Histori * Identitet * Integrim

# Gazeta e Alpeve

Nr. 120

Tel: +355 69 78 39 500 E-mail: gazetaealpeve@gmail.com

Drejtor i Përgjithshëm: Ramiz TAFILAJ Kryeredaktor: Ramiz LUSHAJ

Çmimi: 200 Lekë 2 Euro

Konventa EuroBallkanike e Alpeve Valbonë, 15-16 maj 2026

Konventa Arbërore me Arbëreshët e Italisë San Demetrio Corone 27 prill 2026

Media e Lirë, e Pavarur, e Përdyjavshme, Rajonale - PanShqiptare-NdërBallkanike
EuroAtlantike (Shqipëri-Kosovë-Mali i Zi-Lugina e Preshevës e Sanxhak-Maqedoni e Veriut-Mërgata Shqiptare në Botë)

Viti IX-të i botimit | 16-31 Mars 2026 | Version i shtypur i gazetës me 52 faqe 10 (120) | Abonimi vjetor: 100 Euro (ose kundërvlera në monedha të tjera)

# Konventa Arbërore

## me Arbëreshët e Italisë, një ngjarje e veçantë euroballkanike e vitit

### (në San Demetrio Corone, me 27 prill 2026)

Faqe 2-8

**Fjala e Mirëseardhjes nga dr. Ernesto Madeo - Kryetar i komunës San Demetrio Corone, në provinca e Kozencës, rajoni i Kalabrisë, Itali. Hon. Joseph J. DioGuardi, rrënjas arbëresh, ish Kongresmen në SHBA, President i Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane (AACL/LQSHA), nga Nju Jorku do të dërgojnë një video-mesazh Përshendetës për Konventën Arbërore**

## Ne do të ndërtojmë vetë, së bashku me Qeverinë e Kosovës, Hekurudhën Durrës-Prishtinë

Nga Edi RAMA
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

Faqe 10

## Kriza e zgjedhjes së Presidentit: kalkulimet politike dhe frika nga përgjegjësia

Nga Ramiz TAFILAJ - Texas

Faqe 32

## Alpet tona kreshnike me kryediplomatë elitarë

**Nga Dr. Jorgji KOTE - Mjeshter i Madh në Diplomaci - Bruksel**

**Ambasadorët: Maxhun PEKA, Islam LAUKA, Mal BERISHA, Arben ÇEJKU, Kujtim MORINA, Flamur GASHI, Mehmet ELEZI**

Tropoja, Kukësi, Alpet, kanë nxjerrë diplomatë premtues dhe të vlerësuar karriere, të cilët gjithashtu kam patur fatin t'i njoh, t'bëhemi miq dhe të bashkëpunoj me ta brenda dhe jashtë vendit.

Konkretisht, kemi **Prof. Dr. Petrit Malaj, Ambasadorin tonë të tanishëm në Prishtinë, personalitet i mirënjohur i botës akademike dhe artit; zotin Arben Doçi, me përvojë 25 vjeçare në diplomaci, në Ministrinë e Jashtme, në Ambasadat tona në Moskë, në Prishtinë dhe tani Konsull i Përgjithshëm në Ulqin**; ka kryer studimet e plota edhe në Institutin "Gorki" dhe në Akademinë Diplomatike të Moskës.

Tropojani tjetër, **Ilir Neza është doktoruar në Paris për të drejtën Europiane; ka shërbyer si diplomat në Bruksel në Misionin tonë pranë BE-së nga viti 2008 – 2013; në 15 vitet e fundit në sektorë të ndryshëm në Ministrinë tonë të Jashtme; dhe tani është emëruar në Përfaqësinë tonë të Përhershme pranë OKB-së në Gjenevë**. Një njeri, koleg dhe mik i mrekullueshëm, të cilin e duan dhe rtespektojnë të gjithë. Ruaj kujtimet më të mira nga bashkëpunimi me Ilirin në Bruksel dhe më vonë.

Por Tropoja krenohet edhe me vajza diplomate me përvojë të spikatur. Këtu ia vlen të veçojmë **Almona Bajramin, e cila ka shërbyer në Ambasadat tona në Prishtinë, në Nju Jork, në Londër dhe tani së fundi si zyrtare në Drejtorinë e Protokollit të Shtetit.**

*Vijon në faqen 14*

## Konventa EuroBallkanike e Alpeve

Valbonë, 15-16 maj 2026

Faqe 45, 47-51

## Shqipëria ka potencial të jashtëzakonshëm për turizëm dimëror, por edhe 12-mujor, në turizëm alpin

Nga Avni PONARI

Faqe 9

## Manifestimi i Tretë Rajonal Dimëror

**(Tropojë, 12 mars 2026)**
**Pjesmarrës: Bashkia Tropojë dhe komunat Plavë, Guci në Malin e Zi dhe Pejë, Deçan e Junik në Republikën e Kosovës**

Nga **Rexhë BYBERI** – Kryetar i Bashkisë Tropojë

Në një atmosferë shumë të përzemërt dhe miqësore pata kënaqësinë, që me 13 mars 2026, të mirëpres në Tropojë, së bashku me **deputetin e Qarkut Kukës, z. Eduart Shalsi**, Manifestimin e III Rajonal Dimëror Ndërkufitar Shqipëri, Mal i Zi dhe Kosovë.

Ky, përveçse një takim i rëndësishëm në bashkëpunimin dhe promovimin e resurseve tona turistike dhe ekonomike, është edhe një shtyllë e fuqishme e shkëmbimit të vlerave dhe eksperiencave tona, si një kërkesë e rëndësishme në procesin e integrimit në BE .

*Vijon në faqen 11*

## Festivali i Poezisë Alpine
## Konkursi Ndërkombëtar Poetik "ALPET"

**Poezi nga Sytki NDRECAJ, Ramë ORACA, Fatbardha ÇELAJ, Shyqyri FEJZO**

Faqe 37-38

FESTIVALI I POEZISË ALPINE — VALBONË · 16 MAJ 2026 —

# Konventa Arbërore me Arbëreshët e Italisë San Demetrio Corone

## 25 prill 2026

Komuna San Demetrio Corone në Kalabri (Itali), në bashkëpunim me "Gazeta e Alpeve" (Shqipëri...), në përkujdesjen e Dr. Ernesto MADEO, Kryetar i Komunës San Demetrio Corone në Kalabri, me 25 prill 2026, ora 11.$^{00}$, organizojmë "Konventën Arbërore" me Arbëreshët e Italisë dhe personalitete shqiptare nga Shqipëria, Kosova e Lugina e Preshevës, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Europa, Amerika etj.

Në Programin e Konventës Arbërore do të ketë fjalë rasti, përshëndetje, këngë, valle... dhe veprimtari të tjera, si përurime, vizita në vende e objekte historike etj.

Kontakt: E-mail: konventaarbërore@gmail.com

Konventa Arbërore
me Arbëreshët e Italisë
San Demetrio Corone
25 prill 2026

Konventa Arbërore
*me Arbëreshët e Italisë*
a San Demetrio Corone
25 prill 2026. Ora 11 $^{00}$

Histori * Identitet * Integrim
GAZETA e ALPEVE
Bashkarisht... Shqiptarisht...

*Ftesë*

**Komuna San Demetrio Corone** në Kalabri (Itali)
në bashkëpunim me **"Gazeta e Alpeve"** (Shqipëri...)
*në përkujdesjen e*

**Dr. Ernesto MADEO**
**Kryetar i Komunës San Demetrio Corone në Kalabri**

**Organizojmë "Konventën Arbërore"**
me Arbëreshët e Italisë dhe personalitete shqiptare nga Shqipëria, Kosova e Lugina e Preshevës, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Europa, Amerika etj.

**Në Program do të ketë fjalë rasti, përshëndetje, këngë, valle...**
**dhe veprimtari të tjera si përurime, vizita në vende e objekte historike etj.**

*Ju urojmë mirëseardhjen!*

Organizziamo il "Convegno degli Arbëresh", a San Demetrio Corone, a 25 Aprile 2026, con gli Arbëresh d'Italia e personalità albanesi dell'Albania, del Kosovo e della Valle di Presheva, Montenegro, Macedonia del Nord, Europa, America, ecc.
Nel programma ci saranno saluti, canti, balli...e altre attività come inaugurazioni, visite a luoghi e oggetti storici, ecc.

*Ti diamo il benvenuto!*

Kontakt: E-mail: posta@comune.sandemetriocorone.cs.it dhe konventaarbërore@gmail.com

Konventa Arbërore
San Demetrio Corone
25 prill 2026. Ora 11 $^{00}$

Convegno degli Arbëresh
San Demetrio Corone
25 Aprile 2026

Konventa Arbërore me Arbëreshët e Italisë
në San Demetrio Corone
25 prill 2026

Convegno degli Arbëresh con gli Arbëresh d'Italia
a San Demetrio Corone
25 Aprile 2026

# Arbëreshi i shquar, Joe DioGuardi, ish Kongresmen Amerikan  në Nju Jork, personalitet kombëtar shqiptar, do të përshendetin me një video-mesazh, "Konventën Arbërore" në San Demetrio Corone, në Kalabri

Nga **Rali LURA** - Shqipëri

Personaliteti i shquar shqiptar, me origjinë arbëreshe, **Joseph (Joe) John DioGuardi,** politikan amerikan 86-vjecar (1940), **është i pari dhe i vetmi shqiptaro-amerikan i zgjedhur në Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në dy mandate 1984-1986 dhe 1986-1989, me katër dekada veprimtari aktive e kontribute madhore** për Lirinë, Pavarësinë e Shtetësinë e Republikës së Kosovës, për Demokracinë, Zhvillimet e Integrimet e Shqipërisë, për të Drejtat e Liritë Kombëtare e Universale të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, në Malin e Zi dhe në Luginën e Preshevës.

**Për meritat e tij kombëtare shqiptare, për lidhjet e tij proshqiptare lobuese e afirmuese me Amerikën dhe me komunitetin hebraik në SHBA, për mesazhet, qëndrimet e veprimet proshqiptare përgjatë mbi 20 vizitave në Rajonin Ballkanik Shqiptar** (1990-2025), për jehonën kombëtare shqiptare në botë etj. **Joe Dioguardi është nderuar me dekorata të larta: "Urdhri i Lirisë" nga Presidenti i Kosovës (2023), "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"-nga Presidenti i Shqipërisë (2005)** dhe, së fundit, para një viti, gjatë Vizitës historike në Maqedoninë e Veriut u nderuan me titullin e lartë "Doctor Honoris Causa" nga Universiteti i Tetovës, me titullin e lartë "Qytetar Nderi" nga komuna e Cairit etj.

Personaliteti i shquar shqiptaro-amerikan, Joe Dioguardi dhe Bordi Botues Ndërkombëtar i Gazeta e Alpeve" kanë një marrëdhënie të mirë nderimi e bashkëpunimi ndërmjet tyre. Joseph John DioGuardi & Shirley Cloyes Dioguardi e kanë përshendetur "Kuvendin Kombëtar të Alpeve" në Pejë (2022) dhe "Takimin e Madh të Prishtinës" (2024) me mesazh shkrimor. Në faqet e "Gazeta e Alpeve" janë botuar me dhjetra faqe shkrime për Dioguardët e Kombit, për veprimtarinë e tyre. Joe Dioguardi u nderua me Cmimin e Madh "Lavdi Kombëtare" dhe Shirley Cloyes Dioguardi me Cmimin e Madh "Mirënjohja Shqiptare" nga "Takimi i Madh i Prishtinës, 2024", ku ishte kryeorganizator "Gazeta e Alpeve", ku merrnin pjesë mbi 500 të ftuar nderi nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Lugina e Preshevës, Europa, Amerika, Australia, etj. Në cdo veprimtari (ndër)kombëtare të "Gazeta e Alpeve", DioGuardët e Kombit kanë pasë ftesë të vecantë, sikurse edhe kësaj here, në "Konventa Arbërore" me Shqiptarët e Italisë e të Botës, në San Demetrio Corone, në Kalabri, që organizohet në bashkëpunim me komunën arbëreshe dhe nën përkujdesjen e kryetarit të saj, **Dr. Ernesto Madeo, personalitet i shquar**

*Vijon në faqen 6*




# Joe DioGuardi, rrënjët e tij arbëreshe

Personaliteti i shquar kombëtar shqiptar Joe DioGuardi është i origjinës arbëreshe të kahershme e të afërt, ku shpesh i ka deklaruar me krenari e botnisht rrënjët e tij arbëreshe, duke pohuar se **babai i tij, Joseph DioGuardi Sr. ishte me origjinë arbërore, i lindur në fshatin Greci (Katundi) afër Napolit, në Rajonin Avellino në Itali, i cilësuar si fshati më i vjetër shqipfolës në Itali, i cili emigroi në vitin 1929 në Amerikë** dhe, si shumë emigrantë të tjerë nga Italia, ia filloi jetës së atyshme si shitës perimesh në një shitore në Bronx të Nju Jorkut.

**Të parët e DioGuardit thuhet se kanë emigruar në Greci (Katund) qysh në kohën e Skënderbeut, në shek.. XV, kur luftëtarët e Heroit tonë Kombëtar shkuan në përkrahje të mbretit Ferdinand I i Aragonës për ti mbrojtur nga sulmet e Anzhuinëve. Në Greci (Katund) thuhet se u bë një betejë e madhe, se në këtë fshat kishte ardhur e qëndruar përkohorë edhe vet Skënderbeu** etj.


Qyteti-komunë Katund (Grece), vendi i origjinës së DioGuardit tonë të madh

Greci (arbërisht: vendbanim, fshat-katund) është një qytet dhe komunë arbëreshe, dikur në Rajonin e Napolit e tevona në Provincës e Avelino të Rajonit Kampania në Itali, i vetmi fshat arbëresh në këtë provincë italiane, që ndodhet rreth 100 km në verilindje të Napolit, rreth 50 km në jugperëndim të Foxhias, ndërsa **me komunën San Demetrio Corone është rreth 290 km larg, rreth 4 orë me makinë.**

*Vijon në faqen 7*

# Personalitete shqiptare nga Arbëria (arbëreshë) dhe nga Shqipëria që i kanë kryer studimet apo kanë dhanë mësim në Kolegjin e Shën Adrianit në San Demetrio Corone (komuna Shën Mitër Korone)

## Imzot Feliçe Samuel RODOTÀ
*(1691-1740)*

**Ishte mësimdhënës (profesor) në Kolegjin Arbëresh të Shën Adrianit në Dan Demetrio Corone (Shën Mitër Korone)**

Ishte i pari peshkop i ritit bizantin për Arbëreshët e Kalabrisë, në rajonin e sotëm të Kozencës, në Italinë e Jugut. Një ndër personalitetet arbëreshe të shquara në historinë e Arbëreshëve në Itali dhe të Arbëreshëve në Botë.

## Jul VARIBOBA
*(1725-1788)*

**Personalitet arbëresh që ka studiuar në Kolegjin Shën Adriani të San Demetrio Corone (Shën Mitri Korone)**.

Prift e shkrimtar arbëresh nga Kalabria (nga Mbuzati, San Giorgio Albanese).

Ishte Rektor i Seminarit Arbëresh të Shën-Benedikt në Ullano dhe aty në vitin 1762 e botoi veprën "*Gjella e Shën-Mërisë Virgjër*"- një vepër e hartuar me synim artistik që nga studiuesit cilësohet si kalimi nga poezia e llojeve të shkurta në poemën e gjatë, gjë që s'ishte parë deri në atë kohë ndër shkrimtarët shqiptarë.

## Jeronim De RADA
*(1814 - 1903)*

**Student e më pas edhe profesor në Kolegjin Arbëresh të Shën Adrianit në Shën Mitër Korone (San Demetrio Corone)**

Themelues i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, poet, gazetar, shkrimtar, botues, folklorist, filololog. Botoi e drejtoi të paren gazetë shqipe në historinë e shtypit kombëtar shqiptar "L'Albanese d'Italia", më 23 shkurt 1848 ("Shqiptari i Italisë"); gazetë politike, shoqërore dhe letrare, në gjuhën italiane e pjesërisht edhe arbërisht.

De Rada e organizoi Kongresin e Parë të Arbërishtes në Corigliano Calabro (fshat i madh arbëresh në komunën e sotme Corigliano-Rossano të Provincës së Kozencës) dhe Kongresin e Dytë të Gjuhës Shqipe në Lungro (qytet dhe komunë arbëreshe në Kalabri) dhe falë De Gubernatit dhe së bashku me Giuseppe Schiro (At Zef Skiro, Hora e Arbëreshëve 1690-Himara 3 dhjetor 1769, prift dhe shkrimtar arbëresh, kryepeshkop i ritit bizantin i Dioqezës së Durrësit dhe Vikar Apostolik i Misionit të Himarës) e themeloi Katedrën e Arbërishtes në Institutin Oriental në Napoli.

## Mehdi Bej FRASHËRI
*(1872-1963)*

**Profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Kolegjin Arbëresh Shën Mitër Koronë në Kalabri**

**Mehdi Bej Frashëri, pas një përpjekje për kthim në Atdhe, në mbarim të Luftës së Parë Botërore, internohet në Shën Mitër Koronë, ku edhe shkroi romnain e tij "Novruzi", në gjuhën shqipe.**

Politikani, diplomati, shkrimtari, Mehdi Bej Frashëri, ka pasë detyra të rëndësishme në disa vende të Perandorisë Otomane.

Ishte Kryeministër i Shqipërisë dhe Ministër i Drejtësisë (1935-'36), Ministër i Punëve të Brendshme (1920-'21), Ministër i Punëve Botore dhe Ministër i Bujqësisë (1921), Ministër i Ekonomisë Kombëtare (1930-1931).

Ishte Përfaqësues i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve.

Ishte dhe Antar i Këshillit të Lartë të Regjencës në kohën e pushtimit të Shqipërisë nga Gjermania Naziste.

## Aleksandër XHUVANI
*(1880-1961)*

**Student dhe profesor në Kolegjin Arbëresh të Shën Adrianit në komunën San Demetroi Corone (Shën Mitër Korone) në Kalabri**

Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani ishte veprimtar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, iluminist i spikatur dhe pedagog i madh, personalitet i shquar i arsimit, i shkencës dhe jetës politiko-shoqërore, i dekoruar "Mësues i Popullit" dhe shkencëtar i shquar (gjuhëtar, pedagog dhe psikolog), cilësohej pedagogu më i shquar shqiptar dhe figura qendrore e arsimit kombëtar shqiptar në gjysmën e shekullit XX dhe çmohet edhe si çmohet edhe si themelues i pedagogjisë dhe psikologjisë shqiptare.

Ishte Ministër i Shtetit Shqiptar, në vitin 1921.

## At Anton SATRI
*1819-1894*

**Personalitet arbëresh që ka studiuar në Kolegjin Shën Adriani të San Demetrio Corone (Shën Mitri Korone)**.

Prift françeskan, shkrimtar, poet, dramaturg, veprimtar.

Mori pjesë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Shqipëri.

Autor i një gramatike të shqipes, hartues i një fjalori të shqipes, ka shkruar poezi, poema, romane, drama, novela.

## Zef SEREMBE
*1844-1901*

**Personalitet arbëresh që ka studiuar në Kolegjin Shën Adriani të San Demetrio Corone (Shën Mitri Korone)**.

**Zef Serembe** (*Giuseppe Serembe*) lindi më 6 mars 1844 në Strigari (*San Cosmo Albanese*) të krahinës së Kozencës, ishte poet lirik arbëresh. Në Kolegjin e Shën Adrianit, pati mësues De Radën, me të cilin më vonë u bë mik i mirë.

Shumë prej veprave (punëve) të Serembes (poezi, drama dhe një përkthim i Psalmeve të Davidit) që ai shpesh i rishikonte e i ndryshonte, humbën gjatë jetës së tij endacake. Sa qe gjalle ai botoi vetëm:

"*Poesie italiane e canti originali tradotti dall`àlbanese*" (Poezi italiane e këngë origjinale të përkthyera nga shqipja), Kozencë 1883 në italisht dhe shqip, "*Il reduce soldato, ballata lirica*", 1895 Nju Jork (Kthimi i ushtarit, baladë lirike); vargje vetëm në italisht, dhe "*Sonetti vari*" (Sonete të ndryshme) Napoli 1891, një përmbledhje shumë të rrallë prej 42 sonetesh me një parathënie (hyrje), me një shkrim të imtë të ndrydhur në vetëm 4 faqe.

Një poemë u duk edhe në revistën e Zef Skiroit (Giuseppe Schiro) Arbri i Ri me 31 mars 1887. 39 prej poemave te tij shqipe "Vjersha" u botuan pas vdekjes së tij në vitin 1926 në Milano nga nipi i tij Cosmo (Kozmo) Serembe. Punë të tjera tij u gjendën në arkiva të ndryshme dhe dorëshkrimet në vitet e fundit dhe disa prej poemave në të vërtetë mbijetuan në përcjellje gojore midis fshatarëve të San Cosmo Albanese.

Kjo shenjë e popullaritetit te tij ne vendlindje është tepër për t'u habitur nga që ai pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi larg tij.

*Vijon në faqen 5*

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Personalitete shqiptare nga Arbëria (arbëreshë) dhe nga Shqipëria që i kanë kryer studimet apo kanë dhanë mësim në Kolegjin e Shën Adrianit në San Demetrio Corone (komuna Shën Mitër Korone)

*Vijon nga faqja 4*

**Anselmo LOREKIO**
*(1843 – 1924)*

**Personalitet arbëresh që ka studiuar në Kolegjin Shën Adriani të San Demetrio Corone (Shën Mitri Korone)**

Anselmo Lorekio (*Anselmo Lorecchio*) ka lindur në fshatin arbëresh Puhëriu (Pallagario, Krotonë). Avokat dhe publicist, që së bashku me Jeronim De Radën dhe Zef Skioin, i kanë dhanë shumë Gjuhës dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Kreu shkollimin e lartë për Drejtësi në Universitetin e Napolit dhe më pas iu përkushtua studimit të kulturës arbëreshe. Mori pjesë aktivisht në lëvizjet kulturore dhe politike të periudhës.

Drejtoi Kongresin e Dytë Albanologjik të mbajtur në Lungro më 1897, ku u zgjodh President i Shoqërisë Kombëtare Shqiptare (*Società Nazionale Albanese*), duke botuar dhe shumë punime të shkrimtarëve arbëreshë e shqiptarë me shpenzimet e veta. Autor i *Çështjes shqiptare* (*La questione albanese*; Catanzaro, 1898); *Mendimi politik shqiptar në raport me interesat italiane* (*Il pensiero politico albanese in rapporto agli interessi italiani*; Roma, 1904) si dhe i artikujve të shumtë. Ishte botues i të përkohshmes me ndikim arbëresh *La Nazione Albanese*, një revistë e përdyjavshme që trajtonte çështjet politike dhe kulturore dhe që veproi prej 1897 e deri kur ndërroi jetë.

Në prill të 1922, qeveria shqiptare u përpoq që të emëronte Lorekion si ministër pranë Selisë së Shenjtë.

**Kolë KAMSI**

Me dekretin nr. 2544 datë 19.10.1957, u dekorua me Urdhrin e Flamurit, me motivacion për kontributin e vlefshëm në edukimin e brezave të rinjtë gjatë 50 vjetëve punë të rregullt e të pandërprerë në sektorin e arsimit. Njëkohësisht me dekretin nr. 459 të datës 13.02.1993, Presidenti Sali Berisha i dha Z. Kolë Palok Kamsi titullin "Mësues I Popullit" me motivacion:" Mësues i fillimeve të arsimit kombëtar shqiptar, studiues i pasionuar i gjuhës dhe historisë, i kulturës dhe traditave kombëtare, botues veprash dhe artikujsh shkencorë, shembull qytetarie, shpirt demokratik e përparimtar

**Imzot Donati Oliverio**
*(1956)*

**Mësimdhënës të shquar**

Imzot Feliçe Samuel Rodotà (1691 – 1740)
Jeronim De Rada (1814 – 1903)
Mehdi Frashëri (1872 – 1963)
Aleksandër Xhuvani (1880 – 1961)
Kolë Kamsi (1886 – 1960)
Gaspër Jakova Merturi
Battista Groppa
Kolë Martinaj
Elia Lorichio

**Studentë të shquar**

Papa Jul Variboba (1727 – 1788)
Jeronim De Rada (1814 – 1903)
Papa Anton Santori (1819 – 1894)
Anselmo Lorekio (1843 – 1924)
Zef Serembe (1844 – 1901)
Luigj Gurakuqi (1879 – 1925)
Aleksandër Xhuvani (1880 – 1961)
Imzot Jani Mele (1885 – 1979)
Kolë Kamsi (1886 – 1960)
Kostaq Cipo (1892 – 1952)
Avni Rrustemi (1895 – 1924)
Hysni Lepenica (1900 – 1943)
Sejfulla Malëshova (1900 – 1971)
Papa Dushko Vetmo (1914 – 1999)
Papa Vorea Ujko (1918 – 1988)
Mehmet Vokshi, etj.[4]

# Kolegji Shën Adrianinë komunën San Demetrio Corone (Shën Mitri Korone), në vendlindjen e Jeronim De Radës

**Historiku**

**(vijon nga numri i kaluar)**

Fara e lënë nga murgu nga Rossano Nilo Malena, në vitin 955, para ardhja e arbëreshëve, vazhdoi të jepte fruta të tjera pas shtypjes së abacisë së lashtë të Shënt' Adrianit.

Dhe kështu, në vitin 1794 Kolegji Mbretëror Italo-Grek i Sant'Adriano-s mori detyrën nga Abacia e vjetër e Nilianës, për t'u bërë protagonisti i madh i historisë jo vetëm të zonës lokale, por edhe të etnisë arbëreshe në Kalabri dhe Italinë Jugore.

Prona iu hoq komunitetit fetar me Dekret Mbretëror të Ferdinandit IV të Burbonit dhe iu caktua seminarit të ri. Përmbajtja e studimeve, e tutje, u karakterizua nga një fizionomi më klasike dhe shkencore sesa teologjike. Në vitet e dekadës Napoleonike (1805-1815), Kolegji u ngrit në "Liceo delle due Calabrie", me një dekret Murat të vitit 1812, për shkak të një politike që priret drejt një edukimi më të hapur dhe për rrjedhojë më popullor, duke projektuar

**Kisha e Shën Adrianit, ngjitur Kolegjit Arbëresh në San Demetrio Corone**

kështu Shkollën ndaj kulturave të reja të pritjeve të kohës.

Në vitin 1815, me kthimin e Bourbonëve në skenën politike të Italisë së Jugut, synimet hakmarrëse ndaj kësaj "vatre të djajve" rezultuan në masa të ndryshme mbylljeje, të cilat për fat të mirë u anuluan nga Ferdinandi II falë ndërhyrjeve këmbëngulëse dhe efektive të peshkopit-presidentit. Bellusci. Dekreti prestigjioz i paluajtshmërisë së Kolegjit mbahet mend në dy pllakat e mermerit të dukshme edhe sot në fasadën veriore të kishës, përkatësisht në greqisht dhe latinisht. Të farkëtuar nga rregulla të forta dhe të nënshtruar studimeve të shkëlqyera, por rigoroze, të cilat nuk linin vend as për mediokritet angazhimi dhe fitimi, të rinjtë e arsimuar brenda mureve të Sant'Adriano u dalluan, por edhe në të ardhmen, për aftësinë dhe seriozitetin e tyre. në studimet e tyre; dhe disa prej tyre arritën të merrnin diplomën e tyre me nota të shkëlqyera dhe një përqindje të lartë kalimesh. Më tej, Bellusci prezantoi figurën e re të presidentit ose rektorit, siç do të quhej nga fillimi i shekullit të 20-të; një detyrë që do të kryhet në fushën thjesht administrative dhe arsimore,

Idealet e Revolucionit Francez, puna e fshehtë e karbonarëve dhe idetë e Italisë së re, mbërritën ndërkohë edhe në muret e Kolegjit italo-grek të Sant'Adriano-s, duke infektuar profesorë dhe studentë, saqë u ndezën zemrat e tyre. idealet revolucionare dhe dashuria për vendin.

Dhe më vonë, mjaft studentë italo-shqiptarë të Kolegjit San Demetrio Corone u bënë protagonistë të Risorgimento-s Kalabreze.

*(Vijon në numrin e ardhshëm)*

# Arbëreshi i shquar, Joe DioGuardi, ish Kongresmen Amerikan në Nju Jork, personalitet kombëtar shqiptar, do të përshendetin me një video-mesazh, "Konventën Arbërore" në San Demetrio Corone, në Kalabri

Nga **Rali LURA** - Shqipëri

*Vijon nga faqja 3*

**i botës e kohës së sotme arbëreshe.**

Joe DioGuardi ka diplomuar me nderimet më të larta akademike nga Fordham University më 1962 në Neë York dhe para se të kyçej në politikë ka shërbyer si partner në firmën më të madhe të kontabilitetit të SHBA në atë kohë, Arthur Anderson & Co dhe ishte kontabilisti i parë publik i çertifikuar i zgjedhur ndonjëherë në Kongresin e SHBA.

**Joe Dioguardi, ndër dekadat e fundit, njihet edhe si "Çelsi Shqiptar në Washington, DC".**

Në vitin 1986 e paraqiti për herë të parë Rezolutën Kongresiale për të Drejtat e Liritë e Shqiptarëve në Jugosllavi. Përmes punës direkte me liderët kryesorë në Kongresit e SHBA-ve, qofshin ata demokratë apo republikanë, si **Dole, McCain, Biden, Schumer, Lantos, Hyde, Nadler, Menendez,** e shumë e shumë të tjerë, DioGuardi dhe LQSHA arritën që të rikthejnë në favor të shqiptarëve politikën e jashtme amerikane.

Si rezultat direkt i punës së DioGuardit, SHBA-të u bënë partner dhe mik strategjik e i parezervë i shqiptarëve në përgjithësi e Kosovës në veçanti, që së bashku me Ligën Qytetare Shqiptaro-Amerikane, arritën që të vënë në prioritet të Shtëpisë së Bardhë çështjen e Kosovës, dhe përmes punës së tyre lobiste të përkrahur nga Bordi i Ligës dhe komuniteti i gjerë shqiptaro-amerikan, sollën jo vetëm lirinë e pavarësinë e Kosovës, por edhe demokratizimin e anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, forcimin e të drejtës nacionale të shqiptarëve në Maqedoni të Veriut, dhe përpjekjet e vazhdueshme për barazi për shqiptarët në Mal të Zi e në Luginë të Preshevës.

Joe DioGuardi **njihet edhe si mik i afërt i ish-Presidentit Amerikan George H. W. Bush, dhe mandej edhe i djalit të tij, ish-Presidentit Amerikan, George W. Bush, por edhe i ish-Senatorit e ish Presidentit Joe Biden, ka njohje të mira me Presidentin Amerikan, Donald Tramp.**

DioGuardi më 1989 e themeloi Ligën Qytetare Shqiptaro-Amerikane (LQSHA) që mbetet sot e kësaj dite organizata e vetme e regjistruar si lobiste për kauzën shqiptare në Washington D.C., e cila edhe në kohën e prillit 2026, kur mbahet "Konventa Arbërore" në San Demetrio Corone, do të kenë angazhime kombëtare direkte aktive në Amerikë.

**Personaliteti i shquar Joe Dioguardi, me origjinë arbëreshe, do të përshendetin me një video mesazh të shkurtër (3 minuta) "Konventën Arbërore" të Arbëreshëve të Italisë e të Botës, bashkëvendasit e tij arbënorë në Itali e kudo tjetër në botë, e cila do të mirëpritet nga të ftuarit e Konventës gjatë shfaqjes së saj në video-projektor të Konventës, në ekranin e sallës me rreth 500 vende të Teatrit të rinovuar të San Demetrio Corone, që përurohet me 25 prill 2026, që është një Teatër International Arbëror.**

# Shirley Cloyes DioGuardi, Këshilltare për Çështje të Ballkanit pranë Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane

Ishte publiciste shtëpisë botuese Lawrence Hill Books në SHBA dhe po merrej me botimin e një libri mbi Jugosllavinë (Yugoslavia's Ethnic Nightmare) në fillim të viteve të 1990-ta kur edhe u takua e u njoftën me Joe DioGuardin, të cilët më vonë do të martoheshin dhe do t'i bëhej jo vetëm bashkëshorte, por edhe partnere e rëndësishme për punën e përbashkët në kauzën kombëtare shqiptare.

Shirley Cloyes DioGuardi u bë Këshilltare për Çështje të Ballkanit pranë Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane më 1994, detyrë të cilën e ushtron me përgjegjësi e efikasitet të lartë edhe sot. Ajo është përgjegjëse direkte për një sërë aktivitetesh të suksesshme të Ligës Qytetare.

Një intelektuale par-ekselance, Shirley Cloyes DioGuardi, ka dhënë disa herë dëshmi në dëgjimet kongresionale për Kosovën dhe çështjen shqiptare në Ballkan.

Nga liderët e politikës së jashtme të SHBA-ve në Capitol Hill, Shirley Cloyes DioGuardi vlerësohet si autoritet i rëndësishëm për zhvillimet në Ballkan dhe marrëdhënjet shqiptaro-amerikane.

Ajo ka kryer studimet për sociologji nga Oberlin College dhe magjistraturën në Teologji në Unio Theological Seminary në New York City.

**Logo e komunës Katund (Grece)**

Botimet Dardania
Tiranë-Prishtinë



Limit.al
Portal kombëtar

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Joe DioGuardi, rrënjët e tij arbëreshe

*Vijon nga faqja 3*

**Në qendër të Grece (Katundit) është ngritur Busti i Skënderbeut, që nga vitit 2018**.

Territori komunar i Katundit (Grece), me 33.5 km² dhe rreth 1 mijë banorë, i vendosur në një kodrinë të butë e të bukur 821 metra lartësi mbidetare, kufizohet me komunat Ariano Irpino, Castelfranco in Miscano, Faeto, Orsara di Puglia, Montaguto, Savignano Irpino.

Nëna e Joe DioGuardit ishte italiano-amerikane e brezit të parë të emigruar në Nju Jork, më 1910.

Joe DioGuardi është i martuar me Shirley Cloyes DioGuardi, tashma Këshilltare për Çështje të Ballkanit pranë Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane (LQSHA) në Nju Jork, SHBA.

**Shtëpia e dikurshme e Dioguardëve në Grece (Katund), ku ka lindur babai i Joe DioGuardit, por sot është në zotërim nga pronarë të tjerë të atyhit**

# Shkollimi i të rinjve nga trevat shqiptare në Kolegjin arbëresh të Shën Adrianit

**Nga Dr. Nikollë LOKA**

Pas emigrimit masiv të shqiptarëve në Itali, menjëherë pas pushtimit osman, u krijuan komunitete të arbërve, të cilët ruajtën gjuhën dhe kujtesën e tyre të përkatësisë e të prejardhjes dhe, falë institucioneve fetare e kulturore, rizbuluan rrënjët e tyre.

Rol të rëndësishëm në ruajtjen e vetëdijes kombëtare në Shqipërinë e pushtuar nga otomanët ka luajtur Kolegji, i quajtur më parë Korsini, i themeluar në Shën Benedikt Ulano në vitin 1732 dhe transferuar pastaj në abacinë e lashtë baziliane të Shën Adrianit në Shën Mitrin arbëresh në vitin 1794.

Rol të madh fitoi Kolegji pas vitit 1736, kur filloi të shkruhej gjuha shqipe dhe sidomos në vitin 1849, kur u themelua Katedra e gjuhës shqipe nën drejtimin e rilindasit të shquar Jeronim De Rada.

Lidhjet midis arbëreshëve dhe shqiptarëve nuk u ndërprenë asnjëherë, prandaj shqiptarët i vijuan studimet në këtë Kolegj që nga fillimi i veprimtarisë së tij, për t'u përgatitur si klerikë dhe pastaj edhe si mësues etj. Vetë arbëreshët, menjëherë pas bashkimit të Italisë, i kërkuan qeverisë italiane që të jepte bursa për studentë nga Shqipëria.

Në vitin akademik 1903-1904, Kolegji u ngrit në rangun e Institutit Ndërkombëtar Italo-Shqiptar dhe që atëherë numri i studentëve shqiptarë u shtua shumë.

Nga bankat e këtij kolegji kanë dalë rreth 100 studentë shqiptarë, që u bënë ndër personalitetet më të shquara të historisë dhe të kulturës sonë kombëtare, disa prej të cilëve shërbyen në Kolegjin e Shën Adrianit si mësues, duke i dhënë atij edhe më shumë karakter mbarëshqiptar.

## Hyrje

Pas pushtimit osman të vendit, një pjesë e shqiptarëve kaluan Adriatikun dhe u vendosën në Itali, ku gjetën një atdhe tjetër por morën me vete gjuhën, traditat dhe zakonet, të cilat i ruajtën ndër shekuj. Nevoja për t'u dalluar nga grekët, i shtyu klerikët intelektualë arbëreshë të vinin në pah veçoritë gjuhësore, fetare dhe kulturore të etnisë së tyre, duke i hapur rrugë çështjes kombëtare që do të lindte në dhjetëvjeçarët më vonë. Përmes shkollës, ata mundën të rizbulojnë lidhjet me vendin e origjinës dhe kurrë nuk i ndërprenë përpjekjet për ta parë atë të lirë dhe të pavarur. Kuvendet fetare të bazilianëve, që frekuentoheshin nga arbëreshët dhe pastaj shkollat ku ata mësuan, u bënë qendra të rëndësishme ku lindën idetë e para të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Shqiptarët e dheut mëmë morën në kolegjet arbëreshe, ndër to dhe në Kolegjin e Shën Adrianit, dije, por edhe mësime atdhedashurie, që ata i mishëruan me vepra gjatë gjithë jetës së tyre.

Nga viti në vit, në Kolegjin e Shën Adrianit u formua një brez i shkolluar nga Shqipëria, që fillimisht i përkiste shtresës së klerikëve, por pastaj edhe të laikëve, të cilët u bënë bartësit e ideve të reja atdhetare dhe përpjekjeve për zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

## Nevoja e arbëreshëve për institucionet e tyre arsimore

Para se të imagjinoheshin si komunitete politike, si "krijesa kulturore" të veçanta, kombet, latinisht "nations", konceptoheshin deri në fundin e shek. XVIII, kyesisht si komunitete fetare, ku përfshiheshin bashkë popuj të ndryshëm nga ana etnike, por që kishin të njëjtën "çati" fetare ose të njëjtën gjuhë liturgjike, në përdorim në ritet e tyre kishtare, pavarësisht përkatësisë së tyre në kishën katolike apo në atë ortodokse.

*Vijon në numrin e ardhshëm*

# Shën Mitër Korone

**Qyteti Shën Mitri (Ital. San Demetrio Corone), me rreth 3.500 banorë në provincën e Cosensës në Kalabria, që për herë të parë e vizitova si student 50 vjet më parë, përbën një tempull të shenjtë të kulturës dhe gjuhës arbërore ku falë Kolegjit Adriano dolën personalitete të shquara si: De Rada, Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Avni Rrustemi e të tjerë**

**Teksti e fotot : Rexhep RIFATI – Zvicër**

Në vazhdën e prezantimit të katundeve arbëreshe që po bën portali ynë prointegra, këtë të hënë ju prezantojmë qytezën Shën Mitri (Ital. San Demetrio Corone), lokalitet ky me peshë të rëndësishme sa kulturore e arsimore aq edhe atdhetare, nga fakti se aty u shkolluan personalitete të shquara shqiptuare, si nga Kalabria, ashtu edhe Shqipëria e anë të ndryshme të Arbërisë.

Shën Mitri, të cilin kam pas rastin ta vizitoj tri herë, më parë si student para gjysmë shekulli dhe së voni edhe dy herë radhazi, ndodhet në një lartësi prej 521 m. mbi nivelin e detit, në kodrat që ngrihen mbi fushën e Sibarit në Greca Sila. Ai është ndër qendrat më të rëndësishme të komunitetit arbëresh, që ka ruajtur gjuhën, zakonet, kulturën, ritet fetare dhe identitetin etnik të tij.

Rëndësinë më të madhe këtij lokaliteti ia ka dhënë fakti se këtu ka vepruar Kolegji i Shën Adrianit (1794), një organizatë e rëndësishme fetare dhe kulturore për ruajtjen e ritit bizantin dhe të traditave arbëreshe. Në fillim të shekullit të kaluar ky vendbanim kishte një numër më të madh banorësh, por edhe këtu migracioni e bëri të vetën.

Gjatë vizitës së fundit, në shoqërim të tre mërgimtarëve nga Zvicra, pasi kaluam një natë të këndshme në Shën Mitër, në shoqërim edhe të disa vendasve në një kafiteri të vogël, të nesërmen na shoqëroi një shi i imtë deri sa vizituam qendrën e kësaj qyteze, ku pa dyshim bie në sy busti i kryetrimit tonë Gjergj Ksastrioti Skënderbeu dhe sheshi i Shën Mitrit, me një monument po ashtu që spikat në qendër.

*Vijon në numrin e ardhshëm*

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Shqipëria ka potencial të jashtëzakonshëm për turizëm dimëror, por edhe 12-mujor, në turizëm alpin

Mbrëmjen e 11 marsit 2026, emisioni "Opinion", i drejtuar nga gazetari Blendi Fevziu, iu kushtua një prej temave më të rëndësishme **për zhvillimin e turizmit në vend: potencialit të zonave alpine dhe destinacioneve turistike që mund të vizitohen gjatë 12 muajve të vitit**.

Paneli solli një panoramë të gjerë të strukturave turistike në zonat malore të Shqipërisë, duke ndërthurur përvojat e sipërmarrësve dhe operatorëve që kanë investuar në këto destinacione.

Nga resortet moderne deri tek bujtinat familjare dhe restorantet tradicionale, u përfaqësuan jo vetëm me historitë e tyre të suksesit, por edhe me sfidat dhe reflektimet që shoqërojnë zhvillimin e turizmit malor, nga perspektiva e sipërmarrësve të pranishëm në studio.

Në këtë panel ishte i ftuar edhe z. **Avni Ponari, CEO i SIGAL Insurance Group, njëherësh edhe administrator i "Valbona Resort and Spa"**, strukturw hoteliere me 5 yje në Luginë të Valbonës.

## Potencialet e Shqipërisë Malore

Në hapje të emisionit, z. Blendi Fevziu theksoi se **Shqipëria ka potencial të jashtëzakonshëm për turizëm dimëror, por edhe 12-mujor, në turizëm alpin.**

Ai vuri në dukje se **destinacione të tilla gjenden jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ndërsa në çdo cep të rajonit janë ngritur struktura turistike që ofrojnë eksperienca unike për vizitorët.**

Sipas tij, **Shqipëria malore është po aq spektakolare sa bregdeti shqiptar, në mos edhe më mahnitëse, duke bërë thirrje për më shumë vëmendje nga turistët dhe për investime më të mëdha nga shteti në këto zona.**

## Avni Ponari
### ndan historinë e Valbonës dhe reflektimet e tij për zhvillimin e turizmit

Z. Ponari ndau në panel me publikun historikun dhe zhvillimin e këtij investimi turistik në zemër të Alpeve shqiptare.

**Ponari shpjegoi se resorti është një strukturë me pesë yje, e përfunduar rreth dy vite më parë dhe e ndërtuar mbi bazën e një strukture shumë më të vogël të periudhës së komunizmit.**

***"Ka qenë një strukturë e vogël turistike e kohës së komunizmit, sepse edhe rrugë nuk kishte në atë kohë. Sot është një strukturë e gjitha e re, me 90 dhoma dhe e projektuar nga arkitekt shqiptar, me të gjitha shërbimet që ka një hotel me pesë yje, si pishinë, sauna, palestër dhe sallë konferencash"*, tregoi ai.**

Duke përshkruar vendndodhjen dhe karakteristikat e zonës, Ponari theksoi se Lugina e Valbonës ndodhet mbi 1000 metra mbi nivelin e detit dhe përbën një nga destinacionet më të preferuara për turizmin e natyrës dhe ecjet alpine.

***"Valbona është një zonë shumë interesante për shumë arsye dhe një nga destinacionet më të pëlqyera për hiking"*, tha ai, duke shtuar se aktivitetet në këto zona lidhen kryesisht me eksplorimin e natyrës dhe lëvizjen në terren.**

Në diskutim u theksua se një nga itineraret më të njohura për turistët është shtegu Theth-Valbonë, një rrugë që lidh dy nga destinacionet më të bukura alpine në vend.

**Sipas Ponarit, gjatë një ecjeje në këtë shteg ai kishte takuar qindra turistë nga e gjithë bota.**

***"Në një ditë takova rreth 600 persona nga katër anët e botës. Është një kalim shumë i bukur dhe jo i vështirë; për rreth katër apo katër orë e gjysmë mund të mbërrish në Theth, që është një mrekulli"*, tha ai.**

Megjithatë, sipërmarrësi theksoi se zhvillimi i turizmit malor në Shqipëri përballet me disa pengesa serioze, kryesisht të lidhura me infrastrukturën dhe aksesin. Ai nënvizoi se udhëtimi drejt Tropojës mbetet i vështirë dhe shpesh kërkon kalimin e dy kufijve përmes Kosovës.

***"Akoma nuk është rentable, sepse të shkosh në Tropojë është shumë e vështirë. Rrugët janë të lodhshme dhe alternativat janë të pakta"*, tha Ponari**.

Një tjetër çështje e ngritur prej tij ishte edhe **mungesa e infrastrukturës për sportet dimërore. Z. Ponari theksoi se Shqipëria ende nuk ka një resort të mirëfilltë skish, ndërsa aktivitetet si heli-skiing në Valbonë janë të kufizuara kryesisht për profesionistët. Sipas tij, zhvillimi i turizmit dimëror kërkon investime të mëdha publike në teleferikë, pista skish dhe infrastrukturë të specializuar.**

**Ponari ngriti gjithashtu shqetësimin për promovimin e pamjaftueshëm të turizmit malor.** ***"Ne për dimër kemi mbetur te Korça dhe për verë te Dhërmiu"***, u shpreh ai me ironi, duke shtuar se shumë njerëz ende e konsiderojnë Valbonën një destinacion të largët, edhe pse distanca nga Tirana është e krahasueshme me atë drejt jugut të vendit.

Në fund të diskutimit, ai theksoi se turizmi malor mund të sjellë përfitime të mëdha ekonomike për zonat alpine, duke krijuar punësim dhe zhvillim lokal. Sipas tij, përveç promovimit, është e nevojshme edhe mbështetje konkrete për bizneset që operojnë në këto zona, përfshirë politika më të favorshme energjetike dhe investime në infrastrukturë.

***"Sipas një studimi vetjak, të gjitha vendet perëndimore, me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës, e kanë energjinë elektrike për strukturat hoteliere alpine më të lirë se sa ajo e konsumatorëve"*, apeloi z. Ponari.**

Emisioni solli në vëmendje potencialin e jashtëzakonshëm të maleve shqiptare dhe nevojën për një strategji më të qartë zhvillimi, ku bashkëpunimi mes sipërmarrjes private dhe institucioneve shtetërore

*Emisionin e plotë "Opinion" të datës 11 mars 2026 mund ta ndiqni në You Tube RTV Klan Emisioni Opinion.*

# Korridori VIII dhe Hekurudha

## Konferencë për shtyp e Kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, me 13 mars 2026

### Projekti i Porto Romanos

Përsa i përket projektit të Porto Romanos, për fat të keq ka ndodhur një koincidencë e pashmangshme që në momentin e fundit kompania që ka kaluar të gjitha fazat dhe duhet të bënte ofertimin e fundit është tërhequr, duke iu referuar situatës së krizës dhe natyrisht duke qenë se oferta financiare do të ishte e lidhur me tavanin që ka vendosur studimi i bërë nga Royal Haskoning, kompania më e madhe e botës për ndërtimet e porteve, aeroporteve, infrastrukturës, etj, etj dhe me tavanin e vendosur nga kërkesa në procedurën e hapur të organizuar nga qeveria shqiptare, nuk kemi arsye që të shikojmë mbrapa ndonjë gjë tjetër, ne vetë personalisht.

Nuk kemi të dhëna që kompania është ndodhur nën ndonjë presion, por i gjithë procesi është zhvilluar nën presion, po jo nën presionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, siç thuhet, pa asnjë argument.

Se nuk ka pasur absolutisht jo presion, po s'ka pasur asnjë shqetësim të shprehur, as nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as nga Bashkimi Evropian, as nga askush. Por ka pasur një presion të vazhdueshëm nga faktorë të tjerë, natyrisht të painteresuar që ai port të jetë një histori suksesi.

Kini parasysh që nga A-ja kur disa thonë për çfarë duhet një port i ri, se ne kemi portin tonë atë kënetën në zemër të Durrësit dhe e lidhin, – e lidhnin, se tani s'e kam dëgjuar më idenë e portit të ri me shitjen e atdheut në duart e arabëve, në fakt, e vërteta është që përtej injorancës që gjithmonë faktorë në mënyrën si trajtohen çështjet këtu, pavarësisht nga rëndësia madhore që mund të kenë, qysh në krye të herës ka pasur forca të interesuara që të mos ecte përpara projekti i portit të ri. Porti ekzistues nuk ka asnjë kapacitet për të qenë nyja strategjike dhe logjistike e Korridorit 8

### Porti ekzistues nuk ka asnjë kapacitet për të qenë nyja strategjike dhe logjistike e Korridorit VIII

Pse? Për një arsye që cilido që do ta kuptojë, e kupton pa ndonjë mundim. Porti ekzistues nuk ka asnjë kapacitet për të qenë nyja strategjike dhe logjistike e Korridorit 8, nuk ka asnjë kapacitet, është në të gjitha aspektet, edhe sikur ta marrësh edhe ta zbukurosh, i papërshtatshëm për të qenë nyje logjistike e Korridorit 8.

Nuk e them unë këtë, e thonë të gjitha analizat e bëra dhe këtë e thonë të gjitha proceset e ndjekura dhe këtë e thotë realiteti i thjeshtë që ai port është mes qytetit.

Një nyje logjistike, portuale në mes qytetit nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë, që këtu, pa llogaritur kapacitetet e portit ekzistues që janë krejt të papërshtatshme për të mbajtur gjithë peshën e Korridorit 8.

### Porti i Thatë i Prishtinës dhe i Shkupit

E dyta, porti i ri si nyje lidhëse e Korridorit 8 është një port që e çon Shqipërinë në një nivel krejt tjetër, po jo vetëm Shqipërinë, po çon shqiptarët në një nivel krejt tjetër, sepse është një nyje e lidhur edhe me një tjetër nyje strategjike, Portin e Thatë të Prishtinës dhe është i lidhur edhe me një tjetër nyje, që është Porti i Thatë i Shkupit.

Porti i Thatë i Shkupit planifikohej në projektin e parë në Strugë. Qeveria e re e ka parë të arsyeshme ta spostoje në Shkup. Dhe ky spostim mund t'i mjaftojë kujtdo që logjikon për të kuptuar që këtu kemi të bëjmë edhe me një përmbajtje të rëndësishme interesash kombëtare strategjike.

Tani, nëse ju mendoni që të gjithë mezi po presin që shqiptarët të bëhen më të fortë, mund ta mendoni. Por ju siguroj që jo në një, por në një sërë vendesh ka forca, të cilat nuk e mirëpresin këtë, dhe kjo nuk ka lidhje me armiqësira të natyrës gjeopolitike vetëm, ka lidhje edhe me këto. Kjo ka lidhje edhe me interesat tregtare të vendeve.

### Korridori VIII – pjesë e Korridorit Europian të Transportit

Nëse ju mendoni që porti i ri është një portë, që ata të cilët, i kanë lidhur interesat me rrugët e trafiqeve, mezi po e presin, - ju mendoni gabim, përkundrazi, nuk kanë asnjë arsye ta mirëpresin. Dhe ka dhe një fakt tjetër që e kam shpjeguar edhe më parë, vetë Korridori 8 sot, është pjesë e rrjetit europian të transportit. Jo se e themi ne, se ne mund të themi, dhe unë e them që edhe korridori Durrës-Prishtinë është pjesë e rrjetit europian të transportit, por nuk është në hartën e rrjetit europian të transportit që gjendet në zyrat e Komisionit Europian në Bruksel, që do të thotë që statusi i një korridori të rrjetit evropian të transportit është tjetër nga statusi i një korridori që mund të jetë mes të Europës, por nuk është në atë rrjet, duke filluar që nga financimi, korridoret që nuk janë në atë hartë, nuk financohen.

### Ne do të ndërtojmë vetë, së bashku me qeverinë e Kosovës, Hekurudhën Durrës-Prishtinë

Mund t'i ndërtosh vetë, siç ne do të ndërtojmë vetë, së bashku me qeverinë e Kosovës, hekurudhën Durrës-Prishtinë dhe kemi folur me kryeministrin në Prishtinë herën e fundit për dy mundësi financimi, të cilat do t'i eksplorojmë së bashku, por ama s'ka asnjë shans që ne të kemi akses në fondet europiane për aksin Durrës-Prishtinë, sepse nuk është.

Tani ky Korridori 8, me të cilin disa bëjnë lodra fjalësh dhe nuk kuptojnë fare se për ça flasin, ndërkohë që disa të tjerë, as nuk duan t'ia dinë fare, sepse e dinë se për ça bëhet fjalë, është futur në Rrjetin Europian Transportit, këtu në Tiranë, në Samitin e BE me Ballkanin Perëndimor, mbasi unë dhe qeveria ime kemi luftuar jo pak vite për të hequr bllokimin që i ishte bërë. Ishte i bllokuar. Pse vendet e BE e kishin bllokuar Korridorin e VIII?

Sipas logjikes së injorantëve që bërtasin në rrugët e pazarit mediatik këto janë muhabete rrugësh. Jo këto nuk janë muhabete rrugësh. Këto janë çështje zhvillimi ekonomik, këto janë çështje sigurie, janë çështje kapacitetesh konkurruese në një hapësire ekonomik dhe tregtare që është shumë e vështirë.

Ne vijmë nga një varfëri ekstreme dhe duam të bëhemi pjesë e një shtëpie që praktikisht zotëron një pasuri shumë të madhe.

### Korridori i VIII u fut edhe në rrjetin e lëvizjes së sigurt të NATO-s

Mbas futjes së korridorit VIII në rrjetin europian të transporteve, korridori i VIII u fut edhe në rrjetin e lëvizjes së sigurt të NATO-s dhe projekti ynë i portit të kombinuar tregtar dhe ushtarak është në tryezën e NATO-s dhe ka kaluar të gjitha nivelet teknike të NATO-s si një domosdoshmëri....

***Fragmente të intervistës, ndërsa mestitujt janë redaksional**

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Manifestimi i Tretë Rajonal Dimëror

**(Tropojë, 12 mars 2026)**

**Pjesmarrës: Bashkia Tropojë dhe komunat Plavë, Guci në Malin e Zi dhe Pejë, Deçan e Junik në Republikën e Kosovës**

Nga **Rexhë BYBERI** – Kryetar i Bashkisë Tropojë

Në një atmosferë shumë të përzemërt dhe miqësore pata kënaqësinë, që me 13 mars 2026, të mirëpres në Tropojë, së bashku me **deputetin e Qarkut Kukës, z. Eduart Shalsi**, Manifestimin e III Rajonal Dimëror Ndërkufitar Shqipëri, Mal i Zi dhe Kosovë.

Ky, përveçse një takim i rëndësishëm në bashkëpunimin dhe promovimin e resurseve tona turistike dhe ekonomike, është edhe një shtyllë e fuqishme e shkëmbimit të vlerave dhe eksperiencave tona, si një kërkesë e rëndësishme në procesin e integrimit në BE .

Gjej rastin të **falënderoj iniciatorin, z. Enes Dreškoviq, dhe Tahir Gjonbalaj, si dhe kryetarët e komunave: të Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri, të Komunës së Plavës, z. Nihat Canoviq dhe të Komunës së Junikut, z. Ruzhdi Shehu.**

Mirënjohje për pjesëmarrjen dhe bashkëbisedimin edhe për **përfaqësuesit e komunave të Deçanit, Gjakovës dhe Gucisë, respektivisht zotërinjtë Rifat Stojkaj, Adea Roka dhe Dino Mullanikiq.**

Vijojmë me intensitet punën dhe aktivitetet tona për një Tropojë që të jetë qendër e zhvillimit ekonomik, turistik dhe kulturor.

*Tropojë, 13 mars 2026*

# Manifestimi i Tretë Rajonal Dimëror

**(Tropojë, 12 mars 2026)**
**Pjesmarrës: Bashkia Tropojë dhe komunat Plavë, Guci në Malin e Zi dhe Pejë, Deçan e Junik në Republikën e Kosovës**

## GJAKOVA

Në Tropojë u mbajt ceremonia e hapjes së **Manifestimit Rajonal Dimëror "Trekufiri - një ditë, një majë, skiatorë në tri shtete"**, ku morën pjesë nga Komuna e Gjakovës: Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Adea Roka; Shefi i Kabinetit të Kryetarit të komunës, Xhavit Alijaj, Përfaqësuesi i Sektorit Ligjor në komunë, Florent Koci.

Ky aktivitet, në këto tre vite, po konsolidohet si një platformë e rëndësishme bashkëpunimi ndërmjet komunave të Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi, duke bashkuar sportin dimëror dhe turizmin malor.

Në fjalën e saj, drejtoresha Roka theksoi se **"në kulturë dhe sport kufijtë nuk kanë qenë asnjëherë pengesë", duke shtuar se është kënaqësi që Gjakova do të jetë pjesë e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.**

**Për Gjakovën pjesëmarrja në iniciativa të tilla krijon mundësi për promovimin e potencialeve turistike në nivel rajonal.**

*13 mars 2026*

**Në Manifestim përshendeti edhe Kryetari i komunës Pejë, z. Gazmend Muhaxheri, përfaqësues i Kryeqytetit të Alpeve për Republikën e Kosovës**

## Së bashku mund të bëjmë shumë për të zhvilluar turizmin, promovimin më të mirë të Bjeshkëve dhe forcimin e bashkëpunimit mes bashkive dhe qyteteve të rajonit

Nga **Nihad CANOVIĆ – Kryetar i komunës Plavë, në Malin e Zi**

Në Bajram Curr, në bashkinë e Tropojës, u mbajt Manifestimi i III-të Rajonal "Tromedja - një ditë, një samit, skiator i tre vendeve", i cili mbledh Plavën, Pejën, Deçanin, Gucinë, Junikun dhe Tropojën.

Takime si ky konfirmojnë se sa të lidhura natyrshëm janë rajonet tona dhe sa së bashku mund të bëjmë shumë për të zhvilluar turizmin, promovimin më të mirë të Bjeshkëve dhe forcimin e bashkëpunimit mes bashkive dhe qyteteve të rajonit.

Pikërisht përmes ngjarjeve si këto hapim hapësirë për përmbajtje të reja, më shumë vizitorë dhe lidhje më të forta të njerëzve në të dy anët e kufirit.

Mirënjohje Enes Dreškoviqit për iniciativën dhe bashkërendimin e këtij eventi.

*13 mars 2026*

# At Kosovatours International, we've been crafting unforgettable journeys through Eastern Europe for nearly 35 years

Tel: 001 (914) 237-6400

Kosovatours International

## Explore Destinations
## We help you pleanming your journey
## Albania * Kosova * Montenegro * Macedonia * Eastern Europe

**Services: Custom Travel Planning • Group Travel Planning • Travel Consulting • Translation Services**

Kosova Tours International
1054 McLean Avenue
Yonkers, NY 10704

Phone: (914) 237-6400

info@kosovatours.net

www.kosovatours.net

24/7 Support


# Planifiko udhëtimin tënd në plazhet alpine të Shqipërisë

Nëse të pëlqejnë liqenet akullnajore, kanionet e gdhendura nga lumenjtë apo pishinat natyrore të fshehura, veriu i Shqipërisë ka një përvojë verore që të pret - larg plazheve të mbushura me njerëz.

Këto **plazhe alpine të Shqipërisë** nuk janë thjesht vende për t'u freskuar - janë aventura të vërteta të fshehura në lugina dhe male të paprekura nga koha.



## Lumi i Kirit

Duke rrjedhur nga Alpet Shqiptare drejt qytetit të Shkodrës, Lumi i Kirit kalon përmes një kanioni dramatik që duket si një botë e fshehtë. Përgjatë rrugëtimit të tij, lumi formon pishina natyrore perfekte për not, relaks dhe madje edhe hedhje nga shkëmbinjtë.

Një nga zonat më të njohura është pranë fshatit Prekal, ku uji është i pastër dhe i ftohtë, i rrethuar nga mure shkëmbore. Është lehtësisht e arritshme me makinë dhe vetëm pak minuta në këmbë nga rruga. Lumi i Kirit është një perlë e fshehur alpine ku mali takon rrjedhën.

**Google Maps – Lumi i Kirit (Prekal)**



*Vijon në numrin e ardhshëm*

# Alpet tona kreshnike me Kryediplomatë elitarë

## Ekskluzivisht për "Gazeta e Alpeve"!

Nga **DR. JORGJI KOTE - Mjeshtër i Madh në diplomaci Anëtar i Këshillit të Ambasadorëve të Shqipërisë**

*(Vijon nga numri i kaluar)*

Në vijim të shkrimit të kaluar ku u ndalëm gjatë te vlerat dhe traditat e Alpeve tona kreshnike dhe te një prej personaliteteve të saj më rrezatuese, zoti Besnik Mustafaj, më poshtë do të shkruajmë mbi shtatë shokët dhe bashkëpunëtorët e tij por jo vetëm; edhe ata kanë lindur, janë rritur dhe edukuar në bjeshkët dhe Alpet tona të bekuara. Natyrisht me aq sa e lejon vendi do të trajtojmë vetëm pikat kulmore të jetës dhe veprimtarisë së tyre, kryesisht në fushën e diplomacisë, të lidhura ngushtë me aspektet e tjera të veprimtarisë së tyre elitare.

Por më parë, në respekt të tyre, rikujtojmë për lexuesit tanë të nderuar dhe të gjithë ata që na ndjekin se këta janë diplomatë dhe Ambasadorë veteranë dhe më të shquar në dekada.

Por, Tropoja, Kukësi, Alpet, kanë nxjerrë edhe më vonë diplomatë premtues dhe të vlerësuar karriere, të cilët gjithashtu kam patur fatin t'i njoh, t'bëhemi miq dhe të bashkëpunoj me ta brenda dhe jashtë vendit.

Konkretisht, kemi **Prof. Dr. Petrit Malaj, Ambasadorin tonë të tanishëm në Prishtinë, personalitet i mirënjohur i botës akademike dhe artit**; **zotin Arben Doçi, me përvojë 25 vjeçare në diplomaci, në Ministrinë e Jashtme, në Ambasadat tona në Moskë, në Prishtinë dhe tani Konsull i Përgjithshëm në Ulqin**; ka kryer studimet e plota edhe në Institutin "Gorki" dhe në Akademinë Diplomatike të Moskës.

Tropojani tjetër, **Ilir Neza është doktoruar në Paris për të drejtën Europiane; ka shërbyer si diplomat në Bruksel në Misionin tonë pranë BE-së nga viti 2008 – 2013; në 15 vitet e fundit në sektorë të ndryshëm në Ministrinë tonë të Jashtme; dhe tani është emëruar në Përfaqësinë tonë të Përhershme pranë OKB-së në Gjenevë**. Një njeri, koleg dhe mik i mrekullueshëm, të cilin e duan dhe rtespektojnë të gjithë. Ruaj kujtimet më të mira nga bashkëpunimi me Ilirin në Bruksel dhe më vonë.

Por Tropoja krenohet edhe me vajza diplomate me përvojë të spikatur. Këtu ia vlen të veçojmë **Almona Bajramin, e cila ka shërbyer në Ambasadat tona në Prishtinë, në Nju Jork, në Londër dhe tani së fundi si zyrtare në Drejtorinë e Protokollit të Shtetit.**

Pas këtij sqarimi të nevojshëm, le të kalojmë te 7 ambasadorët tanë të shquar.

### Ambasador Maxhun PEKA





I takon ta fillojmë me këtë emër të shquar, jo vetëm për moshën, por mbi të gjitha për përvojën dhe jetëgjatësinë diplomatike. I lindur në Has, rekrutimi i tij në diplomacinë e karrierës ishte rastësor dhe falë studimeve në Vietnamin e Veriut. Pas tyre dhe një praktike të shkurtër në Atdhe, ai u emërua diplomat në Hanoi, dhe më vonë, pasi kishte shërbyer si atashe dhe sekretar i I-rë, u emërua Ambasador atje. 12 vite diplomatike në atë vend plot sfida, bomba dhe rezistencë. Atje, në një ditë Dhjetori të vitit 1972 e mbrojti Zoti gjatë një bombardimi amerikan mbi Hanoi, kur ishte në një takim pune bashkë me Të ngarkuarin tonë me Punë atje, kolegun dhe mikun tonë të ndjerë, Qemal Rrahmanaj.

Pastaj ndodhi çudia edhe për vetë Maxhunin, siç e ka pohuar edhe në disa intervista, kur në vitin 1982 e dërguan Ambasador në Parisin kortezian, aty ku "gumëzhinte" diplomacia botërore. Gjithsesi, kjo dukej e habitshme, meqenëse Ambasador Peka vinte nga Hasi dhe kishte jetuar 15 vite në Vietnamin komunist.

Mirëpo, 6 vitet e tj në krye të Ambasadës sonë në Paris dëshmuan se emërimi i tij ishte plotësisht i merituar. Kjo falë dhuntive të Ambasadorit, natyrës së tij mondane, të mençur, të urtë, të butë dhe kalorsiake, të cilën do ta kishin zili edhe vetë parizienët. Të ishte në Paris Ambasador në ato vite të trazuara ishte sfidë e shumëanshme. Jo vetëm Parisi, por sidomos problematikat atje, vajtje-ardhjet e shpeshta të liderëve të asaj kohe për vizita mjeksore krijonin situata dhe dinamika të vështira dhe të tensionuara; atyre nuk u kishte bërë ballë as paraardhësi i tij, euriditi Misto Treska; i cili nuk lejohej të shkonte as për të paraqitur Letrat Kredenciale te Duka i Madh i Luksemburgut, vetëm e vetëm se duhej të shoqëronte një anëtar të Byrosë Politike si pacient!

Si edhe shumë e shumë të tjerë, edhe unë kam patur privilegjin ta njihja Ambasador Maxhun Peka këtu e 4 dekada më parë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, kur ai punonte në Drejtorinë e OKB-së dhe të Organizatave Ndërkombëtare. Në atë periudhë ishte rregull që kushdo që shkonte me shërbim jashtë vendit, paraqitej në MPJ për të marrë udhëzimet dhe porositë e rastit nga ekspertët e saj. Ndaj, kur shkonim për takime në organizatat ndërkombëtare, na priste Ambasadori Peka. Dallonte nga të tjerët me butësinë, mirësjelljen, qetësinë, mirëkuptimin dhe bujarinë tipike malësore, në fund të takimit na çonte te klubi për kafen miqësore.

Më vonë pata rastin ta takoja gjatë

*Vijon në faqen 15*

**Dr. Jorgji KOTE**
**Bruksel-Belgjikë**
**Diplomat. Përkthyes. Analist.**
**Përfaqësues mediatik i Bordit Botues Ndërkombëtar i "Gazeta e Alpeve" në Belgjikë dhe pranë selisë së Bashkimit Europian në Bruksel**

**Dr. Jorgji KOTE:**

* **Këshilltar dhe Ministër Këshilltar në Misionin e Shqipërisë pranë BE-së, Bruksel** (1997-2001)

* Ministër Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Berlin (2001-2005)

* Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Shtypit dhe Informacionit në MPJ Tiranë (2005-2011)

* Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Bruksel-Belgjikë (2011-2017)

* Dekoruar me titullin "Mjeshtër i Madh" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë (2022)

* Autor i librave: "Berlini pa mure"; "Fjalor Frazeologjik mbi diplomacinë", "Vetrrethim", "Diplomacia për të gjithë", "True Stories from Red Albania" (anglisht),"Negociatat, sfida e fundit e integrimit".

**Bordi Botues Ndërkombëtar i "Gazeta e Alpeve"**
**Media Rajonale-PanShqiptare-NdërBallkanike-EuroAtlantike**
**(Shqipëri-Kosovë-Mali i Zi-Lugina e Preshevës e Sanxhak-Maqedoni e Veriut-Mërgata Shqiptare në Botë)**

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Alpet tona kreshnike me Kryediplomatë elitarë

## Ekskluzivisht për "Gazeta e Alpeve"!

Nga **DR. JORGJI KOTE - Mjeshtër i Madh në diplomaci Anëtar i Këshillit të Ambasadorëve të Shqipërisë**

*Vijon nga faqja 14*

një kalimi në Pekin në aeroport, dhe pas kthimit të tij nga Pekini. Në Nëntor 2005, kur ishte Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, më priti pa hezitim në zyrë për një hall pune. Më befasoi me pritjen e përzemërt, megjithë superngarkesën, sapo ishte krijuar Qeveria e re Berisha II.

Në përfundim të karrierës së tij brilante u kthye nga Pekini, ku shërbeu disa vite me shumë sukses dhe në situata tejet të turbullta si Ambasadori ynë atje.

Në 10 vitet e fundit jemi takuar, sepse jemi edhe në Këshillin e Ambasadorëve.

Më 5 Prill 2024 promovova librin tim "Negociatat, sfida e fundit e integrimit" në Universitetin Mesdhetar dhe Ambasadori Peka më nderoi duke ardhur aty. Më kërkoi ndjesë se nuk mund të qëndronte deri në fund, sepse atë ditë kishte përvjetorin e shuarjes së shoqes së tij të jetës. Më preku thellë, ndaj e qortova pse kishte ardhur në atë ditë. Por, ky është fisniku dhe kreshniku Maxhun Peka.

U takuam disa ditë më vonë të Grand Hotel në Tiranë, ku më dhuroi librin e tij plot vlera "Një jetë në diplomaci" dhe biseduam si miq të vjetër.

Ka mbetur aktiv edhe në media me intervista intriguese dhe interesante televizive.

Ka një dakordësi absolute me kolegët dhe dashamirësit e tjerë se rrallë kemi parë një njeri dhe personalitet me një mirësi, edukatë dhe fisnikëri të tillë unikale. Nuk di kush që ai ta ketë ngritur zërin asnjëherë dhe në asnjë rrethanë. Mishërim i gjallë i vlerave dhe virtyteve më të mira të Hasit, Kukësit dhe Alpeve tona kreshnike, mik për besë dhe pa kushte në çdo kohë!

**Ambasador Islam LAUKA**

**Amb. Dr. Islam Lauka "Qytetar Nderi" i Deçanit**

Le ta them qysh në fillim se me jetën dhe personalitetin e tij, ashtu si te të gjithë kolegët dhe dashamirësit, Ambasador Islam Lauka ka vend të veçantë te shokët dhe shoqet e Shkollës së Mesme dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja që studiuam atje nga fundi i viteve '60 dhe deri në mesin e viteve '70. Ishte dy vjet mbas meje për rusisht, por duke qenë i aktivizuar me rininë u njohëm shumë shpejt dhe më mirë. Pastaj ishim shumë pak djemë në atë shkollë, jo më shumë se 50 dhe kjo e lehtësonte shumë njohjen dhe miqësinë tonë, plus aksionet, zboret, aktivitetet e përbashkëta. Lauka shquhej kudo për sjelljen dhe urtësinë e tij, zellin në mësime dhe rregullsinë në jetë. Përfundoi studimet me rezultate të shkëlqyera, si në përgjithësi edhe shokët dhe shoqet e tjera që vinin nga Veriu, këtu veçoj shokun tonë të mirë të kursit po për rusisht, **Shpend Demiraj, i cili në vitin 1992-1996 ishte edhe Kryebashkiaku i Bajram Currit**.

Në vitin 1980 - 1982 patëm rast të rrinim më gjatë, mbasi shkova dy herë në Bajram Curri, si i deleguar i KQ të BRPSH-së në fushatën e zgjedhjeve të rinisë. Islami ishte Sekretar i Parë i Rinisë i Rrethit, ndërsa zëvendës i tij ishte i ndjeri **Idriz Bajrami, një djalë bujar, entusiazt dhe me humor, por që u shua para kohe**. Vajza e tij**, Almona Bajrami është ndër diplomatet tona më të mira, me gati 20 vite përvojë; gjatë viteve 2002-2024 ishte pjesë e ekipit tonë diplomatik në Nju Jork që kontribuoi në praninë tonë në KS të OKB-së. Ka shërbyer edhe në Kosovë dhe gjetkë, duke marrë cilësitë më të mira nga i jati i ndjerë dhe e ëma e saj e fisshme**, Lumturia, krahas dellit poetik. Në ato vite, shkuam edhe në Pac dhe Zogaj, në shtëpinë e Islamit, i jati i tij i ndjerë na dha tutat sportive dhe me të gjithë vëllezërit e mirë luajtëm futboll te bahçja. Në Zogaj, shijuam një nga drekërat më të mira të jetës time, që nuk e harroj asnjëherë, edhe pse falë zanatit si diplomat kam drekuar dhe darkuar në shumë shtete dhe lokale të tjera ultraluksoze.

Në mesin e viteve 80, pasi kreu një kurs trajnues, Ambasador Lauka u emërua në MPJ; kështu u bëmë " kojshij", mbasi unë punoja në godinën ngjitur të Ministrisë së Tregtisë së Jashtme.

Kështu filloi karriera e tij e sukseshme diplomatike, plot kthesa dhe përthyerje.

Si ndër të paktët kremlinologë, në vitet 90 shërbeu në Ambasadën tonë në Moskë. Me një përvojë të pasur, imagjinoni se sapo kishim rivendosur marrëdhëniet e prishura 30 vite më parë, me kërkesa dhe sfida të panumurta. Vetëm një punëtor i palodhur si Islami mund t'i përballonte ato. Aty iu vu punës dhe fitoi doktoraturën për marrëdhënie ndërkombëtare.

Mirëpo pas kthimit nga Moska në vitin 1996 të Majtët në pushtet e lanë papunë dhe ai iu kushtua biznesit. Por pa e lënë pasdore pasionin dhe profesionin për diplomacinë, e mbante ndezur prushin e saj. Shkruante, kërkonte, botonte.

Në vitin 2005, Ministri Mustafaj e emëroi drejtor të Bashkëpunimit Rajonal. Vështirë të kishte njeri tjetër më të përshtatshëm në këtë detyrë. Sidomos në ato vite kur Kosova ishte në krye te axhendës ndërkombëtare dhe diplomacia jonë po bënte maksimumin e saj. Shumë shpejt, me riorganizimin në atë Ministri, Lauka u caktua drejtor i Përgjithshëm i Bashkëpunimit Shumëpalësh. Kjo u bë kryesisht nisur nga qëllimi për të mbështetur procesin e pavarësimit dhe njohjes ndërkombëtare të Kosovës.

Thjesht për të qenë bindës, dua të përmend se me Islamin, përveç se shokë shkolle, ishim ngjitur me zyra atje në katin e katërt të ministrisë. Veç takimeve të përditshme pune, nga mesdita dilnim të dy aty në një cep korridori dhe tymosnim nga një cigare duke shkëmbyer ide dhe mendime për sfiat dhe tematikat e asaj dite. Kjo edhe meqenëse isha në Drejtorinë e Shtypit dhe Përkthyes i të gjitha dokumentave dhe materialeve zyrtare. Krahas pranisë sonë në delegacione të ndryshme të kryesuara nga Ministri Mustafaj dhe më vonë në Greqi, SHBA, Rusi, Kroaci dhe gjetkë. Ja pse isha në dijeni të plotë të punës plot ritëm, përkushtim dhe profesionalizëm të Laukës. Kishte edhe raste kur debatonin dhe shprehnim mendime të kundërta, por kjo e forconte edhe më shumë shoqërinë dhe mirëkuptimin tonë, sepse i shërbente cilësisë së punës. Lauka me të drejtë ishte manjak lidhur me përdorimin e duhur të çdo fjale nga anglishtja. Edhe pse shumë më i lartë se unë në rangun diplomatik, Lauka sillej përherë me modesti dhe me përulje. Madje më promovonte kudo për aftësitë në diplomacinë publike dhe anglisht, çka më vinte në pozita.

Veç kësaj, në vitin 2007, Lauka botoi librin "Kosova, rast universal apo sui generis", ku argumentonte qartë, bindshëm, me referenca dhe krahasime historike dhe gjeopolitike se Kosova ishte rast krejt i veçantë dhe jo universal, siç përpiqej të argumentonte diplomacia ruse. Nisur nga interesi i madh i kësaj teme, sidomos deri në vitin 2010 kur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpalli vlefshmërinë e pavarësisë së saj, Lauka ma besoi përkthimin e shpejtë të saj; po ashtu libri u botua edhe në Arabisht me shumë jehonë dhe kërkesa nga të huajt. Ai dhe përkthimi më ndihmuan shumë për t'u njohur më mirë me dinamikat e çështjes së Kosovës. Kam lexuar shumë libra mbi këtë temë, edhe nga autorë të huaj, por libri i Laukës mbetet më i miri dhe më praktiku, bashkë me vlerën e madhe të shtuar të Parathënies nga emblematiku Noel Malcolm.

Krahas veprimtarisë aktive diplomatike brenda dhe jashtë vendit, Ambasador Lauka është marrë intensivisht për gati 30 vjet edhe me kërkime, studime dhe botime për Kosovën; nga viti 1994 me librin e tij të parë "Evolucioni dhe gjendja aktuale e Kosovës" te "Shkëputja e Kosovës nga Rusia" me 2007 dhe "Pavarësia ose dështimi i kryqëzatës ruso-serbe" më 2011. Po ashtu, është bashkëautor te libri "Shqipëria në arkivat ruse"me pedadogun e talentuar të tij dhe të disa brezave, Prof. Dr. Eshref Ymeri, dhe në dy libra të tjerë, plus katër eseve, dhjetra shkrime në të përditshmet shqiptare dhe intervista televizive kryesisht për çështjen shqiptare dhe atë të Kosovës, por edhe për tema të tjera madhore gjeopolitike.

Ndërkohë, me Ambasadorin Lauka kemi diskutuar të gjitha marrëveshjet me Greqinë. Ai ishte

*Vijon në faqen 16*

# Alpet tona kreshnike me Kryediplomatë elitarë

## Ekskluzivisht për "Gazeta e Alpeve"!

Nga **DR. JORGJI KOTE - Mjeshtër i Madh në diplomaci Anëtar i Këshillit të Ambasadorëve të Shqipërisë**

*Vijon nga faqja 15*

dhe mbetet tejet kërkues, maniak do të thoja, ca më tepër se ishte edhe i fushës; ai kërkonte saktësi absolute fjale. Por edhe dëgjonte, pranonte dhe reflektonte.

Gjatë asaj periudhe, krahas të tjerash, vura re se Lauka e ruante dhe respektonte shoqërinë e vjetër të shkollës së mesme dhe të fakultetit; ndryshe nga të tjerët, ne kishim qëndruar 7 vite rresht bashkë. Duke qenë ngjitur me zyra, aty ritakova edhe disa shokë dhe miq të vjetër që vinin të takonin Laukën. Sado i ngarkuar të ishte më punë, Lauka linte çdo gjë dhe na ftonte te kafja, duke u zhytur në kujtimet e rinisë sonë të bukur.

Për të mos përmendur bujarinë e tij të pashoqe; kudo ku shkonim jashtë me shërbim, në Pogradec, në Selanik, në Nju Jork nuk na linte të futnim dorën në xhep, por të gjithëve, të vegjël dhe të mëdhenj pa dallim na ftonte ku dhe me se të mundej pa asnjë dallim.

Në gjithë veprimtarinë e tij diplomatike, Kosova ishte në krye të çdo axhende. Me respekt për disa kolegë dhe personalitete të tjera tejet kontribuese, prapë nuk besoj se ka një diplomat tjetër që të ketë menduar, shkruar dhe vepruar më shumë se Lauka, në të gjitha planet, në Ministri, në publicistikë dhe nga viti 2009 deri më 2014 si Ambasadori ynë i parë në Kosovën e lirë. Një emërim i mirëpritur nga të gjitha krahët e politikës dhe opinioni publik. E kisha parë në disa raste, kur ishim në Kosovë në dhjetor 2006, por edhe më pârë, në Selanik, ku ish **Presidenti Sejdiu** dhe të tjerët e trajtonin me shumë konsideratë dhe respekt Laukën, madje i drejtoheshin njeri tjetrit si të ishin shokë dhe miq të vjetër.

Si Ambasador në Prishtinë veproi me dinjitet, si diplomat, si shqiptar, si patriot, mik dhe vëlla me popullin dhe personalitetet e atjeshme në periudhën më kritike të Kosovës.**Tani, nëse ka një ambasador që duhej të ishte dekoruar nga Prishtina, ky është Islam Lauka**. Gjithsesi, ne nuk kemi si t'i kërkojmë llogari Prishtinës për këtë harresë, kur Tirana zyrtare dhe e majta e saj e largoi Laukën, me gradën e lartë Ministër Këshilltar për të dytën herë dhe pa asnjë shkak nga shërbimi diplomatik; kur do të duhej ta shfrytëzonte përvojën e tij të madhe si në poste drejtuese në Ministri, ashtu dhe me mandat tjetër ambasadorial në ndonjë vend tjetër me rëndësi. Në vend që të linin të vegjetonin ende sot me mbi 10 vjet në të njëjtin vend ambasadorë të tjerë shumë më inferiorë se Lauka me shokë. Por, ai u largua me dinjitet; meqenëse ministri i atëhershëm që nuk e meriton tia përmendim as emrin, si i paedukatë që ishte, se si askush tjetër nuk na jepte as dorën, nuk deshi ta priste për ta përshëndetur Ambasadorin tonë të parë në Prishtinë, Lauka i shpalosi mendimet dhe objeksionet e tij në një letër të gjatë për të.

Gjithsesi, Islami vazhdoi punën e vet, me intervista dhe botime të tjera. Gjithmonë duke mbajtur të gjallë dhe të paprekur respektin për shokët, shoqet dhe kolegët e tij. Nuk e harroj se si në vitin 2022, një mikesha jonë e familjes, gazetarja e mirënjohur **Klementina Cenkollari** më kërkonte ta ndihmoja duke i rekomanduar për intervistë një diplomat ose ambasador, por nuk po arrinte të kapte dikë. Atëhere iu drejtova me besim të plotë Laukës; por ai më tha se nuk jepte më intervista plus ngarkesën ato ditë. Mirëpo kur i qava hallin dhe i thashë se nuk doja të ma prishte qejfin, e bëri një përjashtim për hatrin tim, ra dakord dhe dha një intervistë brilante në studio te televizioni MCN. Klementina tejet e entusiazmuar me cilësinë e intervistës nuk gjente dot fjalë për ta falenderuar, si mirënjohëse e madhe që është, por Lauka, i tha troç, «falenderoni Jorgjin, se unë vetëm zbatova urdhërin e tij si shok". Ky është Islam Lauka që edhe në shumë raste të tjera ka treguar se mbi gjithçka, edhe mbi karrieësn e tij vendos dinjitetin, shokun, mikun, zakonin, traditë e mrekullueshme e njerëzve të Alpeve tona kreshnike!

### Ambasadori Mal BERISHA

Ambasador Mal BERISHA, një tjetër përfaqësues model i Malësisë tonë kreshnike, i dekoruar nga Presidenti i Republikës «Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut».

Gjatës periudhës së monizmit, pas përfundimit të studimeve në Institutin e Lartë të Arteve, punoi kryesisht në rrethin e Krujës dhe Kurbinit me kulturën masive. Por qysh atëhere, megjithë kufizimet dhe pengesat e tjera ideologjike, Mali iu vu me pasion qëmtimit dhe mbledhjes së vlerave dhe traditave më të bukura të atyre viseve. Libri i tij i parë i kushtohet pikërisht atyre dhe Mali krenohet me të. Pata rastin të njihesha fare pak qysh në vitin 1979, mbasi e fejuara

ime krutane që më vonë u bë shoqja ime e jetës sapo kishte filluar punën si inxhiniere ndërtimi në Burizanë. Pikërisht aty, në sallën e madhe të kulturës punonte Mali plot zell dhe pasion, tejet aktiv, duke ftuar artistë teatri, estrade, varieteje për shfaqje dhe koncerte; e kishte bërë Burizanën të dëgjuar, duke iu afruar tej mase Krujës, ku në këtë të fundit punonin dy diva të kulturës krutane, të cilëve Mali u ka thurur homazhe, **Ibrahim Bërdaku**, emrin e të cilit mban sot Shtëpia e Kulturës në Krujë dhe **Ruzhdi Keraj,** kompozitori dhe drejtuesi i formacionit muzikor të Krujës.

Në vitin 1992 Mali iu bashkua diplomacisë së karrierës si Konsulli ynë në Stamboll.

Aty kreu dhe universitetin e Hacetepes për marrëdhënie ndërkombëtare dhe ishte tejet aktiv në të gjitha drejtimet.

Në vitin 1995 shkova në Stamboll me avokatin e njohur **Përparim Sanxhaku,** në një takim të Unionit Ndërparlamentar Botëror për çështjen Nano. Mali erdhi gjithë përzemërsi dhe na takoi ngrohtësisht të dyve, edhe pse në anën tjetër e pritnin deputetët e PD-së. Kur u ktheva në Tiranë bisedova me Mirën dhe ajo më tregoi edhe më shumë për aktivitetin dinamik të Malit gjatë asaj periudhe. Edhe Malin nuk e lanë ta çonte deri në fund misionin e tij diplomatik, as në Stamboll dhe as në Londër në vitin 2015; në këtë të fundit të xhelozuar nga performanca e tij brilante në të gjitha dimensionet publike, kulturore dhe qytetare. E lanë pa shofer, pa fonde, me trysni nga çdo anë, derisa "u dorëzua". Pas Londrës u kthye "në bazën" e vet, në New Jersey, ku vazhdon veprimtarinë aktive në shërbim të vendit dhe të kombit. Duke lëvizur në Kosovë, Shqipëri dhe Europë.

Ashtu si edhe gjatë viteve 90, vazhdon të jetë aktivist me shoqatat tona patriotike dhe kulturore. Me shumë kontakte dhe takime me lobet shqiptare te Kongresi dhe Senati Amerikan, me Ligën Qytetare Shqiptare Amerikane dhe Këshillin Kombëtar Shqiptaro-Amerikan, etj.

Nga viti 2000-2009 shërbeu në Prishtinë si punonjës i UNMIKUT, duke e çvendosur kësisoj veprimtarinë e tij për Kosovën në terrenin praktik atje në Prishtinë.

Në vitin 2009 u rikthye në Ministrinë e Punëve të Jashtme si Drejtor i Përgjithshëm i Bashkëpunimit Rajonal. Aty pata rastin të njihesha më nga afër me Malin, përherë kërkues dhe krijues. **Pa hequr dorë nga dashuria e parë për Donikën e tij por edhe kulturën.**

Në muajin Mars 2011 në Ministri u zhvillua një takim përkujtimor festiv me rastin e 20 vjetorit të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me SHBA-të. Me praninë e Kryeministrit, Kryetares së Kuvendit, Ministrit të Jashtëm, ambasadorit amerikan dhe shumë ambasadorëve dhe diplomatëve të tjerë.

Ashtu si Islami, edhe Mali i ruante dhe vijonte kontaktet e tij me shokët e "bukës së vjetër" të Krujës. Këtë ai e kishte bërë edhe **Ismail Bërdakun**, piktorin e shquar krutan në Itali, vëllain e Ibrahimit, legjendës krutane. Ndonëse me një dorë të gjymtuar, Ismaili, ai kishte hedhur në vaj portretet e të 44 presidentëve amerikanë, të cilat ia bëri dhuratë Ambasadës Amerikane me rastin e atij jubileu domethënës. U takuam te zyra e Malit edhe me Ismailin, u çmallëm si miq të vjetër dhe unë si dhëndër krutan. Të nesërmen pastaj shijuam takimin festiv, ku Ismaili ishte në krye bashkë me të ftuarit e nderit. Ky akt qytetar simbolik u përmend nga të gjithë folësit si shembull i përkryer i diplomacisë publike dhe të kulturës.

Në vitin 2012 Mali u emërua Ambasador në Britaninë e Madhe. Nuk e lanë më shumë se tre vjet ata

*Vijon në faqen 17*

Botimet Dardania
Tiranë-Prishtinë

Diplomaci – Marrëdhënie Ndërkombëtare

Limit.al
Portal kombëtar

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Alpet tona kreshnike me Kryediplomatë elitarë

## Ekskluzivisht për "Gazeta e Alpeve"!

Nga **DR. JORGJI KOTE** - **Mjeshtër i Madh në diplomaci Anëtar i Këshillit të Ambasadorëve të Shqipërisë**

*Vijon nga faqja 16*

të Rilindjes, por në tri vjet Mali bëri në Londër shumë më tepër se të gjithë ambasadorët që kanë shërbyer atje në 20 vitet e fundit, përfshirë pasardhësin që ndenji 9 vjet dhe këtë të sotmin. Dhe kjo në të gjitha fushat, në shtimin dhe zgjerimin e kontakteve me qeverinë, diplomacinë, Parlamentin dhe organizatat jo-qeveritare britanike. Ai i kushtoi theks të veçantë dimensionit publik, qytetar dhe kulturor të diplomacisë në atë vend me tradita. Gjatë atyre tre viteve aty u organizuan ekspozita, shfaqje me artistët tanë më të shquar si **Ermonela Jaho** dhe **Saimir Pirgu**; ditën e 100-Vjetorit të Pavarësisë sonë, në Londër u vendos me nismën dhe përpjekjet vetjake të Malit, madje edhe me shpenzimet e tij busti i Skënderbeut. Ndërkohë, Mali vazhdoi edhe atje dhe përfundoi kolanën e mrekullueshme të shkrimeve dhe botimeve dinjitoze mbi 100 Vjetorin e marrëdhënieve diplomatike me Britaninë e Madhe, për figura të ndritura amerikane dhe britanike që i kanë ardhur në ndihmë popullit dhe vendit tonë në momentet më të vështira, si Ambasadorin e parë amerikan në vendin tonë, Herman Bernstejn dhe për Charles Telford Erickson, personalitet i shquar amerikan, i cili jetoi mbi 20 vjet në Shqipëri, duke ndihmuar me bujarinë e tij popullin dhe vendin tonë. Në vitin 1921 Charles Telford Erickson hapi shkollën e famshme mekanike bujqësore në Kavajë. Veç librit që i ka dedikuar, Mali është bërë nismëtar edhe për vendosjen e bustit të tij përpara godinës së shkollës, duke bërë thirje në të gjitha format te autoritetet kompetente për ruajtjen dhe rinovimin e asaj shkolle dhe godinës së saj të amortizuar me tradita dhe gjurmë të mëdha.

E megjithatë, ish Ministrit të Jashtëm të asaj periudhe, ashtu si edhe në rastin e Ambasadorit Lauka dhe të tjerëve më pas, siç i themi ne "ia kishte zënë sytë e mira" ndaj i ra asaj me shkelm", duke treguar më të keqen e tij edhe me Ambasadorin Mal Berisha.

U largua nga Londra i përcjellë me nderime nga të zotët e shtëpisë dhe bashkëatdhetarët tanë të çdo ngjyre partiake, të cilët e kujtojnë edhe sot me respekt. Por, Mali, si Mal, i papërkulur, e vijon veprimtarinë diplomatike, me ligjërata ngado, me dokumentarë kushtuar figurave të shquara të Shqipërisë dhe Kosovës, me prononcime në media, me botime dhe përkthime të tjera me vlerë mbi vendin tonë. Në vitin 2021 botoi librin "Ambasadori i fuqisë së butë" me shumë jehonë. Po ashtu, ka përkthyer librin e spikatur të ish Kryeministrit emblematik britanik, Beniamin Disraeli "Naltësimi i Iskanderit" mbi Skënderbeun, një zbulim i ri i kohëve të fundit dhe plot të tjera. Duke na dhënë shembullin e një diplomati të angazhuar dhe me mision edhe kur nuk është në atë funksion. Kam patur rastin dhe vitin e kaluar të ligjëroj bashkë me Malin në dy seminare në Shkup dhe në Golem me përfaqësues të shoqërisë civile ku, përvoja e tij mirëpritet dhe çmohet shumë.

### Ambasador Arben ÇEJKU

Vjen nga Hasi i Kukësit edhe ai përfaqësues i më të rinjve relativisht, me një karrierë të sukseshme diplomatike, si kur ishte pjesë e sistemit dhe në 10 vitet e fundit jashtë tij. Me kualifikim modern perëndimor në Berlin, në Qendrën Garmish të studimeve europiane të sigurisë dhe gjetkë.

Pas disa viteve pune në Ministrinë e Jashtme, në vitin 2005 u caktua zv.shef i Përfaqësisë sonë në Prishtinë dhe më 2007 shef i saj në një periudhë të vështirë dhe historike për Kosovën, në prag, gjatë dhe pas shpalljes së Pavarësisë së saj. Dhe Arbeni e përballoi me sukses atë sfidë të vërtetë, duke e pasuruar jetëshkrimin e tij diplomatik tashmë edhe në terren. Për t'u zëvendësuar në vitin 2009 nga kolegu dhe miku i vet, Ambasadori Islam Lauka.

Ndërkohë, Ambasador Çejku u dërgua në Shkup, në krye të Ambasadës sonë atje, me sfida dhe probleme të një natyre tjetër. Maqedonia ende nuk e kishte marrë vehten nga ngjarjet e disa viteve më parë dhe kishte hyrë në rrugëtimin e gjatë të anëtarsimit në BE, por me shumë tematika të nxehta për komunitetin substancial shqiptar. Peisazhi politik dhe partiak edhe mes bashkëatdhetarëve shqiptare ishte më i polarizuar se kurrë. **Çejku po zëvendësonte në Shkup të ndjerët Shaban Murati dhe Vladimir Prela me goxha emër dhe trashëgimi atje, dy pesha të rënda të diplomacisë sonë.** Megjithatë, Çejku iu fut me entusiazëm punës dhe gjatë 4 viteve 2009-2013, ajo përfaqësi shënoi disa arritje mbresëlënëse në të gjitha drejtimet

**Ambasadori Çejku me ish Presidentin Hashim Thaçi**

e lartpërmendura. Veç të tjerash, pati dhe një bashkërendim shumë më të mirë dhe miqësor midis dy vendeve tona lidhur me integrimin Euro-Atlantik, ku të dyja ishim bashkëudhëtarë luajalë.

Kështu, Arbeni e afirmoi shpejt vehten si një diplomat dhe ambasador serioz dhe premtues, sidomos në kuadrin e bashkëpunimit rajonal, mbasi drejtoi dy ambasadat tona më të rëndësishme dhe problematike. Ndër të tjera, ai u shqua për operativitetin dhe pragmatizmin e tij, duke zbatuar ligjëratat dhe mësimet teorike në terrenin diplomatik. Mirëpo, **ja që ashtu si Islamin, Malin dhe të tjerë, Rilindja nuk i donte diplomatë dhe ambasadorë të tillë, sepse u bënin hije si nga Veriu dhe Alpet.** Ndaj, edhe Arbeni pas vitit 2013 pësoi fatin e shokëve të vet, mbeti i papunë. Megjithatë, ai i shfaqi edhe më mirë cilësitë dhe aftësitë e tij gjatë 13 viteve të fundit, duke themeluar dhe drejtuar Qendrën think tank për qeverisje të mirë, me jehonë dhe veprimtari të begatë, falë kontakteve me qendra prestigjioze europiane dhe amerikane. Tejet aktiv dhe fjala e tij ka peshë të veçantë në trajtimin e çështjeve rajonale, i cili është padyshim "habitati" i vet.

Kam patur rastin të jem i pranishëm vitet e fundit në disa evente të organizuara në Tiranë, në Shkup dhe në Bruksel, ku Beni ka spikatur për dijet e thella, qasjet dhe angazhimin e tij të veçantë. Është ndër diplomatët dhe Ambasadorët më të artikuluar në faqet e shtypit të shkruar dhe në televizionet tona. Dallon nga të tjerët për frymën, prakticitetin, me këmbë në tokë, me një njohje të thellë të politikës, sepse ka qenë i angazhuar më parë me të djathtën e moderuar, i thjeshtë, i kapshëm dhe i komunikueshëm në të gjitha analizat dhe parashikimet e tij. Padyshim ndër analistët më të spikatur.

Madje, vitet e fundit ka treguar aftësitë e tij edhe në publicistikë dhe si shkrimtar. Veçoj këtu librin "Sovraniteti versus integritetit" që ngjalli kërshëri dhe interesim të madh. Ndërsa vitin e kaluar na befasoi të gjithëve me romanin "Kandidati për kandidat", një libër intrigues me shumë jehonë dhe vlerësime. E "përpiva" me një frymë, madje bëra dhe një shkrim të posaçëm vlerësues në shtypin tonë të përditshëm.

Gjithsesi, me përvojën e tij tashmë akoma më të pasur, Ambasador Çejku ka ende shumë për të thënë e për të bërë në fushën e diplomacisë. Habitem me qeveritarët e sotëm që fetishizojnë të huajt dhe nënvleftësojnë tanët në organizatat ndërkombëtare, por harrojnë se në 35 vitet e fundit, ne kemi krijuar një trupë diplomatike brilante, me diplomatë dhe ambasadorë me përvojë, me disa mandate brenda dhe jashtë vendit dhe që nuk u lenë asgjë mangut të huajve dhe tanëve në ato organizata; madje, e kam thënë edhe me parë në media se tanët janë më të hajrit, sepse i njohin problemet nga brenda, nuk janë libreskë, ndaj ata duhet të kenë përparësi.

### Ambasador Kujtim MORINA

Eshtë ndër diplomatët relativisht më të rinj por me përvojë gati 20 vjeçare në shërbimin tonë diplomatik. I ardhur edhe ai nga Hasi, e la profesionin e matematikanit dhe iu fut me guxim dhe pasion fushës së diplomacisë. Kreu disa kurse trajnimi brenda dhe jashtë vendit dhe për 10 vite rresht deri në vitin 2009 punoi në terren në Kukës me përfaqësues të organizatave

*Vijon në faqen 18*

# Alpet tona kreshnike me Kryediplomatë elitarë

## Ekskluzivisht për "Gazeta e Alpeve"!

Nga **DR. JORGJI KOTE - Mjeshtër i Madh në diplomaci Anëtar i Këshillit të Ambasadorëve të Shqipërisë**

*Vijon nga faqja 17*

ndërkombëtare. Në fillim të vitit 2009 filloi punën në Ministrinë tonë të Jashtme në drejtorinë që mbulonte vendet e Europës Perëndimore dhe Gjermaninë.

Duke qenë se kisha punuar shumë vite në Ambasadën tonë në Berlin dhe pas atyre viteve përgatita dhe botova librin "Berlini pa mure" (2009) më lidhi puna me Kujtimin. Më la mbresa qysh në fillim urtësia, mençuria dhe mirësia e atij djali me shpirt poetik. E ndjeva këtë më shumë kur lexova vëllimin e tij me poezi" Kthimi i syve" që më pëlqeu shumë. I dërgova mbresat e mia për çdo vjershë dhe ai më falenderoi, i impresionuar sidomos nga fakti që përgëzimet dhe vlerësimet nuk ia kisha bërë "në bllok" dhe thjesht për mirësjellje por me një analizë të hollësishme. I tregva se veç dashamirësisë, kisha mbaruar studimet për letërsi shqipe dhe angleze dhe ai u bind. Kështu, u lidhëm edhe më shumë, duke qenë bashkë dhe në disa evente letrare. Pastaj, rrugët na ndanë,

Në korrik të vitit 2011 unë shkova diplomat në Bruksel, ndërsa Kujtimi gati dy vite më vonë u promovua me të drejtë si Ambasador në Kuvajt. Përvojë e re për të, me plot të panjohura; gjithsesi, me

qetësinë, përvojën dhe profesionalizmin e tij të spikatur ia doli mbanë shumë mirë. Punonte pa u dëgjuar, pa bujë dhe zhurmë, tamam diplomat profesionist, duke shfrytëzuar me mjeshtëri edhe "diplomacinë e butë".

Pas kthimit nga Kuvajti, ku mund fare mirë ta kishin lënë më gjatë, se është ndër rastet tejet të rralla që kthehen pa mbushur 4 vjet, vazhdon të punojë në Ministri në drejtori të ndryshme; është po ai Kujtim, i qetë, i urtë, fjalëpakët dhe punëtor i palodhur. I mban të dyja, diplomacinë dhe poezinë pranë e pranë. Ka botuar 3 vëllime të bukura poetike: 'Dehja nën mjegull' (2007) "Kthimi i syve" ( 2010) dhe "Herën tjetër" ( 2015) dhe ka bërë disa përkthime të spikatura të veprave botërore, si "Arkipelagu Kulag" të Solzhenicinit, "Këngë për emrin tim" të Linda Hogan, SHBA, "Shpirti vallëzon në djep" të Niels Hav, Danimarkë, "Antologji e poezisë Kuvajtiane' dhe 'Trëndafila Persie" - Antologji e poezise moderne Iraniane.

Më ka nderuar me praninë e tij në promovimet e botimeve të mia, siç bëri dhe në Prill 2024 për librin më të ri "Negociatat, sfida e fundit e integrimit". Padyshim që me përvojën e pasur dhe moshën relativisht të re, Kujtimi me siguri do t'i japë akoma shumë diplomacisë sonë dhe më vonë do të flasim e shkruajmë shumë më tepër për të, si i treti Ambasador i spikatur nga Hasi.

## Ambasador Flamur GASHI

**Flamur Gashi** vjen nga Peja, por gjithmonë e kam menduar si përfaqësues të denjë të Alpeve, bashkë me miqtë e tij, Islamin, Maxhunin, Çejkun dhe të tjerë.

Dikujt mund t'i duket e pabesueshme, por ja që kështu e ka jeta, ndaj është e bukur ta jetosh; them kështu, sepse në vitet 2005-2011, kur isha në Ministrinë e Jashtme, Ambasador Laukën e kisha ngjitur nga e majta, Ambasador Flamur Gashin, drejtor i Institutit të Diasporës, ngjitur nga e djathta, ndërsa Kujtim Morinën, një kat më poshtë. Kështu që ngado që të shkoja, në mos me njerin do të kryqëzohesha sa herë vija dhe dilja nga zyra.

Aty e pashë për herë të parë Flamurin, në atë fillim të vitit 2007, pa ndonjë njohje të mëparshme; vetëm se ia kisha dëgjuar emrin si drejtues i Radio Kontakt, e para në vendin tonë dhe mediave të tjera. Përpara se ta emërohej, pati llafe se demek ishte ekstremist, i ashpër, i atij dhe këtij dhe patëm një farë droje, edhe pse nuk kisha ndonjë lidhje direkte pune. Ai e zëvendësoi të ndjerin **Thimi Nika**, njeri i butë dhe i shtruar, i cili kaloi si ekspert po aty derisa doli në pension. Mirëpo, sapo u përshëndetëm për herë të parë aty para zyrave tona pamë se ishte krejt e kundërta. Njeri i qeshur, i gjallë, energjik, pozitiv dhe që tregonte kudo respekt. Më shfaqi menjëherë respektin e tij, mbasi më kishte ndjekur në përkthimet direkte me Ministrin Mustafaj.

Në vitin 2009 promovova te Pallati i Kongreseve librin tim "Berlini pa Mure" me rastin e 20-Vjetorit të shembjes së Murit të Berlinit. E kisha problem se nuk njihja shumë atëhere për shkak të shkëputjes 8-vjeçare në Bruksel dhe në Berlin dhe nuk po gjeja dot personin e duhur për të folur në ceremoninë e rastit. Ashtu e solli puna dhe Flamuri më shfaqi gatishmërinë për të më nderuar. Më gëzoi shumë, goxha drejtor, veç anës njerëzore. Dhe kështu ndodhi, erdhi atë ditë dhe foli me gjithë entusiazmin e tij sikur të ishim miq prej kohësh. Qysh atëhere u miqësuam akoma më shumë, tani jemi bashkë edhe te Këshilli i Ambasadorëve.

Më bën përshtypje edhe talenti i tij artikulues në biseda, në të folurin publik dhe në intervista, si i lindur për mikrofon dhe për ekran. Aty në Drejtorinë e Diasporës, të cilën e drejtoi deri në vitin 2010, na bënte të gjithëve përshtypje stili i tij i drejtimit në punë me ekip dhe marrëdhëniet që krijonte me bashkëpunëtorët e vet. Aty veç të ndjerit Thimi Nika ishte emblematiku i muzikës sonë moderne, **Sherif Merdani**, dhe një diplomat dhe publicist brilant si **Ylli Polovina**, etj. E shihja se ata ishin tejet të motivuar dhe ai ua vlerësonte tej mase punën. Madje në dy raste, propozoi dhe ia dëgjuan fjalën duke i dërguar ata në shtete të ndryshme për të marrë pjesë në festimin e Ditës së Pavarësisë. Po kështu u kujdes për motivimin dhe promovimin e tyre, duke filluar nga grada diplomatike. Do të thoja pa asnjë tepërim se Drejtoria e atëhershme e Diasporës mbetet në çdo drejtim dhe mbi të gjitha sa u takon rezultateve më e mira; të tjerat kanë qenë më shumë për konvejencë.

Në Qershor 2007, Ambasador Flamur Gashi u caktua si personi përgjegjës për gjithë median, me rastin e vizitës historike në Tiranë të Presidentit amerikan G.W.Bush. Një detyrë me shumë përgjegjësi, të cilën ai e kreu më së miri, me pasion, qetësi dhe ndërgjegje të lartë. Në ato ditë super të ngarkuara i forcuam edhe më shumë marrëdhëniet tona, mbasi isha pjesë e ekipit të përkthimit në takimet me shtypin.

Suksesi dhe performanca e Flamurit lidheshin me pasionin dhe studimet e tij për letërsi, dhe faktin se ai kishte kryer kurse specializimi për median, për gazetari dhe diplomaci; kryesorja, kishte goxha praktikë me mediat duke qenë edhe zv.Drejtor i Autoritetit të Kontrollit të Medias Shqiptare.

Këtë pune brilante dhe me pasion Ambasador Gashi e bëri edhe në Bosnie si ambasadori ynë i parë atje, në vitin 2010 deri më 2013. Ai ishte njeri i fjalës dhe i veprës, i aksionit, i kontakteve. Shumë shpejt emri dhe puna e tij u bënë të njohura në Sarajevë; ku kishte gjetur edhe një seli tejet të përshtashme dhe tërheqëse. U shqua në shumë fusha si diplomat profesionist por edhe për diplomacinë efektive publike, kulturore dhe qytetare.

Për atë punë shembullore, Flamuri u laurua me Çmimin si "Ambasadori më i mirë në Europën Qëndrore dhe Lindore"

*Vijon në faqen 19*

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Alpet tona kreshnike me Kryediplomatë elitarë

## Ekskluzivisht për "Gazeta e Alpeve"!

Nga **DR. JORGJI KOTE - Mjeshtër i Madh në diplomaci Anëtar i Këshillit të Ambasadorëve të Shqipërisë**

*Vijon nga faqja 18*

nga një agjenci e pavarur diplomatike.

Dhe, megjithatë, edhe Flamuri si shokët dhe kolegët e tij pësoi të njëjtin fat të keq, u shpall pa asnjë arsye praktikisht "i padëshiruar" vetëm se ishte nga Veriu dhe i djathtë. Ndonëse **ministri që nuk e donte as Flamurin vinte nga një familje shkodrane me emër, por ai i kishte tradhëtuar me kohë traditat e saj të shquara, veç emrit në gjendjen civile. Mirëpo, duke parë pengesat me Malin, Islamin, Arbenin, këtë radhë Bushatlliu famëkeq përdori taktikën tjetër të turpshme; ndonëse Ambasada kishte vetëm tre vite që ishte çelur, u vendos mbyllja e habitshme e saj, vetëm e vetëm që të ikte Flamuri.**

Por, Flamuri, si patriot i vërtetë, siç e ka treguar në librin e tij emocionues me kujtime, nuk e kishte fare hallin te vehtja, familja dhe fati i tij, por te halli që e zuri me kolegët dhe të zotët e shtëpisë se si tua shpjegonte këtë absurditet, dhe sidomos detyrimet e shumta edhe financiare për skak të godinës dinjitoze që mbeteshin pezull dhe askush nuk donte tia dinte. Se sa i gabuar ishte ai vendim, këtë e tregoi fakti se as 10 vite më vonë, e rihapën ambasadën tonë në Sarajavë, pa harruar ta quajnë si zakonisht sukses të diplomacisë sonë!

Natyrisht që Flamuri nuk ngeli pa punë. Vazhdoi për 10 vite Këshilltar Diplomatik i dy Presidentëve të Republikës dhe pastaj me komunitetin televiziv në Prishtinë. Tani vazhdon po aty si pedagog universitar dhe po mbron doktoraturën në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Është aktiv në Këshillin e Ambasadorëve dhe i pranishëm si përherë me fjalën e vet të çmuar në media dhe televizione në Tiranë dhe në Prishtinë, po ai Flamur, siç ka edhe emrin.

## Ambasador Mehmet ELEZI

Mehmet Elezi është figurë dhe personalitet i mirënjohur nga Tropoja, përpara dhe pas viteve 90. Hijerëndë, serioz, i mendueshëm, i thellë, i lirë në mendimin dhe gjykimin e tij. Brilant në fushën e tregimit, novelës, poezisë, publicistikës, gazetarisë, përkthimit dhe gjuhësisë. Faktet dhe veprat e tij flasin më mirë dhe më shumë se çdo fjalë. Në fondin e tij të artë të krijimtarisë përfshihen 18 romane, novela dhe tregime, 4 vëllime poetike, 9 esera, 11 studime gjuhësore, të cilat kanë kulmuar me "Fjalorin e Gjuhës Shqipe" me 41.000 fjalë, që nuk ishin përfshirë në fjalorin zyrtar (2006) dhe me dhjetra shkrime me tematika të ndryshme në shtypin tonë të përditshëm. Gazetar elitar për shumë vite deri në Kryeredaktor, drejtues i rinisë, studiues dhe kërkues dhe së fundi Ambasador i spikatur.

Habitem se si nuk më është dhënë rasti të njihem me të nga afër.

Me bashkëshorten e tij, Dashamirën, kemi qenë në Shkollën e Mesme dhe Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ku ajo studionte frëngisht, vajzë nga Berati **në mos gaboj,** vërtet zonjë qysh atëhere.

Por prapë kam ndjesinë se e njoh Ambasador Elezin, falë ndjekjes me simpati të gjithë krijimtarisë dhe aktivitetit të tij, te ZP-ja dhe te rinia si drejtuesi i saj kryesor në vitet 80.

Ashtu si shokët e vet, Besniku, Biberaj e të tjerë, Mehmeti ka qenë njeri i lirë në botën e vet edhe në kohët më të zymta, pa fanatizëm partiak, pa bujë dhe zhurmë. Një minierë e vërtetë vlerash me shumë galeri të larmishme nga ku kanë dalë thesare të çmuara letrare, artistike dhe shkencore. **Ndaj bënë si bënë e larguan ata të atëhershmit në vitin 1990, se ishte i ri, nuk ishte nga ata të luftës, nuk kishte miq dhe nuk ua plotësonte tekat partiakëve dhe drejtuesve të atëhershëm.** Por Mehmeti iku pa zhurmë, pa ankesa dhe në prag të agimit të demokracisë; i ka treguar më vonë këto incidente dhe kujtime edhe me doza të lehta humori dhe realizëm, jo me inat dhe mllef, por me keqardhje dhe si mësim për të tjerët, për të ardhmen. **Vlen të theksohet se Mehmet Elezi është i pari që kërkoi hapur në forumin më të lartë të partisë komuniste vendosjen e pluralizmit politik.**

Jeta e tij vazhdoi me pasionin dhe përkushtimin ndaj medias. Nga viti 1992 deri më 1996 në gazetën e pavarur "Bashkimi" dhe kolumnist për gazetën shqiptaro-amerikane "Illyria" në New-York. Gjatë periudhës së viteve 1996-2005 ishte drejtor i Institutit të Studimeve Ndërkombëtare dhe Strategjike, një think tank jo-qeveritar i krijuar prej tij; po ashtu ka qenë botues i revistës tre mujore në anglisht "The Balkan Analyst" dhe pedagog me kohë të pjesshme në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës.

E tepërt të zgjatem te krijimtaria e tij e larmishme, ca më tepër te "Gazeta e Alpeve" ku Mehmeti është vërtet si i shtëpisë, sepse veprat e tij njihen dhe flasin vetë.

Pastaj, në vitin 2006 deri më 2013 ai drejtoi Ambasadën tonë në Bernë, në Konfederatën Zvicerane. Edhe atje u shqua për qetësinë tij, arsyen, mendimet dhe demarshet diplomatike për nxitjen dhe promovimin e marrëdhënieve dypalëshe me Zvicrën. Por, edhe ndihmën dhe mbështetjen e saj të fuqishme, si nyje e diplomacisë dhe negociatave ndërkombëtare, në realizimin e objektivave tona shumëpalëshe dhe shumë e rëndësishme për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ishte i veçantë si ambasador, as politik, as i karrierës; dallonte nga gjithë të tjerët se i përshtatej më mirë se kushdo kushteve në një vend si Zvicra. Nuk ishte si ca të tjerë të fortë, me miq dhe nga politika, as për konvejencë; me një CV të pasur në shumë fusha, bindëse, në të gjitha aspektet, me një besueshmëri të lartë, çka i jepte akses të madh diplomatik, faktori më i rëndësishëm për një performancë të sukseshme në shërbimin e jashtëm.

Gjatë kohës që ishte në Bernë, isha diplomat në Bruksel dhe në takimet e ndryshme me kolegët tanë zviceranë, ata na shprehnin mbresat më të mira për punën dhe personalitetin e Ambasador Mehmet Elezit në Bernë.

Puna e tij u përkthye dhe u shpërblye me shtimin e ndjeshëm të shkëmbimeve politike, ekonomike, kulturore dhe të ndihmës ekonomike zvicerane.

Më konkretisht, më 20 Dhjetor 2007, në prani të Presidentit të Konfederatës Zvicerane, Rolf Alther, Ambasadori Elezi shpalli themelimin e Shoqatës së Bashkëpunimit Shqiptaro-Zviceran, siç shihet edhe në foton e mëposhtëme.

Po ashtu, ndihma zvicerane u shtua në drejtim të Kosovës, ku Mehmeti kishte bashkëpunim të shkëlqyer me Ambasadën e Kosovës atje; qënia e tij nga veriu ishte natyrisht vlerë e shtuar në këtë drejtim.

Padyshim që pas mbarimit të misionit të tij diplomatik në Zvicër, Ambasador Mehmet Elezi mund të kontribuonte akoma më shumë në diplomacinë tonë, qoftë në MPJ dhe sidomos në ndonjë përfaqësi tonë nga më të rëndësishmet. Mirëpo kjo, siç e thamë edhe më lart, nuk përputhej me ideologjinë e atyre që drejtonin diplomacinë tone në ato vite. **Ashtu si etërit e tyre ideologjikë 23 vite më parë, ata u ngutën ta nxjerrin Mehmetin në pension, edhe pse nuk e kishte ende moshën; ndonëse në të njëjtën kohë ata dërgonin Ambasadorë të tjerë pensionistë të stazhionuar dhe pa asnjë lidhje me diplomacinë.**

Gjithsesi, Mehmet Elezi me krenarinë e tij vazhdoi të punonte në "mbretërinë" e tij, duke na dhuruar vepra të spikatura, me jehonë në politikën, median dhe studimet tona gjuhësore. Respekt dhe CHAPEAU Ambasador!

*Bruksel, mars 2026*

# Nga Amerika me shpirt e zemër për Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

**Nga Agim ALIÇKAJ**
**Drejtor Ekzekutiv i Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane**

Sakrifica heroike e komandantit legjendar Adem Jashari dhe e 56 anëtarëve të familjes së tij nuk ishte vetëm një tragjedi e madhe kombëtare. Ajo ishte momenti kur historia mori drejtim tjetër. Në Prekaz shpërtheu vullkani i lirisë së Kosovës - një vullkan që nuk mund të shuhej më. Një vullkan, flakët e të cilit përpinë klikën vrasëse të Serbisë gjenocidale

Flijimi i familjes Jashari tronditi ndërgjegjen e gjithë kombit shqiptar. Nga ai moment, liria nuk ishte më një ëndërr, por një betim. Shqiptarët nga të gjitha trojet u ngritën në këmbë. Vullnetarë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe diaspora shqiptare në Evropë e Amerikë iu bashkuan luftës për çlirim.

Në mesin e tyre ishin edhe shumë shqiptaro-amerikanë, të cilët krijuan Brigadën legjendare "Atlantiku". Ata lanë jetën e sigurt në Amerikë dhe u kthyen në vendlindje për të luftuar për lirinë e Kosovës. Ishte një dëshmi e jashtëzakonshme se lidhja e diasporës me atdheun nuk është vetëm emocionale, por edhe sakrificë reale.

Në të njëjtën kohë, në Shtetet e Bashkuara zhvillohej një betejë tjetër - beteja diplomatike për të vërtetën e Kosovës. Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane, nën udhëheqjen e ish-kongresmenit me prejardhje arbëreshe Joseph DioGuardi dhe këshilltares për çështje ballkanike Shirley Cloyes DioGuardi, punoi pa pushim për ta bërë të dëgjohej zëri i shqiptarëve në Washington.

Falë përpjekjeve të tyre të palodhshme, dyert e institucioneve amerikane u hapën për Kosovën, ndërsa propaganda e regjimit kriminal të Sllobodan Millosheviqit filloi të shembej përballë fakteve.

Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane ishte ndër organizatat e para që doli publikisht në përkrahje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në fillim të vitit 1998. Në Washington u organizuan protesta të mëdha para Shtëpisë së Bardhë dhe në Capitol Hill, ku morën pjesë senatorë dhe kongresmenë të njohur amerikanë.

Në mars të vitit 1998, vetëm pak ditë pas masakrës së familjes Jashari, në Kongresin Amerikan u zhvillua një dëgjim i rëndësishëm për Kosovën. Aty u përball dhe u hodh poshtë përpjekja për ta shpallur UÇK-në organizatë terroriste. Argumentet ishin të qarta: terroristë nuk janë ata që mbrojnë shtëpitë dhe familjet e tyre nga një ushtri pushtuese.

## Adem Jashari - simbol i përjetshëm i Lirisë

Historia e popullit shqiptar është histori rezistence. Për shekuj me radhë, shqiptarët janë përballur me pushtime dhe padrejtësi, por kurrë nuk e kanë humbur shpirtin e lirisë.

Figura e Adem Jasharit përfaqëson kulmin e kësaj tradite. Ai i tregoi botës se liria nuk negociohet dhe nuk blihet - ajo fitohet me sakrificë.

Të rrethuar nga një ushtri e armatosur deri në dhëmbë, Adem Jashari dhe familja e tij nuk u dorëzuan. Ata luftuan deri në frymën e fundit. Burra, gra dhe fëmijë qëndruan së bashku përballë një makinerie të egër ushtarake.

Në atë qëndresë heroike u shkrua një nga kapitujt më të ndritur të historisë shqiptare. Prekazi u bë simbol i sakrificës dhe i guximit. Nga ai moment, lufta për lirinë e Kosovës mori një dimension të pakthyeshëm.

Flijimi i familjes Jashari u bë thirrje për mijëra shqiptarë që të bashkoheshin në luftën çlirimtare.

## Amerika - aleati vendimtar i Kosovës

Historia moderne e Kosovës nuk mund të kuptohet pa rolin vendimtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në një kohë kur Evropa shpesh hezitonte të përballej me agresionin dhe hegjemonizmin ruso-serb në Ballkan, Amerika u bë zëri më i fuqishëm në mbrojtje të lirisë dhe të drejtave të shqiptarëve.

Mbështetja amerikane nuk ishte rastësi. Ajo ishte rezultat i përpjekjeve të diasporës shqiptare, i punës së palodhshme lobuese dhe i të vërtetës që nuk mund të fshihej më nga propaganda serbe.

Edhe sot, është e qartë se pa rolin aktiv të Shteteve të Bashkuara nuk mund të ketë stabilitet afatgjatë në Ballkan dhe as zgjidhje të drejtë për Kosovën.

Prandaj marrëdhënia strategjike me Amerikën mbetet një nga shtyllat më të rëndësishme të politikës dhe të së ardhmes së Kosovës.

## Amaneti i të rënëve për liri

Adem Jashari, familja e tij, anëtarët e familjes legjendare Haradinaj dhe mijëra dëshmorë të tjerë të luftës për liri nuk ranë vetëm për të çliruar një territor. Ata ranë për dinjitetin dhe të ardhmen e një kombi.

Ata e paguan lirinë me jetën e tyre.

Amaneti i tyre është i qartë: liria duhet ruajtur, shteti duhet forcuar dhe interesat kombëtare nuk duhet të tradhtohen kurrë.

Amaneti i tyre i fundit ishte BASHKIMI KOMBËTAR.

Prekazi nuk është vetëm një vend në hartë. Prekazi është një betim.

Një betim se liria e Kosovës nuk do të dorëzohet kurrë.

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# From America with soul and heart for the Epic of Kosova Liberation Army

**By Agim ALIÇKAJ**
**Executive Director of the Albanian-American Civic League**

The heroic sacrifice of the legendary commander Adem Jashari and 56 members of his family was not only a great national tragedy. It was the moment when history took a different direction. In Prekaz, the volcano of Kosova's freedom erupted - a volcano that could no longer be extinguished. A volcano whose flames burned the murderous clique of genocidal Serbia.

The sacrifice of the Jashari family shook the conscience of the entire Albanian nation. From that moment on, freedom was no longer a dream, but an oath. Albanians from all territories rose to their feet. Volunteers from Kosova, Albania, North Macedonia, Montenegro, and the Albanian diaspora in Europe and America joined the struggle for liberation.

Among them were many Albanian-Americans who created the legendary **"Atlantic" Brigade**. They left their secure lives in America and returned to their homeland to fight for Kosova's freedom. It was extraordinary proof that the diaspora's connection with the homeland is not only emotional, but also a real sacrifice.

At the same time, another battle was taking place in the United States — the diplomatic battle for the truth about Kosova. The Albanian-American Civic League, under the leadership of former congressman of Arbëresh origin Joseph DioGuardi and Balkan affairs adviser Shirley Cloyes DioGuardi, worked tirelessly to make the voice of Albanians heard in Washington.

Thanks to their relentless efforts, the doors of American institutions opened for Kosova, while the propaganda of Slobodan Milošević's criminal regime began to collapse in the face of facts.

The Albanian-American Civic League was among the first organizations to publicly support the Kosova Liberation Army at the beginning of 1998. Large protests were organized in Washington in front of the White House and on Capitol Hill, where well-known American senators and congressmen participated.

In March 1998, only a few days after the massacre of the Jashari family, an important hearing on Kosova was held in the U.S. Congress. There, the attempt to declare the KLA a terrorist organization was confronted and rejected. The arguments were clear: terrorists are not those who defend their homes and families from an occupying army.

## Adem Jashari – Eternal Symbol of Freedom

The history of the Albanian people is a history of resistance. For centuries, Albanians have faced occupations and injustices, but they have never lost the spirit of freedom.

The figure of Adem Jashari represents the peak of this tradition. He showed the world that freedom is not negotiated and cannot be bought — it is won through sacrifice.

Surrounded by a heavily armed army, Adem Jashari and his family did not surrender. They fought until their last breath. Men, women, and children stood together against a brutal military machine.

In that heroic resistance, one of the brightest chapters of Albanian history was written. Prekaz became a symbol of sacrifice and courage. From that moment on, the war for Kosova's freedom took on an irreversible dimension.

The sacrifice of the Jashari family became a call for thousands of Albanians to join the liberation struggle.

## America - Kosova's Decisive Ally

The modern history of Kosova cannot be understood without the decisive role of the United States of America.

At a time when Europe often hesitated to confront Russian-Serbian aggression and hegemonism in the Balkans, America became the strongest voice in defense of the freedom and rights of Albanians.

American support was not accidental. It was the result of the efforts of the Albanian diaspora, tireless lobbying work, and the truth that could no longer be hidden by Serbian propaganda.

Even today, it is clear that without the active role of the United States there can be no long-term stability in the Balkans nor a just solution for Kosova.

Therefore, the strategic relationship with America remains one of the most important pillars of Kosova's politics and future.

## The Testament of Those Who Fell for Freedom

Adem Jashari, his family, members of the legendary Haradinaj family, and thousands of other martyrs of the freedom struggle did not fall just to liberate a territory. They fell for the dignity and future of a nation.

They paid for freedom with their lives.

Their legacy is clear: freedom must be protected, the state must be strengthened, and national interests must never be betrayed.

Their final testament was **NATIONAL UNIFICATION**.

Prekaz is not just a place on the map.

Prekaz is an oath.

An oath that the freedom of Kosova will never be surrendered.

# Konventa Greko-Turke e Lozanës e vitit 1923 dhe përzënia e shqiptarëve në Turqi

Nga **dr. Nikollë LOKA**

**KONVENTA GREKO-TURKE E LOZANËS E VITIT 1923**

*(Vijon nga numri i kaluar)*

**Neni 10**

Likuidimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që u përkasin personave që kanë lënë tashmë territoret e Palëve të Larta Kontraktuese dhe që, sipas nenit 3 të kësaj Konvente, konsiderohen si pjesë e shkëmbimit të popullsive, do të kryhet në përputhje me nenin 9 dhe pavarësisht nga çdo masë e çfarëdo natyre që, sipas ligjeve dhe rregulloreve të nxjerra që nga 18 tetori 1912 në Greqi dhe Turqi, ka sjellë kufizime mbi të drejtën e pronësisë, si konfiskimi, shitja e detyruar apo masa të tjera. Nëse pasuritë e përmendura janë prekur nga masa të tilla, vlera e tyre do të përcaktohet nga Komisioni i nenit 11 sikur këto masa të mos ishin zbatuar.

Sa u përket pasurive të shpronësuara, Komisioni i Përzier do të kryejë një rivlerësim të pasurive të shpronësuara që nga 18 tetori 1921, të cilat u përkasin personave të përfshirë në shkëmbim dhe që ndodhen në territoret e shkëmbimit. Komisioni do të caktojë një dëmshpërblim që do të riparojë dëmin e konstatuar. Shuma e këtij dëmshpërblimi do të regjistrohet në favor të pronarëve dhe në debit të qeverisë në territorin e së cilës ndodhen pasuritë e shpronësuara.

Në rast se personat e përmendur në nenet 8 dhe 9 nuk kanë përfituar të ardhurat e pasurive nga të cilat janë privuar, atyre do t'u sigurohet kthimi i vlerës së këtyre të ardhurave mbi bazën e rendimentit mesatar para luftës, sipas mënyrave që do të përcaktojë Komisioni i Përzier.

Në likuidimin e pasurive vakëfe në Greqi dhe të të drejtave që rrjedhin prej tyre, si dhe të fondacioneve analoge që u përkasin grekëve në Turqi, Komisioni i Përzier do të mbështetet në parimet e përcaktuara në traktatet e mëparshme, me qëllim mbrojtjen e plotë të të drejtave dhe interesave të këtyre fondacioneve dhe të individëve të interesuar.

**Neni 11**

Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, do të krijohet një Komision i Përzier me seli në Turqi ose në Greqi, i përbërë nga katër anëtarë për secilën Palë të Lartë Kontraktuese dhe nga tre anëtarë të zgjedhur nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve midis shtetasve të fuqive që nuk kanë marrë pjesë në luftën e viteve 1914–1918. Kryesia e Komisionit do të ushtrohet me radhë nga secili prej këtyre tre anëtarëve neutralë.

Komisioni i Përzier do të ketë të drejtë të krijojë nënkomisione në vendet ku e sheh të nevojshme, të përbëra nga një anëtar turk, një anëtar grek dhe një kryetar neutral i caktuar nga vetë Komisioni. Komisioni do të përcaktojë kompetencat e deleguara.

**Neni 12**

Komisioni i Përzier do të ketë për detyrë të mbikëqyrë dhe lehtësojë emigrimin e parashikuar nga kjo Konventë dhe të kryejë likuidimin e pasurive sipas neneve 9 dhe 10.

Ai do të përcaktojë rregullat e emigrimit dhe të likuidimit.

Në përgjithësi, Komisioni i Përzier do të ketë të gjitha kompetencat për të marrë masat e nevojshme

për zbatimin e kësaj Konvente dhe për të vendosur mbi të gjitha çështjet që mund të lindin prej saj. Vendimet do të merren me shumicë votash.

Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me pasuritë, të drejtat dhe interesat që do të likuidohen do të zgjidhen përfundimisht prej tij.

**Neni 13**

Komisioni i Përzier do të ketë kompetencë të plotë për të kryer vlerësimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që duhet të likuidohen, duke dëgjuar palët e interesuara ose pasi ato të jenë thirrur rregullisht për t'u dëgjuar.

Baza e vlerësimit do të jetë vlera e pasurive në monedhë ari.

**Neni 14**

Komisioni do t'i dorëzojë pronarit të interesuar një deklaratë që vërteton shumën që i detyrohet për pasuritë nga të cilat është zhveshur, pasuri që do të mbeten në dispozicion të qeverisë në territorin e së cilës ndodhen.

Shumat e përcaktuara do të përbëjnë një borxh të qeverisë së vendit ku është kryer likuidimi ndaj qeverisë së vendit nga i cili varet emigranti. Ky i fundit, në parim, do të marrë në vendin ku emigron pasuri me vlerë dhe natyrë të barabartë me ato që ka lënë.

Çdo gjashtë muaj do të hartohet një llogari e shumave që qeveritë përkatëse i detyrohen njëra-tjetrës. Në likuidimin përfundimtar, nëse ka barazi, llogaritë do të kompensohen. Nëse pas kompensimit një qeveri mbetet debitore, ajo do të paguajë shumën e mbetur. Në rast se kërkon afate, Komisioni mund t'i japë, me kusht që pagesa të kryhet maksimumi brenda tre vjetësh, me interesa të caktuara nga Komisioni.

Nëse shuma është shumë e madhe dhe kërkon afate më të gjata, qeveria debitore do të paguajë menjëherë deri në 20% të shumës dhe për pjesën tjetër do të emetojë tituj huaje me interes, të amortizueshëm brenda maksimumit 20 vjetësh. Garancitë do të përcaktohen nga Komisioni ose, në mungesë marrëveshjeje, nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve.

**Neni 15**

Për të lehtësuar emigrimin, shtetet e interesuara do t'i japin fonde paraprake Komisionit të Përzier, sipas kushteve të përcaktuara prej tij.

**Neni 16**

Qeveritë e Turqisë dhe të Greqisë do të merren vesh me Komisionin e Përzier për të gjitha çështjet që lidhen me njoftimet ndaj personave që duhet të largohen dhe me portet e nisjes.

Palët angazhohen që të mos ushtrojnë asnjë presion të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi popullsitë që do të shkëmbehen dhe që emigrantët të mos i nënshtrohen taksave të jashtëzakonshme. Banorët e rajoneve të përjashtuara nga shkëmbimi sipas nenit 2 do të gëzojnë lirisht të drejtat dhe pronat e tyre.

**Nenet 17–19**

Shpenzimet e Komisionit do të mbulohen nga qeveritë e interesuara.

Palët do të përshtatin legjislacionin e tyre për zbatimin e Konventës.

Konventa do të ketë të njëjtën fuqi sikur të ishte pjesë e Traktatit të Paqes me Turqinë dhe do të hyjë në fuqi pas ratifikimit.

**Nënshkruar në Lozanë, më 30 janar 1923.**

Kjo Konventë do të ketë të njëjtën fuqi dhe vlerë, për Palët e Larta Kontraktuese këtu të përmendura, sikur të ishte e përfshirë në Traktatin e Paqes që do të lidhet me Turqinë. Ajo do të hyjë në fuqi menjëherë pas ratifikimit të atij traktati nga të dyja Palët e Larta Kontraktuese.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, Plenipotenciarë, fuqitë e plota të të cilëve janë njohur si të rregullta dhe të vlefshme, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Lozanë, më tridhjetë janar një mijë e nëntëqind e njëzet e tre, në tre kopje origjinale, nga të cilat një do t'i dorëzohet Qeverisë helenike, një Qeverisë së Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë dhe kopja e tretë do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së Republikës Franceze, e cila do t'u japë kopje të vërtetuara Fuqive të tjera nënshkruese të Traktatit të Paqes me Turqinë.

**(L.S.) E. K. VENIZELOS**
**(L.S.) D. CACLAMANOS**
**(L.S.) ISMET**
**(L.S.) Dr RIZA NOUR**
**(L.S.) HASSAN**

**Protokoll**

Plenipotenciarët turq të nënshkruar më poshtë, të autorizuar rregullisht, deklarojnë se, pa pritur hyrjen në fuqi të Konventës së lidhur sot me Greqinë lidhur me shkëmbimin e popullsive greke dhe turke, dhe me përjashtim nga neni i parë i kësaj Konvente, Qeveria turke, që nga momenti i nënshkrimit të Traktatit të Paqes, do të lirojë burrat e aftë për punë të përmendur në nenin 4 të Konventës së sipërpërmendur dhe do të sigurojë largimin e tyre.

**Bërë në tre kopje në Lozanë, më tridhjetë janar një mijë e nëntëqind e njëzet e tre.**

**ISMET**
**Dr RIZA NOUR**
**HASSAN**
**mjp.univ-perp.fr.**

**Grèce, Turquie, minorités, échange des populations 1923, Digithèque MJP**

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Lartësia e Tij Mbretërore, Leka II, Princ i Shqiptarëve, martohet me Zonjushën Blerta Celibashi, në Kështjellën Apponyi në Sllovaki, rezidencë e familjes fisnike të Lartmadhërisë së Saj, Mbretëreshës Geraldina

## (Komunikatë zyrtare)

**Oborri Mbretëror Shqiptar ka kënaqësinë e veçantë të njoftojë martesën e Lartësisë së Tij Mbretërore, Leka II, Princ i Shqiptarëve, me Zonjushën Blerta Celibashi.**

**Martesa u kremtua në një ceremoni private, duke ruajtur karakterin e saj intim dhe solemn.**

**Fotografia zyrtare e publikuar me këtë rast është realizuar në Kështjellën Apponyi në Sllovaki. Përzgjedhja e këtij mjedisi historik, rezidencë e familjes fisnike të Lartmadhërisë së Saj Mbretëreshës Geraldinë, u bë për të nderuar trashëgiminë e saj të çmuar dhe origjinën hungareze, e cila mbetet një pjesë e pandarë e historisë së Familjes Mbretërore Shqiptare.**

**Pas martesës, Princeshë Blerta do të mbajë mbiemrin e familjes Zogu dhe titullin Princeshë e Shqiptarëve.**

**Familja Mbretërore e ndan këtë lajm të gëzueshëm me kombin shqiptar dhe me miqtë e saj anembanë botës.**

**OBORRI MBRETËROR SHQIPTAR**

*Tiranë, 15 mars 2026*

Komunikatë Zyrtare

Oborri Mbretëror Shqiptar ka kënaqësinë e veçantë të njoftojë martesën e Lartësisë së Tij Mbretërore, Leka II, Princ i Shqiptarëve, me Zonjushën Blerta Celibashi.

Martesa u kremtua në një ceremoni private, duke ruajtur karakterin e saj intim dhe solemn.
Fotografia zyrtare e publikuar me këtë rast është realizuar në Kështjellën Apponyi në Sllovaki. Përzgjedhja e këtij mjedisi historik, rezidencë e familjes fisnike të Lartmadhërisë së Saj Mbretëreshës Geraldinë, u bë për të nderuar trashëgiminë e saj të çmuar dhe origjinën hungareze, e cila mbetet një pjesë e pandarë e historisë së Familjes Mbretërore Shqiptare.

Pas martesës, Princeshë Blerta do të mbajë mbiemrin e familjes Zogu dhe titullin Princeshë e Shqiptarëve.

Familja Mbretërore e ndan këtë lajm të gëzueshëm me kombin shqiptar dhe me miqtë e saj anembanë botës.

Oborri Mbretëror Shqiptar
Tiranë, 15 mars 2026

Official Communiqué

The Royal Court has the distinct pleasure of announcing the marriage of His Royal Highness Crown Prince Leka of the Albanians to Miss Blerta Celibashi.

The marriage was celebrated in a private ceremony, preserving its intimate and solemn character.

The official photograph released on this occasion was taken at the Château Apponyi in Slovakia. It was the historic residence associated with Her Majesty Queen Geraldine of the Albanians, born into the Hungarian noble family of Apponyi, whose legacy remains a cherished part of the Royal Family's history.

Following the marriage, Princess Blerta will bear the family name Zogu and the title Princess of the Albanians.

The Royal Family shares this joyful news with the Albanian nation and with friends around the world.

Issued by the Albanian Royal Court, Tirana
15 March 2026

# Një zonjë e veçantë nga Nikaj-Mërturi

Sot dua t'ju flas për një zonjë të veçantë nga Nikaj–Mërturi i Malësisë së Gjakovës.

Ajo quhet Drita Mhill Progni.

Drita rrjedh nga një familje me tradita të larta atdhetare, me besë, burrni e fisnikëri, ashtu siç njihen përgjithësisht nikaj-mërturasit.

Unë pata rastin ta njoh nga afër kur isha i ri, rreth viteve '80. Në atë kohë Drita ishte Sekretare e Parë e Komitetit të Rinisë në rrethin e Tropojës.

Fillimisht unë isha aktivist, e më pas instruktor në aparatin e Rinisë.

Drita ishte një intelektuale e shquar e kohës. Ishte shumë e thjeshtë, njeri me shpirt e zemër të madhe. U fliste njerëzve në rrugë, të njohur e të panjohur, me shumë thjeshtësi në komunikim.

Asnjëherë nuk na shihte si vartës, por na trajtonte me respekt, sikur të ishim familjarë të saj.

Përveç kësaj, ajo kishte edhe një familje shembullore. Bashkëshorti i saj, Nik Progni, ka shërbyer si oficer policie në detyra të ndryshme drejtuese. Edhe fëmijët e tyre kanë qenë shembull në shkollë dhe në shoqëri.

Nga rinia, Drita kaloi më pas në kryesinë e gruas, ku shërbeu si kryetare e saj.

Pas viteve '90 punoi në Prokurorinë e Përgjithshme, me të njëjtin përkushtim ndaj detyrës dhe me të njëjtën sjellje të mirë ndaj njerëzve.

Ajo gjithmonë ka qenë e heshtur ndaj mediave dhe asnjëherë nuk ka kërkuar t'i bëjë publicitet vetes.

Drita Progni, në çdo moment, rrezatonte mirësi dhe dritë - ashtu siç e ka edhe emrin.

Si ajo ka pasur dhe ka shumë gra të zonja në Tropojë dhe në gjithë Shqipërinë, por fatkeqësisht ne shkruajmë pak dhe i evidentojmë rrallë vlerat dhe kontributet e tyre.

I uroj nga zemra gjitha të mirat Dritës dhe familjes së saj!

Me respekt,
**Avdyl Matoshi**
*9 mars 2026*

# Dita e Verës

Deshëm apo s'deshëm, tiranasit vendali apo edhe ne-"të ardhurit e mëvonshëm", Elbasani mbetet "Kryeqyteti i Ditës së Verës". Kjo festë është një nga traditat më të vjetra shqiptare, e cila festohet më 14 mars dhe shënon ardhjen e pranverës, largimin e dimrit dhe ringjalljen e jetës në natyrë. Në këtë ditë njerëzit dalin në rrugë, vizitojnë njëri-tjetrin, urojnë shëndet e mbarësi dhe tryezat mbushen me ëmbëlsira e sidomos me ballokume, simboli i kësaj feste.

Qyteti i Elbasanit e ka ruajtur me shumë dashuri këtë traditë brez pas brezi. Nga ky qytet, kjo festë pagane, u përhap në të gjithë Shqipërinë dhe sot festohet kudo me gëzim e hare, është një "Festë Zyrtare" për Shqipërinë.

Le ta festojmë këtë ditë me zemër të bardhë, me buzëqeshje dhe me shpresë për ditë më të mira!

Gëzuar Ditën e Verës, të gjithëve!

**Avdyl Matoshi**
*14 mars 2026*

**Gëzuar ditëlindjen, bashkëshortja ime e dashur!**

**Zoti të dhëntë shëndet, qetësi në zemër dhe buzëqeshje çdo ditë!**

**Të urojnë me gjithë zemër fëmijët, nipi e mbesat dhe e gjithë familja jonë.**

**Edhe 100 vite me ne, me gëzim e dashuri!**

**Avdyl MATOSHI**

# Në kujtim të birit të Nikaj-Mërturit - Mirash Sokoli

**...në Bashkinë e Tiranës**

Sot po shkruaj disa rreshta për birin e Nikaj-Mërturit, të ndjerin Mirash Sokoli.

Mirashi rridhte nga një familje me traditë. I ati, mixhët dhe mbarë familja e tij kanë qenë dhe janë njerëz të ndershëm, fisnikë, bujarë e punëtorë - ashtu siç i ka hije Malësisë.

Vetë Mirashi ishte një intelektual i shquar. Kudo që punoi - në ushtri apo në Bashkinë e Tiranës - u dallua për punë shembullore dhe integritet të lartë.

Ishte nga ata burra që nuk bënin zhurmë, por linin gjurmë.

U largua shpejt nga kjo botë, duke lënë në pikëllim të thellë bashkëshorten, fëmijët, vëllezërit e motrat, si dhe mbarë farefisin e tij.

Por la pas një emër shumë të mirë, që do të kujtohet gjatë.

Dritë e diell paç në jetën e pasosur, miku ynë i paharruar, Mirash Sokoli!

**Kujtesë nga**
**Avdyl Matoshi**
*4 mars 2026*

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

**Në prag të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit**

# Me gëzim e nderim shkruaj për Gëzim Prengzin e Geghysenit "Nderi i Kombit"

Sot dua të shkruaj për një mësues model, për një djalë të dalë nga një familje e nderuar në Prengzaj të Gegysenit,Nderi i Kombit familja e Ibrahim Prengzit

Një derë e respektuar në Malësinë e Gjakovës.Bëhet fjalë për Gëzim Ibrahim Prengzin.

Që nga klasa e parë e deri në përfundim të Universitetit ai ka shkëlqyer në mësime-një djalë korrekt, i edukuar dhe i përkushtuar ndaj dijes.

Pas studimeve nisi punën si mësues në disa shkolla të Malësisë së Gjakovës, ndërsa sot jep mësim në shkollën 9-vjeçare "Sherif Nuha", në fshatin e tij të lindjes.

Gëzimi është ndër ata të rinj të rrallë që nuk zgjodhi emigrimin, por zgjodhi të jetojë e të punojë në vendlindje, duke i shërbyer komunitetit të tij. Së bashku me kolegët e tij, kanë arritur ta kthejnë shkollën në një model për shumë shkolla të rrethit të Tropojës.

Ai është gjithashtu pjesëmarrës dhe kontribues në shumë aktivitete arsimore, artistike e kulturore në Malësinë e Gjakovës dhe në Kosovën Dardane.

I apasionuar pas historisë, ai është një kujtues i përkushtuar i luftërave dhe figurave historike të kombit shqiptar, duke marrë pjesë edhe në aktivitetet e Komitetit të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare.

Me telefonin e tij, që shpesh është kthyer në një "kamerë të fuqishme", ai sjell pamje mahnitëse nga vendlindja, nga bjeshkët e Shqipërisë dhe të Kosovës, duke i ndarë ato me dashamirësi me të gjithë.

Sot ai është një mësues që me punën dhe përkushtimin e tij ka fituar respektin e të rinjve dhe të të moshuarve.

I uroj shëndet të plotë, suksese në misionin e tij fisnik dhe shumë lumturi në familje, së bashku me bashkëshorten dhe dy fëmijët e tij!

**Me respekt,**
**Avdyl Matoshi**
*6 mars 2026*

## Qyteti dhe fshati

Qyteti e ka origjinën nga fshati. Por fshati shpesh ka mbetur mbrapa, sepse shumë banorë, për arsye të ndryshme, u larguan prej tij dhe shkuan të ndërtojnë jetën në qytet. Ata morën me vete dijen, zanatin dhe ëndrrat, dhe kështu u rritën qytetet.Megjithatë, rrënjët mbeten gjithmonë në fshat.Sepse pa Fshatin nuk do të kishte as Qytet.

**Avdyl Matoshi**
*12 mars 2026*

# *Julian, Gëzuar Ditëlindjen*

**Sot është një ditë e veçantë për familjen tonë. Djali ynë i madh, Julian Avdyl Matoshi, ka ditëlindjen.**

**Të urojmë shëndet, lumturi dhe suksese në çdo hap të jetës, biri Ynë!**
**Krenarë gjithmonë për Ty.**
**Edhe 100 vite të tjera të gëzuara, së bashku me Familjen!**

**Mami & Babi**

*Tiranë, 6 mars 2026*

# “Me Zanin e Bjeshkëve” Tradita, muzika dhe arti shqiptar në një festë të bukur shpirtërore

**Një mbrëmje plot emocione në koncertin e këngëtarit Gëzim Nika me Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore “Me Zanin e Bjeshkëve”. Tradita, muzika dhe arti shqiptar në një festë të bukur shpirtërore**

- shkruan **Sh.T.Z. Bajram BEGAJ**, në faqen e Tij në Facebook, me 13 mars 2026

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

Abonohuni në GAZETA E ALPEVE 100 € për 1 VIT
Botimet Dardania Tiranë-Prishtinë


# Sofije Salihu - Dumnica, pena e artë e Mërgatës

Nga **Hilmi GASHI** - Gjermani

Sofije Salihu-Dumnica, nga Banulla e Lipjanit, pas ardhjes së bashkëshortit të saj në Gjermani, Bajram Dumnicës, u nis drejt mërgimit së bashku me fëmijët për t'u bashkuar me të. Bajram Dumnica punonte si mësues i mësimit plotësues të gjuhës shqipe në Leverkusen.

Pa humbur kohë, në maj të vitit 1990, Sofije Dumnica u angazhua në aktivin e Lidhjes Demokratike të Kosovës në Leverkusen, ku kryetar ishte bashkëshorti i saj, Bajram Dumnica. Me angazhimin dhe përkushtimin e saj në këtë aktiv, ajo jo vetëm që u bë krahu i djathtë i kryetarit Dumnica, por për një kohë të shkurtër aktivi i LDK-së në Leverkusen u shndërrua një ndër aktivet me te suksesshme që nëndega kishte në Nordrhein-Westfalen.

Meqenëse u ndje nevoja për mësues të mësimit plotësues të gjuhës shqipe, u hap konkursi në Leverkusen-Opladen. Znj. Dumnica konkurroi dhe, pasi i plotësoi të gjitha kushtet, u pranua si mësuese.

Për më shumë se tre dekada, gjatë punës së saj si mësuese, Sofije Salihu-Dumnica organizoi me nxënësit e shkollës shqipe në Leverkusen-Opladen shumë manifestime kulturore në shenjë respekti për datat historike të popullit shqiptar. Gjatë këtyre viteve ajo nxori shumë gjenerata nxënësish, të cilët sot janë të integruar në profesione të ndryshme në shoqërinë gjermane. Edhe sot ata shprehin mirënjohje për punën dhe përkushtimin edukativo-arsimor që mësuesja Sofije u ka dhënë.

Paralelisht me punën në arsim, ajo ngriti zërin fuqishëm kundër padrejtësive dhe gjenocidit që po përjetonte populli shqiptar në Kosovë. Angazhimi i saj i palodhur për çështjen e Kosovës i solli besimin e bashkëveprimtarëve dhe avancimin në strukturat udhëheqëse të nëndegës.

Në Kuvendin e parë zgjedhor, znj. Dumnica u zgjodh Sekretare, duke u bërë një mbështetje e fortë për kryetarin prof. Marjan Tunaj. Në këtë kuvend, që u mbajt në Köln-Ehrenfeld të Nordrhein-Westfalenit, iu dha besimi edhe mësuesit Bajram Dumnica për detyrën e procesmbajtësit të përhershëm.

Pas këtij kuvendi, bashkëshortët Dumnica u angazhuan edhe më fuqishëm,

duke vizituar 65 aktivet në qytete të ndryshme të Nordrhein-Westfalenit, shpesh duke mbuluar shpenzimet nga buxheti i tyre familjar.

Që nga fillimi i vitit 1991, znj. Dumnica ishte pjesë e pritjeve të shumë delegacioneve nga Kosova, Ilirida dhe Shqipëria. Ajo dhe bashkëshorti i saj Bajrami ishin gjithmonë në ballë të protestave të mbajtura në Düsseldorf, Bonn, Bruksel, Vjenë dhe Gjenevë.

Sofija ishte një nga organizatoret më të zëshme për grumbullimin e ndihmave për arsimin shqip në Kosovë, për shëndetësinë dhe për familjet në nevojë, si dhe për mbledhjen e mjeteve materiale për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Bashkëshortët Dumnica ishin promotorë të fuqishëm në ngritjen e zërit të protestës dhe në sensibilizimin e opinionit gjerman për të vërtetat e Kosovës.

Mërgata shqiptare në Gjermani rrallëherë ka pasur shembullin e një çifti aq të përkushtuar në veprimtari kombëtare si Sofije dhe Bajram Dumnica. Gjithmonë së bashku, të pandarë dhe me buzëqeshje, ata dhanë shumë për Kosovën dardane, për kulturën dhe arsimin shqip në mërgim. Ata kontribuan që gjeneratat e reja të ruajnë dhe të mbajnë gjallë historinë, kulturën dhe gjuhën e bukur shqipe.

Por një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme e ndau këtë çift nga aktiviteti i përbashkët, nga buzëqeshjet dhe nga bisedat me bashkëveprimtarët dhe mërgatën shqiptare në Gjermani. Bajram Dumnica u nda nga jeta, duke lënë pas bashkëshorten Sofije, fëmijët, nipat e mbesat dhe shumë bashkëveprimtarë që e kujtojnë me respekt të madh.

Ndërsa mësuesja Sofije sot ka kaluar të tetëdhjetat dhe gëzon praninë e djemve, vajzave, nipave dhe mbesave të saj të dashura. Por mësuesja mbetet gjithmonë mësuese. Edhe sot ajo hap albumet e pasura nga arkivi i saj dhe u tregon nipërve e mbesave për kontributin e gjyshit dhe gjyshes së tyre, për sakrificat dhe punën që bënë për kombin dhe për të ardhmen e brezave.

Mërgata shqiptare dhe bashkëveprimtarët u janë thellësisht mirënjohës bashkëshortëve Dumnica për kontributin e tyre në arsim, kulturë dhe në çështjen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

Bajramit i qoftë i lehtë dheu i tokës dardane për të cilën dha aq shumë!

Ndërsa mësueses Sofije i urojmë shëndet, jetë të gjatë dhe të lumtur pranë djemve, vajzave, nipave dhe mbesave të saj.

Mërgata nuk të harron kurrë, Sofije!
Të paçim me jetë të gjatë!

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Jülich - qytet i vogël me emër të madh

Nga **Hilmi GASHI** - Gjermani



Qyteti Jülich ndodhet në Nordrhein-Westfalen të Gjermanisë. Që nga vitet '70, në këtë qytet janë integruar shumë shqiptarë nga Kosova, Lugina e Preshevës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Shqipëria. Ata, jo vetëm me punë fizike, por edhe me biznese të ndryshme, kanë fituar respekt të madh te vendasit.

Në mesin e shumë mërgimtarëve në Jülich është edhe Hamit Halili, i lindur dhe i rritur në një familje patriotike në Dubovc të Vushtrrisë, në rrëzë të bjeshkëve të Çyçavicës - vend i lidhur me historinë e lavdishme të Azem Bejtës e Shotë Galicës, Shaban Polluzhës dhe Mehmet Gradicës.

Qysh i ri, në odën e familjes së bacës Hamit, ai kishte dëgjuar rrëfime nga burra të njohur e trima të fshatrave të Drenicës, me të cilët familja kishte miqësi të hershme, si: Bajram Zuka nga Likoshani,Zenel Hoti e Zukë Xani nga Polaci, Nebih Meha e Emin Lati nga Prekazi, Rushit Zeka nga Llausha dhe shumë të tjerë. Këto rrëfime bënë që ai, që në fëmijëri, të krijonte një ndjenjë kundërshtimi ndaj sistemit serbo-jugosllav të asaj kohe.

Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike dhe bindjeve që tashmë kishte formuar si i ri, Hamiti në moshën 16-vjeçare u detyrua të largohej nga shkolla dhe të marrë rrugën e mërgimit. Fillimisht u ndal në Slloveni, duke kërkuar një jetë më të mirë për veten dhe familjen e tij. Mirëpo, pasi paga mujore nuk i mbulonte nevojat e tij dhe të familjes në Kosovë, vendosi të kalonte në Jülich të Gjermanisë.

Që në fillim, baca Hamit kërkoi të angazhohej në qendra dhe shoqata ku mund të kontribuonte për Kosovën dhe shqiptarët. Pas disa kërkimesh, ai arriti të gjejë vendet ku shqiptarët organizoheshin dhe ngrinin zërin për Kosovën.

Jo shumë kohë më vonë, së bashku me shokët e tij si Veliu, Rizahu, Musa, Rrahimi dhe shumë të tjerë, themeluan në Jülich Shoqatën Kulturore "Bashkimi Kombëtar", me kryetar Hamit Halilin.

Kjo shoqatë organizonte demonstrata për mbrojtjen e çështjes së Kosovës dhe për sensibilizimin e opinionit gjerman mbi të vërtetën e popullit shqiptar. Po ashtu, grumbullonte ndihma materiale për familjet në nevojë në Kosovë dhe Shqipëri.

Paralelisht me aktivitetin në krye të shoqatës kulturore, baca Hamit, së bashku me prof. Marjan Tunajn, Bahtir Avdiun dhe shumë aktivistë të tjerë, në maj të vitit 1990 themeluan në Nordrhein-Westfalen Nëndegën e Lidhjes Demokratike të Kosovës, me kryetar Marjan Tunaj, sekretar Hamit Halilin dhe arkëtar Bahtir Avdiun.

Angazhimi i bacës Hamit në kuadër të kësaj nëndege u shoqërua me organizimin dhe pjesëmarrjen masive të shqiptarëve në protesta dhe aktivitete në qytete të ndryshme evropiane, si në Bon, Bruksel, Vjenë dhe Gjenevë.

Aktiviteti dhe kontributi i bacës Hamit për Kosovën Dardane, Luginën e Preshevës, Iliridën dhe Shqipërinë nuk u ndalën kurrë. Sa herë që ishte nevoja për kombin, ai, së bashku me bashkëkombësit dhe aktivistët e Jülichit, ishte gjithmonë i pranishëm.

Për kontributin e tij në Jülich dhe në mbarë Gjermaninë janë në dijeni të gjithë - të rinj e të moshuar. Prandaj, me respekt dhe dashuri, të gjithë e thërrasin Baca Hamit, sepse gjatë gjithë jetës ai ka qenë në ballë të aktiviteteve dhe çështjeve kombëtare.

Sot, baca Hamit i ka kaluar të tetëdhjetat. I rrethuar nga nipat dhe mbesat e tij, ai shpesh hap albumin me fotografi - të cilat janë të shumta - dhe u tregon për aktivitetet dhe organizimet e dikurshme, duke ua përcjellë atyre dashurinë për kulturën dhe gjuhën e ëmbël shqipe.

Ne nuk mund të bëjmë shumë më tepër për bacën Hamit, përveçse t'i urojmë jetë të gjatë dhe të lumtur, së bashku me djemtë, vajzat, nipat, mbesat dhe gjithë familjen e tij.

Le të jemi gjithmonë mirënjohës për kontributin e tij të çmuar për Kosovën Dardane!

# Kambana e zgjimit

Nga **Sadik BICAJ** - Istog, Kosovë

U linde dhe u rrite në terrin e zi
Në tokën dardane të kallur me mijëra vjet
Në Drenicë Dukagjin Llap e Gollak ...
U bëre legjendë historie
Rilindje e kombit tonë të lashtë
Ëndërr e djalërisë së patrembur shqiptare
Ti Ushtria jonë Çlirimtare

Rinia u ngrit nga zemra e Dheut
Atdheut të robëruar i doli Zot
Trimat u tubuan nga mbarë ILIRIA
Amanetin e Skënderbeut e kujtuan
Rezistencë t'i bëjnë armikut
E ta mposhtin si herëve të tjera gjatë historisë

U kalite shtatë palë pash nën tokë
Në Drenicën e lashtë heroike
Ti dashuria jonë e zjarrtë
Ti Ushtria jonë Çlirimtare
Ti komandanti ynë legjendar Adem Jashari

Kosova po lahet në gjak
O njerëz të botës së shurdhër
Sot kambana e zgjimit po bie në Prekaz të Drenicës
Ora e fitores po ofrohet në çdo cep të Dardanisë
Vetëm edhe pak durim
Të hidhemi mbi kokat e çmendura çetnike
Se lirinë e kemi në mesin e ushtarëve të UÇK-së
Në armët dhe heroizmin e legjendarit Adem Jashari

*Është çështje kohe kjo*
*Sepse ngadhënjimi do të ndodh patjetër*

Qëndrove e pathyeshme ndër mote
Ti Ushtria jonë Çlirimtare
Ti komandanti ynë legjendar Adem Jashari

Armikun e tmerrove me trimëri
Ti trim mbi trima
O i pavdekshmi Njeri.

Qëndruat të patrembur
Armikun e tmerruat me shkathtësi
Zëri juaj kumboi deri në kupë të qiellit
O të pavdekshmit për LIRI

Hidhërimin kurrë s'e deshët
As ankimin se i patet lakmi
Kosova e robëruar iu dogji flakë
Patriotizmi iu dha shpresë për Ardhmëri
Ju trim mbi trima
Ju fatbardhësi

Sonte tërë natën e çjerrë
Nuk e bëri asnjë sy gjumë
Kosova e gjakosur dhe me varre
Më doli përpara
Ëndrrat e juaja më silleshin vërdallë
Ne më thatë duhet ta krijojmë shtetin tonë
Evropa duhet ta kuptojë të vërteten
Se Kosova e pavarur duhet të mbijetojë
Ju të rënët për LIRI
Ishit trim mbi trima
Zemrat i kishit plot me dashuri
Tokë e djegur ua kishte lakmi

Shtati juaj shndriste në Drenicë Dukagjin...
Amanetin e juaj e ruajtëm me krenari
Qindra vjet në robëri
Të pavdekshëm mbetet ndër mote

Ju yje mbi yje
Ju krenari

U vra Arbëria
U vra Iliria
U vra Çamëria ...

*TËRË EMRAT SIMBOLIK u VRANË*
*PËR të RILNDUR PRAPË një DITË*

U vra heroizmi i viteve të 1950-ta
U vra ideali i viteve të 1960-ta
U vra e ardhmja e viteve të 1970-ta
U vra kombëtarizimi i viteve të 1980-ta
U vra qëndresa e viteve të 1990-ta.

*U VRANË VITET e FËMIËVE TANË*
*U VRANË DRITAT e SYVE TANË*

Librat fletoret lapsat çantat dhe shkollat
I dogji flakë armiku i tërbuar serb
Me qëllim të errët barbar
Që të përdhoset dituria e fëmijëve tanë

U vranë por nuk vdiqën
Sepse jetojnë në historinë tonë
Komandanti Adem Jashari me shokë
Tërë jetën tonë

U vranë nga dora barbare serbe
Legjendari Adem Jashari
Dhe qindra luftëtarë të lirisë
Por nuk u vra ideali i tyre
Dhe ëndrra jonë e pavarësisë

Sot do të rilind komandanti legjendari Adem Jashari
Sot do të rilind Iliri Iliria, Dijona, Liridona...
Nesër do të rritet Njomëza, Qëndresa...
Pasnesër do të ngadhënjejnë Kosova, Çamëria...

***NË TË ARDHMEN e NDRITUR***
***DO TË ZHDUKEN LARGËSITË***
***DHE PARAPË DO TË RINGJALLET***
***TRUNGU i LASHTË i ILIRISË.***

## SADIK BICAJ
### Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës



Lindi në Vrellë të Istogut, më 21.10.1958. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Pejë, SHLP-në në Gjakovë, ndërsa Fakultetin e Filologjisë, Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe, në Universitetin e Prishtinës.

Është anëtar i Shoqatës së Gjuhës Shqipe të Kosovës, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe kryetar i klubit letrar "Podguri" të Istogut.

Merret me poezi, gjuhësi, kritikë letrare dhe publicistikë. Një kohë të gjatë, para luftës së UÇK-së, punoi në shkollën fillore "Fazli Graiçevci" të Hades së Obiliqit, pastaj në shkollën fillore "Hysni Zajmi" të Vrellës, ndërsa pas luftës disa vjet në gjimnazin "Haxhi Zeka" të Istogut, ndërsa nga vitit 2010 është drejtor në SHFMU "Hysni Zajmi" të Vrellës.

Krahas punës në arsim, dhjetë vjet paslufte, ishte edhe korrespondent i rregullt i gazetës "Koha Ditore" nga Istogu, ndërsa krahas kësaj një kohë ishte edhe përgjegjës për kulturës në Drejtorinë e Arsimit dhe drejtor në Shtëpinë e Kulturës " Adem Jashari" të Istogut.

**Deri tash ka botuar këto vepra:** "Plaga e kurbetit", dramë, 1992 / "Zëri i pikëllimit", poezi, 1994 / "Artikuj gjuhësorë praktikë", 1996 / "Historiku i shkollave fillore të komunës së Istogut", monografi, 1997 / "Vështrime letrare", 2000 / "Rrugët drejt lirisë", ditar nga lufta, 2002 / "Sylë Vrella, mjek i njohur popullor", monografi, 2006 / "Teste nga Gjuha Shqipe e Letërsia", 2008 / "Fadil Ferati, veprimtar i denjë i lirisë dhe pavarësisë" (monografi), 2014 / "Vështrime gjuhësore e letrare", 2019 / "Këndvështrime gjuhësore në romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" / Vëllimi poetik i tij "Zëri i pikëllimit", 1994, i është përkthyer në gjuhën suedeze, 2020, nga Shoqata" Dora e artë" në Malmo.

Sadik Bicaj është përfshirë në "Leksikonin e shkrimtarëve" të Hasan Hasanit, në "Leksikonin enciklopedik" të Akademisë Shqiptare Amerikane, 2020, të autorit Flori Bruqi, në "Antologjinë e poezisë moderne shqipe" të autorit Adem Zaplluzha etj.

Jeton dhe vepron në vendlindje.

Botimet Dardania
Tiranë-Prishtinë

Masmedia * Publikime * Abonime
* Veprimtari * Rrjete Sociale

Limit.al
Portal kombëtar

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Abonimi juaj vjetor për vitin 2026,

## një kontribut i çmuar për cilësinë, jetëgjatësinë e mbarëvajtjen e "Gazeta e Alpeve", në këto kushte të vështira për shtypin shqiptar dhe botëror

# FUSHATA e ABONIMEVE

**për periudhën 1 mars 2026 - 1 mars 2027**

Fushata e Abonimeve Vjetore në "Gazeta e Alpeve", Media Rajonale, **PanShqiptare, NdërBallkanike, EuroAtlantike, (Shqipëri-Kosovë-Mali i Zi-**Lugina e Preshevës e Sanxhak-Maqedoni e Veriut-Mërgata Shqiptare në Botë) **me** 100 Euro (apo kundërvlera monetare në monedha të tjera) abonimi vjetor në "Gazeta e Alpeve" **për vitin 2026 dhe 2027**

Komunikimet: E-mail: gazetaealpeve@gmail.com **Tel:** +355 69 78 39 500

Gazeta e Alpeve
Tel: +355 69 78 39 500 dhe 00383 49 866 902 - E-mail: gazetaealpeve@gmail.com
Drejtor i Përgjithshëm: Ramiz TAFILAJ Kryeredaktor: Ramiz LUSHAJ
Nr. 105 1-15 Maj 2025 Çmimi: 50 Lekë Vendet e Rajonit: 1 €
Abonimet Vjetore në "Gazeta e Alpeve" për Vitin 2025
Pse Familja Trashëgimtare e Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, nuk ka Status Diplomatik në Shqipëri...?! Nga Ramiz LUSHAJ
Unaza e Alpeve Theth -Valbonë, rruga që do t'i japë jetë një prej thesareve më të fshehura të Shqipërisë Nga Avni PONARI
Hekurudha Kuq e Zi, Shkodër - Gjakovë Nga Musa KURTULAJ
Duhet të punojmë më shumë për të forcuar pozitat tona kombëtare shqiptare në arenën ndërkombëtare
-Një bisedë vllaznore e diplomatit, studiuesit e analistit Mal BERISHA, me aktivistin e shquar të çështjes kombëtare shqiptare, z. Harry BAJRAKTARI
Xhorxh H.W. Bush, më tha në vitin 1987: "Po deshtët me pasë një Kosovë të Pavarur duhet me pas një Shqipni Demokratike. Po deshtët me i ba ndihmë Kosovës na duhet me e ndryshue sistemin në Shqipni"
ILDA ZHULALI Emri që i mungon Kuvendit të Shqipërisë
Pse nuk u përzgjodh Kruja për Kryeqytet? Nga Mehmet ELEZI – Tiranë.
Dr. Ibrahim RUGOVA Arkitekti i Pavarësisë së Kosovës (Besa TAFILAJ PINCHOTI & Korab F. KASTRATI)
PLOJA e TIVARIT
Bylbyl Breçani nuk ishte i zakonshëm, por bënte pjesë tek lulja e Kombit, duke u shndërruar në model e në ideal për të tjerët Sh.T.Z. Skënder F. DURMISHI Ambasador i Republikës së Kosovës në Tiranë
Stacioni Policor i Klinës, Drejoria Rajonale e Policisë dhe Prokuroria në Pejë, Ministria e Brendshme në Prishtinë, nuk duhet të heshtin përballë kësaj vepre kriminale ndaj identitetit kombëtar shqiptar dhe ndaj kulturës kombëtare shqiptare (!)

Gazeta e Alpeve
Nr. 108 1 - 16 Korrik 2025 Çmimi: 50 Lekë Vendet e Rajonit: 1 €
Grupi për Çështjet Shqiptare në Kongresin Amerikan
Marrëveshja e Ohrit Dy analiza nga Prof. dr. Skënder ASANI, Luljeta SYLE-JMANI
Projekti Kombëtar "Pena Alpine" për shkollat me krijimtari letrare, publicistike, artistike
Festa e Madhe e Shipshanit Një përvjetor - një histori krenarie kombëtare!
Zgjerimi i Bashkimit Europian me anëtarësime nuk është një proces bamirësie, por investim strategjik në sigurinë, stabilitetin, zhvillimin dhe të ardhmen e vet Europës
Prof. Asoc. Dr. Bajram BEGAJ, dr. Vjosa OSMANI SADRIU...
Heroi i Kombit Selman Kadria vjen në shtatore në Bronx, në ditën e Çlirimit të Istogut Reportazh nga Maxhun OSMANAJ
Kosova kurrë nuk ka mendue të jetë shtet i pavarur, por vetëm e bashkuar me Shqipërinë Nga Ramiz TAFILAJ
Hapja e Fondit për Ushtrinë e Kosovës, urgjencë e kohës!
Rreth 40 mijë pensionistë të vitit 2025 do të përfitojnë nga ky koifiçent indeksimi Nga Astrit HADO
Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, nderon Ekrem Bardhën me "Çelësi i Prishtinës" dhe përurimin e Parkut "Bardha"
Lola Aleksi Gjoka, e para pianiste koncertale shqiptare Nga Feride ISTOGU GILLESBERG - Danimarkë
Një lumë i formuar me ujë burimesh, nuk shterrë kurrë... Nga Dëfrim CANI - Dibër/Tiranë
Nëndega e LDK në Gjermani një shembull i mirë kombëtar Jakup Gërguri

Gazeta e Alpeve
Nr. 111 1-16 Nëntor 2025 Çmimi: 50 Lekë Vendet e Rajonit: 1 €
12 tetor 2025 deri 10 prill 2026 Shqipëria: kalimi i Kufirit me Sistemin Europian të Hyrjeve/Daljeve (EES) në Zonën Shengen
PAKETA e MALEVE Dr. Artan Gjika, emër që la gjurmë në Kosovë Nga Hilmi GASHI – Gjermani
ALBTVUSA Televizioni i Shqiptarëve të Amerikës 25 Vjet në shërbim të Komunitetit Shqiptaro-Amerikan dhe në Botë
Koha për një Arkitekturë të Re të Pensioneve në Shqipëri Nga Elvis PONARI - CEO i SIGAL Invest
Eksportet nga Kosova në Shqipëri u rritën 4 herë, ndërsa importet e Kosovës nga Shqipëria u rritën 2 herë, krahasuar me vitin 2015
Delegacioni nga Kosova Lindore në Texas: Zëri i Shqiptarëve që Nuk Heshtet
Institucionit të Avokatisë në Shqipëri nuk ju dha asnjëherë Identiteti i saktë ligjor dhe aq Hyjnor, si në vendet euro-atlantike Nga Av. Korab ZENUNI – Tiranë
"Nëse do ta qëndisja kohën"... Nga Sarë GJERGJI – Kosovë
Emërimi Konsull Nderi i Republikës së Shqipërisë në Kalabri: një nder i lartë, përgjegjësi e angazhim i madh
SOFRA PUKJANE "Sofra Pukjane" ka ndriçuar si një vatër bashkimi, një tempull vlerash... Nga Rrok DODAJ

Gazeta e Alpeve
Nr. 106 17-31 Maj 2025 Çmimi: 50 Lekë Vendet e Rajonit: 1 €
"Disko Club Albania" në Tiranë, në Vitet '90, me veprimtaritë kombëtare, ishte krejtësisht në shërbim të ndryshimit të sistemit, nga monist në demokratik, në Shqipëri
Për një Europë të Re në një Botë të Re Edi Rama- Kryeministër i Shqipërisë
Fryma e një kombi që jeton përmes kujtimeve të një biri të tij të denjë. Një dashuri që ka vetëm një emër: Atdhe! Nga Fran GJOKA - Detroit
Marrëveshja e Konçulit– një kapitull i mbetur peng në fletët e historisë Nga Ragmi MUSTAFI – Bujanoc
Kosova e ngërçeve të përhershme Prof. Dr. Enver HASANI
Donacion me shumë vlerë i tre Vëllezërve Ahmetaj për Qëndren Kulturore në Vuthaj, ku do të mbahet "Takimi i Pestë Kombëtar i Plavë-Gucisë, 2025" Nga Esad GJONBALAJ - Amerikë
Një gjeneratë larg Demokracisë Nga Prof. Asoc. Dr. Afrim KRASNIQI

Gazeta e Alpeve
Nr. 109 1 - 16 Shtator 2025 Çmimi: 50 Lekë Vendet e Rajonit: 1 €
1-30 Shtator 2025: Aksioni i Përgjithshëm, Përfundimtar, për realizimin, ngritjen dhe përurimin e Shtatores së heroit Bylbyl Breçani dhe të Memorialit për Luftën e Kosovës, që do të vendosen së shpejti në qytetin e Bajram Currit
Petka (Gjypeta) mbi 4.000 vjeçare e Pultit të madh Iliro-Dalmat që flet Shqip Sokol SUSAJ - Etnomuzikolog
Takimi i Plavë-Gucisë, 2025, Takim PanShqiptar-NdërBallkanik-EuroAtlantik
Çmimi i Lartë "Mikpritja Shqiptare" për "Valbona Resort & SPA" Nga Shaban & Fatime PRELVUKAJ – Hollandë
Vepra "Dr. Ibrahim Rugova, Arkitekti i Pavarësisë së Kosovës", Promovim madhështor në Tiranë
Hapja e Fondit për Ushtrinë e Kosovës, urgjencë e kohës! Nga: Idriz ZEQIRAJ
"HIMNI i ALPEVE"
Tërbimi malazez i rradhës
Kur java ka 7 të diela!
Institucioni i Besë - Përvoja dhe Vlera ma e Vjetër e Njerzimit - Caku Sublim i të Vërtetës

Gazeta e Alpeve
Nr. 112 16-30 Nëntor 2025 Çmimi: 50 Lekë Vendet e Rajonit: 1 €
Kongresi i Manastirit
Ferik Ferra: Poet, kulturolog dhe fisnik!... Nga Dëfrim CANI
Pena, Peneli dhe Puna Atdhetare, Kulturore, Humanitare e Sejdi Bytyçit në Amerikë
Konflikti midis Kosovës dhe Serbisë mund të zgjidhet vetëm nga Amerika Nga MSc. Agim ALIÇKAJ – Drejtor Ekzekutiv i LQSHA
Televizioni i Shqiptarëve të Amerikës "ALBTVUSA" festoi 25 vjetorin e themelimit Nga Sokol PAJA
Këtë marrëdhënie të jashtëzakonshme mes Italisë dhe Shqipërisë ta shndërrojmë në një mësim, në një thesar për ta fuqizuar edhe më shumë
Ali Mus Lushaj i Shipshanit 100-Vjetori i Lindjes
U riafirmua angazhimi i ndërsjelltë për zgjerimin e pranisë japoneze në sektorë prioritarë të ekonomisë shqiptare dhe rritja e prezencës së produkteve shqiptare në tregun japonez
Bashkia Kukës e nderoi filantropin e shquar Lazim Destani me "Çelësin e Qytetit" dhe me "Mirënjohje"
Pse pensionet në Europë janë më të larta se ato të shqiptarëve?!
Shënime për Librat
Ing. Gegë SOKOLI i shkencës, i pyjeve, i mjedisit

Gazeta e Alpeve
Nr. 107 1-15 Qershor 2025 Çmimi: 50 Lekë Vendet e Rajonit: 1 €
Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane në Washington Nga Agim ALIÇKAJ
Ekrem Bardha me kontribute të veçanta e të çmuara për Çështjen Shqiptare, për Kosovën, për Kombin
Ceremoni me mbi 400 të ftuar nderi në Kishën Katolike Shqiptare "Shën Pali" në Detroit-Michigan në nderim të personalitetit të shquar shqiptaro-amerikan, Ekrem BARDHA
Peticioni Qytetar "Ta bëjmë Kosovën-DARDANI"
Pensionistët përballë sfidave të kohës: legjislacioni shqiptar, pagesat monetare, mbijetesa e sotme
Serbia çdo ditë e më shumë po shpërfaq qasjen e saj diskriminuese ndaj shqiptarëve të Luginës së Preshevës, që në thelb ka spastrimin etnik të tyre Nga Xhelal SVEÇLA
Në fund të Viteve '80-ta kam përcjellë disa mesazhe historike amerikane në Kosovë Intervistë me Ramiz TAFILAJ – Amerikë
"Ora e Maleve": Manifestim Tradicional Kulturor në Rozhajë
Në agun e një dite
Kuvendi i Serbisë ka grup miqësie vetëm me një nga shtetet e ish-Jugosllavisë e të Ballkanit Përëndimor...! Nga Ramiz LUSHAJ

Gazeta e Alpeve
Nr. 110 1 - 16 Tetor 2025 Çmimi: 50 Lekë Vendet e Rajonit: 1 €
12 Tetor 2025 - Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës
Pena e Drinit
Prej 7 tetorit 2025 Shqipëria në SEPA
Arbëreshët e Rajonit të Kalabrisë në Itali - ura bashkëpunimi ekonomik e kulturor me Shqipërinë, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut
Mbështetje për zhvillimin e Eko-Turizmit në korridorin ekologjik
Si në njerëz edhe në bagëti, Zoti i ka falë dy gjini
Investimet e zgjuara në SIGAL MAX mposhtin pasiguritë e të ardhmes
Dr. Ruki Kondaj nga Kanadaja me fjalën e saj në Shtëpinë e Kulturës në Vuthaj, një mesazh krenarie dhe reflektimi për trevën tonë
Avdyl Sula
Shqiptarët e Amerikës nderuan veprën kombëtare të Joe Dioguardit e Shirley Cloyes Dioguardit
Ramiz Lushaj, publicisti i Alpeve dhe një nga zërat e Shqiptarisë në Rajon

Gazeta e Alpeve
Nr. 113 1-16 Dhjetor 2025 Çmimi: 50 Lekë Vendet e Rajonit: 1 €
Biznesmeni Avni Ponari - i suksesshëm, i besueshëm, transparent dhe i vendosur për t'i realizuar objektivat dhe qëllimet e tij
Investimet, lobimi, kultura dhe energjia e Diasporës Shqiptare janë faktor kthese në zhvillim dhe në sigurinë kombëtare Nga Ramiz TAFILAJ - Houston - Teksas/ SHBA
Kristaq Janushi, një jetë mes artit, kulturës e fotografisë
Para se Serbia të hyjë në BE, ajo më parë duhet të hyjë në Europën e të drejtave, e jo vetëm në Europën e tregut Nga Shaip KAMBERI
Shqipëria: midis dinamikës së reformave dhe brishtësisë demokratike
Shkrimtari me famë botërore, Besnik MUSTAFAJ, vjen me romanin e ri "Në mëni të njeni-tjetrit"
"Darka e Lamës" Festë Tradicionale Shtetërore e Republikës së Kosovës
Edhe një Mandat për Këshilltarin Bashkiak të Mynihut, Deli BALIDEMAJ
"Shqipëria - Orienti i Europës"

# Kriza e zgjedhjes së Presidentit: kalkulimet politike dhe frika nga përgjegjësia

Nga **Ramiz TAFILAJ** - Texas, SHBA

Dështimi i zgjedhjes së presidentit të ri në Parlamentin e Kosovës nuk është thjesht një problem procedural. Ai është simptomë e një krize më të thellë politike, ku kalkulimet partiake po vendosen mbi funksionimin normal të institucioneve. Në këtë situatë është e vështirë të vendoset barazi përgjegjësie mes presidentes aktuale Vjosa Osmani dhe kryeministrit Albin Kurti apo partisë së tij, Lëvizja Vetëvendosje. Arsyeja është e qartë: përgjegjësia kryesore politike për funksionimin e institucioneve bie mbi partinë që ka shumicën parlamentare dhe udhëheq qeverinë.

Paradoksi i situatës aktuale është se LVV arriti një mbështetje të madhe elektorale, por sot duket e pasigurt se si ta përdorë këtë pushtet. Fitorja e saj në zgjedhje u ndërtua mbi një narrativë të fuqishme kundër elitave të vjetra politike dhe mbi një mobilizim të jashtëzakonshëm në rrjetet sociale dhe mediat elektronike.

Megjithatë, qeverisja kërkon më shumë sesa mobilizim elektoral. Ajo kërkon vendime të vështira dhe përgjegjësi politike. Sot duket se pikërisht nga kjo përgjegjësi po përpiqet të shmanget lidershipi i LVV-së.

Një nga arsyet kryesore që përmendet në analizat politike është frika politike nga implementimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Ky është një obligim që rrjedh nga procesi i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë dhe që është rikthyer fuqishëm në agjendë pas marrëveshjeve të arritura në Ohër, në kuadër të procesit të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Për një parti që ka ndërtuar identitetin politik mbi kundërshtimin e këtij mekanizmi, implementimi i tij do të kishte një kosto të madhe politike.

Prandaj, në qarqe politike po qarkullon një hipotezë serioze: se LVV mund të preferojë zgjedhje të reja dhe një qeveri të ardhshme koalicioni. Në një konfigurim të tillë, përgjegjësia për vendimet e vështira do të ndahej mes disa partive.

Me fjalë të tjera, një pjesë e klasës politike mund të jetë duke kërkuar të ndajë përgjegjësinë për vendime që më parë i ka refuzuar kategorikisht.

Një dimension tjetër i krizës është marrëdhënia mes Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit. Bashkëpunimi i tyre dikur u paraqit si një projekt i ri politik për Kosovën, por sot duket se ai është dobësuar ndjeshëm.

Nëse Osmani zgjidhet për një mandat të dytë presidencial, ajo fiton një autonomi shumë më të madhe politike. Një presidente e pavarur mund të marrë vendime që i shërbejnë interesit të shtetit, por jo domosdoshmërisht interesave taktike të një partie të vetme.

Kjo perspektivë nuk është domosdoshmërisht e rehatshme për një parti që është mësuar të kontrollojë fort narrativën politike.

Sipas Kushtetuta e Kosovës, procedura për zgjedhjen e presidentit është e përcaktuar qartë. Nëse procesi dështon, hapet rruga për shpërndarjen e parlamentit dhe zgjedhje të reja.

Në këtë kontekst një rol vendimtar mund ta ketë Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Por çdo interpretim i saj që perceptohet si politik do të rrezikonte seriozisht besimin në institucionet e shtetit.

Kosova ka vuajtur shpesh nga përdorimi selektiv i institucioneve për qëllime politike. Një përsëritje e kësaj praktike do ta thellonte edhe më shumë krizën.

Një cikël i ri zgjedhor do të krijonte mundësi për ripozicionim të opozitës: Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Megjithatë, edhe këto parti përballen me probleme serioze.

LDK mbetet potencialisht forca me hapësirën më të madhe për rritje, por ajo vazhdon të pengohet nga një krizë lidershipi. Pas disa humbjeve radhazi, mungesa e reformës së brendshme dhe dominimi i interesave personale mbi ato politike e kanë dobësuar ndjeshëm këtë parti.

PDK dhe AAK kanë një bazë relativisht stabile votuesish, por edhe një tavan të dukshëm elektoral që e bën të vështirë zgjerimin e ndikimit të tyre.

Një element që shpesh injorohet në analizat politike është roli i diasporës. Në zgjedhjet e fundit ajo mobilizoi një mbështetje të madhe për projektin politik Kurti–Osmani.

Sot, një pjesë e diasporës ndjehet e zhgënjyer. Shpresa se ky bashkëpunim do të sillte stabilitet institucional dhe një drejtim të qartë politik për Kosovën duket se është zbehur.

Perceptimi që po krijohet është se lufta për pushtet dhe kalkulimet personale po e zëvendësojnë vizionin strategjik për shtetin.

Është e pamundur të analizohet kjo krizë pa përmendur faktin se Vjosa Osmani ka qenë ndër figurat më të votuara në historinë politike të Kosovës. Mbështetja që ajo mori në zgjedhje nuk ishte vetëm partiake; ajo ishte edhe personale.

Për shumë votues, veçanërisht në diasporë, Osmani përfaqësonte një figurë të re politike – më të pavarur nga strukturat tradicionale partiake.

Por pikërisht kjo pavarësi sot mund të jetë arsyeja pse një mandat i dytë i saj nuk shihet me entuziazëm nga disa qarqe të pushtetit.

Një presidente që nuk kontrollohet lehtë nga një parti mund të bëhet faktor i rëndësishëm institucional. Dhe kjo nuk është gjithmonë e rehatshme për pushtetin ekzekutiv.

Kriza aktuale nuk është vetëm për zgjedhjen e një presidenti. Ajo është një test për maturinë e klasës politike në Kosovë.

Nëse partitë vazhdojnë të përdorin institucionet si instrumente taktike për përfitime afatshkurtra politike, dëmi nuk do të jetë vetëm institucional. Ai do të jetë edhe në besimin e qytetarëve tek vetë demokracia.

Në fund, zgjedhjet mund të ndryshojnë përbërjen e parlamentit. Por nëse kultura politike nuk ndryshon, krizat e tilla do të përsëriten.

*Texas, 7 mars 2026*

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Gjenerali i Unazës së Bjeshkëve Alpine

Kohët e fundit, gjeneral Dedë Prenga, ish Komandant i Batalionit Xhenerio-Ndërtues të Forcave të Armatosura, në Tiranë, u nderua me titullin "Qytetar Nderi" nga Bashkia Tropojë, për kontributin e tij të veçantë në jetësimin e projektit të Unazës së Bjeshkëve Alpine të Tropojës, me vendimmarrjet e tij eprore dashamirëse e përkushtuese për fillimin dhe vijimin e punimeve të projektit nga Batalioni i Xhenios  në Alpet e Malësisë së Gjakovës.

Ky vlerësim i lartë për Gjeneral Brigade Dedë Prenga përbën një akt mirënjohjeje të merituar dhe një dëshmi të gjallë se kontributet e vërteta nuk harrohen asnjëherë, kur në udhët e jetës ka mirënjohës, sikurse është kryebashkiaku i Tropojës, Rexhë Byberi, kohë më herët edhe Kryetar i Komunës Margegaj.

Figura e gjeneralit mirditor Dedë Prenga lidhet ngushtë me një prej projekteve më domethënëse infrastrukturore për zonën, Unazën e Bjeshkëve Alpine të Tropojës, ku përfshihet edhe rruga nacionale ndërkufitare që lidh Tropojën (Lugun e Malësisë e Qytetin e Alpeve) dhe Dragobinë me krahinën e Plavë-Gucisë në republikën fqinjë të Malit të Zi. Kjo një nismë me ndikim strategjik në zhvillimin ekonomik, turistik dhe lidhjet ndërkufitare të rajonit alpin të Malësisë së Gjakovës, Plavë-Gucisë e Rrafshit të Dukagjinit.

Në vitin 2007, ushtaraku model Dedë Prenga ishte Komandant i Batalionit Xheniero - Ndërtues të Forcave të Armatosura me qendër në Tiranë. Pozicioni i tij ishte vendimarrës për çdo projekt në shkallë vendi që do realizohej nga strukturat e Batalionit të Xhenios që drejtonte asokohe.

Vendosmëria dhe angazhimi i tij rezultuan vendimtare për miratimin dhe nisjen e punimeve së Unazës së Bjeshkëve Alpine të Tropojës. Shumë prej atyre që e ndoqën nga afër procesin dëshmojnë se pa përkushtimin e tij, projekti mund të kishte mbetur në letër ose ishte shtyrë pa afat duke marrë kahje tjetër.

Kontributi i Gjeneralit nuk ishte thjesht institucional, por edhe moral. Ai e konsideroi Tropojën jo vetëm si një hapësirë, ku kishte shërbyer ndër vite si Komandant i Batalionit të Xhenios (1984-1989), por si një obligim personal për të mbështetur zhvillimin e saj. Kjo lidhje e qëndrueshme me komunitetin tropojan edhe pas përfundimit të detyrës, e bën nderimin edhe më kuptimplotë.

Ky vlerësim i lartë nga Bashkia Tropojë e Këshilli bashkiak i saj është një akt që kapërcen formalitetin administrativ dhe shndërrohet në shprehje të respektit qytetar, që shprehet në motivacionit e dekorimit: "Personalitet me kontribut të veçantë për komunitetin tonë duke u bërë bashkëiniciator në fillimin e hapjes së Unazës së Bjeshkëve në krye te forcave të Xhenjos të Forcave të Armatosura".

Ky nderim bashkon simbolikisht Mirditën me Tropojën, duke dëshmuar se vlerat e shërbimit, profesionalizmit dhe përkushtimit ndaj vendit janë ura që lidhin treva dhe komunitete.

Në një kohë kur shpesh harrohen meritat e heshtura, ky vlerësim rikthen në qendër figurën e ushtarakut që i shërbeu vendit të tij, kombit të vet, me dinjitet, duke përfaqësuar me krenari Shqipërinë brenda dhe jashtë saj.

Urime Gjeneralit për këtë titull të merituar, një nder që refleton jo vetëm kontributin e tij profesional, por edhe integritetin njerëzor që e ka shoqëruar gjatë gjithë jetës.

Mbresa leximi

# Dëgjuesi dhe krijuesi popullor, Mustafë Rugova, u jep vlerën secilit në librin "RTV Fontana dhe vlerat e saj"

Shkruan **Maxhun Osmanaj**-Istog, Kosovë

("RTV Fontana dhe vlerat e saj", Mustafë Rugova, shtypi "Dukagjini"-Pejë, 2023)

Sapo më ra në dorë, libri në fjalë, dhuratë nga Zeqir Mehmetaj, drejtor i RTV Fontanës, i autorit, Mustafë Rugova, ndonëse një libërth modest, i vogël në sasi, 55 faqe, por i shkruar me zemër që rrezaton një shpirt të madh fisnik, nuk e lashë ta mbulojë pluhuri i harresës, në bibliotekën time modeste. Tipi i librit zhanror është : gjysma e librit në prozë, formë monografie, ndërsa gjysma në poezi popullore. Kryefjalë e librit është mediumi RTV Fontana, përkatësisht drejtori i saj, baca Zeqë i njohur në popull si dhe afër njëqind personalitete, dëgjues të këtij mediumi, që kalërojnë brenda librit qoftë në prozë, qoftë në poezi. Lbri fillon me një citat: "*Edhe nga ata që na lëndojnë, mësojmë diçka.Mësojmë se si nuk duhet të bëhemi kurrë si ata".(f.q.3).*

## Cili është autori, Mustafë Rugova?

Mustafë Rugova është një mërgimtar dhe veprimtar,nga fshati Cërrollukë, komuna e Istogut, të cilin valët e egra të kohës, tash e katër dekada e hodhën padashur në mërgim, në Holandë. Mustafa është tip i njeriut malësor, sikur i odave të moçme, që kur e dëgjon, kurrë nuk të zhgënjen.Ai ka ruajtur vlerat më fisnike të njeriut, të trashëgimisë etnokulturore edhe jashtë atdheut.Është ajka e mijëra dëgjuesve të Fontanës.Fjala e tij peshon, motivon, unifikon, rrezaton, mbjell shpresë, që rrallëkush e ka.Ai shpalos mençuri shpërfaqur me urtësi dhe gjakftohtësi.Është dëgjues besnik i RTV Fontanës që nga themelimi i këtij mediumi, pradaj ka fituar nderimin e mijërave dëgjuesve.

Shtylla e librit është jo vetëm një përshkrim shpirtëror i afro njëqind personaliteteve që zë në shkrim, ata më të rëndësishmit që e dëgjojnë dhe e shikojnë këtë medium, por edhe vlerat e këtyre njerëzve, që ia shtojnë vlerat këtij mediumi.Duke qenë edhe vetë autori Rugova një dëgjues besnik i Fontanës që nga themelimi, ai me telefonatat e tij, me zërin e tij fisnik, krijoi ura bashkëpunimi, krijoi miqësi njerëzore, dhuroi njerëzillëk, që i jap hijeshi mediumit.Çdo komunikim i tij, i ëmbël, i mençur duke përcjellë një mesazh uniteti, pa ngjyra partiake, u bë një kryepersonazh i Fontanës, meqë temat që i trajtonte dhe i trajon, sikur u jep një vulë mirëkuptimi, por pa ia mohuar askujt vlerat.

## Mesazhin që përcjell autori Rugova përmes këtij libri-proza

Rugova përmes këtij libri modest, u ufron lexuesve, dëgjuesve dhe shikuesve një mesazh fisnik se miqësia nuk peshohet aq lehtë kur brenda miqësisë ka urtësi, sinqeritet, gjakftohtësi, besim,humanizëm,pra këto vlera duhet përqafuar si dhurata njerëzore.Në fillim të librit, autori rrëfen se si rastësisht u njoh me bacën Zeqë në hotel "Trofta", atëherë kur ishte vetëm si medium i radios.Ai jap shumë arsye pse e dëgjon, pse e shikon këtë medium, tashmë të njohur jo vetëm në Rrafshin e Podgurit por në mbarë Kosovën.Ky medium, duke pasur një mision jo vetëm informativ, por edhe atë humanitar, përfitoi mijëra lexues nga Kosova dhe mbarë bota ku jetojnë dhe veprojnë mërgimtarët tanë shqiptarë. Në fillim, disa "intelektualë" dyshuan pak me një dozë në vlerat e mediumit, kinse"Fjalori në Fontanë nuk është në përputhje me standardin e gjuhës". Mustafa, reagoi: "Bash për këtë dhe mu për këtë gjuhën të cilën e flet Zeqa më ka bërë të jem edhe më i përafërt me të. Ju vazhdoni mos ta doni Fontanën, e dua unë edhe për juve".(f.q.5). Në këtë libër kalërojnë personazhe-personalitete nga shumë fusha të jetës.Të rinj dhe të pjekur, të moshuar, burra dhe gra nga vendi dhe bota.Pra nga gjeografia e trojeve shqiptare, qoftë ata që jetojnë brenda në vendlindje, qoftë në mërgim.Autori Rugova ua përcjell lexuesve secilin që e zë në gojë, vlerat që i bartin duke i njohur disa edhe fizikisht, disa përmes valëve të Fontanës dhe me komentet e tyre.Pra, u bë një përshkrim të brendshëm për vlerat që i bartin. Ky përshkrim bëhet me gjuhën e ëmbël të autorit, me ngjyrat më të bukura siç thotë; disa janë azganë, disa gjaknxehtë, disa të urtë, disa të pjekur si "këtyneherit", siç thotë autori, disa mjeshtër të fjalës, disa humorista, disa për beteja.Shumë janë veprimtarë, humanistë pa kurrkund shoq, disave u peshon bukur fjala etj.Në libër e gjejmë edhe një letër të Idriz Zeqirajt, nga Studenica e Istogut,"ky intelektual emblematik"(f.q.11), i përndjekur para shumë dekadave nga trolli i vet,Studenicë, i burgosur në Shqipëri me vite dhe , pas burgut me banim në Gjermani, një veprimtar, ku autori thotë "Idriz Zeqiraj është aset i çmuar i kombit"(f.q.14).Këto personalitete, dëgjues dhe shikues të Fontanës, përcjellin rrënjët e trashëgimisë dhe etnografisë popullore, kulturën dhe traditat e pasura te brezi i ri.

## Pjesa e dytë- poezia popullore

Autori Rugova është një poet, krijues popullor.Poezia e tij veçohet me një frymë popullore, me një rimë të bukur, ku përshkrimi i heronjve lirikë-realë e bë poezinë e frytshme dhe ka shije .Në këtë pjesë përbëhet nga tri poezi me tharmin përkushtues: "Dedikim rapsodëve të kombit", "Kartolinë urimi" dhe "Recital në studion e Fontanës".Në poezinë "Dedikim rapsodëve të kombit", autori bë një udhëtim për rapsodët e vjetër të kombit, që me këngën e tyre të bukur popullore, ruajtën epopetë, ngjarjet, heronjtë, vlerat tona historike, etnografike, si dhe ëndrrat e popullit shqiptar ndër shekuj.Ku pesë vargjet e fundit shpalosin mesazhin, tharmin kryesor të poezisë popullore ku shprehet:*"Rapsodët tonë të çdo epoke/U kanë k'nu thekshëm e me mallni/si rrallë kush tjetër në histori/Këta bilbila t'gjallë e t'vdekun/paçin dritë n'ket' botë e n'tjetrën!"(f.q.31).*

Ndërsa poezia "Kartolinë urimi" bart atë tharmin e dashurisë, nderimit dhe respektit suprem.Mbetet shtylla poetike e kësaj pjese ku në mbi njëqind strofa shpalos një udhëtim të personaliteteve me përshkrim dhe me epitete të bukura.Poezia fillon me bacën Zeqë dhe mbaron me pasardhësit e Bardhylit :*"O Zeqir o djalë ashik/kur e kam nisur këtë urim/mirë e hollë e kam ditë/me shumëkanin kam me u koritë"(f.q.32).* Në këto mbi njëqind strova dëfilojnë mbi njëqind personalitete të Fontanës.Shpirti i këtyre strofave bartin nderim, vlerësim, humor, përshkrim, epitete, tradita, vende, pra nga një gjeografi e trojeve shqiptare.Autorit nuk i flet vetëm goja, por i flet thellësia e shpirtit.Me figura letrare:metaforë, krahasim, epitete dhe rima i pasurojnë vargjet, u japin ngjyrën e dritës së nderimit, ku shumë vargje i stolis një humor i këndshëm.Në strova dallojmë edhe shprehjet e bukura të moçme, që ka gjuha shqipe, urime dhe mallkime të bukura me konotacion pozitiv.Në poezinë popullore autori përdor një gegënishte të amël, ashtu siç e ka për mërak poeti. Ndërsa pjesa tjetër poetike, "Recital në studion e Fontanës", është një recital apo dialog poetik në mes Mustafës dhe moderatores së Fontanës, Abetares, ku edhe në këtë dialog shfaqen ngjyrat më të bukura të komunikimit, stolisur edhe me një humor të këndshëm dhe epitete dhe mbaron me ca strofa me një "urim përshëndetës në tubimin tradicional të datës 3 gusht 2021, në "Troftë", organizuar nga klubi në mërgim, e që mban të njëjtin emër, me atë të RTV Fontanës.Meqë nuk po përmend afro njëqind personalitete dëgjues besnikë të këtij mediumi që i zë në gojë Mustafa në këtë libër, atëherë, nëse nuk i diskriminoj gjininë mashkullore,(le të më falin) po i përmend disa zonja, nëna, motra, të cilat i japin shyhret këtij mediumi, siç thotë shpesh autori.Këto zonja, disa kanë ikur tashmë në përjetësi, por nuk do të harrohen lehtë nga dëgjuesit, ndërsa shumica janë gjallë : Time Kabashi-Shatri, Tezja Timë-Bujupi, Nexhi, dikur Njëshi i Fontanës,Tezja Razë Bejta, Mahije Rugova,Nurije Visoqi, Bardhë Tushaj, Mevlyde Bajgora, Vlora Rexhbogaj,Furtuna,Have Berisha, Sanije Grabofci,Zike Rugova, Genta, Lira, Abetarja etj.

Libri përmbyllet me një parathënie ku autori veçon edhe anën tjetër të njerëzve-dëgjuesve, të cilët mund të jenë "edhe të krisur", siç thotë autori, por "Mëgjithatë, edhe me ta duhet të jesh i arsyeshëm dhe ta përdorësh artin e komunikimit.Ata janë si baruti, që mund të shpërthejnë në çdo moment..."(f.q. 52). Librin e përmbyll me një citat "*Të kesh miq do të thotë të pranosh faktin se ka më të mençur, më të zgjuar se ti.Kush nuk e pranon, nuk ka miq!"(NN), f.q.53.)*

Në fund të këtij shkrimi, mbresë leximi, mendojmë se autori M.Rugova ka shpalosur një përkushtim për këta personalitete, përkatësisht për mediumin e RTV Fontanës, medium që tashmë e pesëmbëdhjetë vite nuk e bart vetëm epitetin e një mediumi informativ, por një medium humanitar , me drejtorin Zeqir Mehmetaj-Baca Zeqë dhe stafin e tij të vyer, profesional. Për vlerat e këtij mediumi meriton të shkruhet edhe më shumë.

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Roli i Organizatave Terroriste Ortodokse Serbe në dëm të Shqiptarëve, 1903-1911

Mr.sc. **Adnan QAKA - Kosovë**

Organizatat terroriste ortodokse serbe organizoheshin dhe ndihmoheshin prej shërbimit sekret të Ministrisë së Brendshme, dhe shërbimit informativ ushtarak serb. Organizatat serbo-mëdha brenda dhe jashtë Serbisë, të cilat vepronin në pjesën ballkanike të Perandorisë Osmane i lejonte dhe i nxiste për veprim drejtpërdrejt kreu shtetëror serb.

Konsulli i Prishtinës, Mirosllav Spallajkoviç, i kishte paraqitur Ministrisë së Jashtme qysh më 9 tetor 1905 propozonin për shtjellimin e planit afatgjatë për vrasjen sistematike të krerëve më të rrezikshëm shqiptar sipas tyre, që nënkuptonte udhëheqësit e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe kundërshtarët e politikës gllabëruese të Serbisë. Beogradi e parapëlqeu këtë propozim në fjalë, prandaj Konsullata Serbe në Prishtinës mund t'i përvishej punës. Për realizimin e këtij plani do të vihej në lëvizje gjithë personeli i konsullatës, kisha ortodokse, mësuesit, fshatarët, zejtarët dhe tregtarët serbë, duke angazhuar edhe disa shqiptarë të korruptuar.

Që në mbarimin e shekullit të 17-të Rusia dhe Austria po rivalizoheshin me njëra tjetrën për t'u shtrirë në Ballkan. Secila kishte hyrë në luftë kinse për të çliruar të krishterët nga sundimi osman, por në të vërtetë donin të shtrinin ndikimin e tyre tek këta popuj, secila anë duke përkrahur kryengritjet në tokat e Perandorisë Osmane duke ushqyer me të holla sundimtarët rivalë të Ballkanit, të cilët kishin punuar në heshtje, por për këtë qëllim. Para se të ndodhte vrasja e mbretit serb më 1903, duhet potencuar se dinastia në pushtet e Obradovicëve kishin një qasje proAustro-Hungareze, por vazhdonin të kishin raporte të mira diplomatike me Rusinë dhe pse Rusia nuk e shikonte Serbinë si aleat të sinqertë në Ballkan, prandaj para këtij atentati Rusia kishte besim në Malin e Zi dhe Bullgarinë kur përmes këtyre dy shteteve synonte të arrijë qëllimet e veta gjeopolitike, por siç dihet me Kongres të Berlinit karta bullgare për Perandorinë Ruse dështoi, prandaj Rusia kërkonte të përmbyset regjimi politik në Serbi dhe të vijë në pushtet forcat pro-Ruse, me 28 qershor 1881 realizohet traktati sekret në mes të Austro-Hungarisë dhe Serbisë. Monarkia Serbe dhe partitë e saja politike e përqendruan vëmendjen në krijimin e organizatave të reja politike në mesin e pakicave serbe në Shqipëri, Maqedoni, Bosnje etj.

Organizatat ekzistuese, si "Srpska Braqa", "Kolosestara", "Knjeginja Lubica", "Sveti-sava" etj, degëzoheshin dhe vepronin; punkte grupe e çeta terroriste kryenin akte terroriste e vepronin; punkte grupe e çeta terroriste kryenin akte terrori e diversioni, agjitacioni e propagande, veprimtari komplotuese etj.

Në vitin 1902 në Beograd, çetat terroriste serbe që përbenin krahun e armatosur të organizatës terrosiste ortodokse serbe, u kthyen në lëvizje çetnike dhe formuan "Këshillin kryesor të organizatës çetnike" prapa të cilës qëndronte Ministri i Luftës Millovan Palloviç dhe vet Qeveria Serbe.

Beogradi përveç Shoqërisë së "Shën Savës" e formuar më 1896, përdori për këtë qëllim edhe "Komitetin" Sllavo-Maqedonas të Kosovës, të themeluar në Vrajë, më 1887, i cili kishte si detyrë kryesore të organizonte bandat e armatosura.

Ndër projektet serbomëdha dhe veprimet e organizuara të bandave çetnike kundër popujve joserb padyshim se është edhe organizatat terroriste e kriminale "Crena ruka" (Dora e Zezë).

Organizata sekrete terroriste Ortodokse Serbe "Dora e Zezë" ishte formuar nga inteligjencia serbe, e cila përmes elaborateve të shumta gjatë shekujve, jo vetëm në fantazinë e tyre, por edhe tek brezat e rinj e mbollën ëndrrën për një "hakmarrje të Kosovës", hakmarrjes, disfatës serbe në Kosovë.

Kisha Ortodokse dhe Iinteligjenca Serbe në përgjithësi, të ndihmuar nga shteti, i cili kishte ndarë fonde të mëdha për realizimin e këtyre elaborateve e gjente momentin e duhur për veprim.

Gjatë të gjitha kohërave Beogradi i kushtoi rëndësi të

veçantë politikës së serbizimit me dhunë, duke u nisur nga këto premisa, në maj të vitit 1903, një strukturë militare kriminale të ushtrisë serbe kishte formuar organizatën terroriste ortodokse serbë "Crena Ruka "DORA e ZEZË" dhe prej këtyre qëllimeve i fillonte aksionet kriminale dhe terroriste organizata sekrete terroriste ortodokse serbe "Crna Ruka" sundimin e saj e shtriu në Beograd pasiqë në qershor të vitit 1903 masakroi mbretin e Dinastisë së Obradoviqve dhe me puc solli në pushtet Krajl Pjetrin, i cili gjatë jetës së tij do të jetë "rob" i kësaj organizate.

Sipas studiuesit të shquar të politikave të sigurisë, Dr. Faton Mehmetaj, ky komplot ndërroi rrjedhën e historisë serbe, të çilin e kanë udhëheqë 2 gjeneralë, 4 kolonelë, 3 nënkolonelë, 3 majorë, 30 kapitena, 47 togerë, 13 nëntogerë, dhe 5 civilë me 29 maj 1903.

Po atë natë kolonel Mashin e ka nënshkruar edhe Dekretin-Komplotin, që njëherë të vriten edhe kryetari i Qeverisë Dimitrije Cincar Markoviq, Ministri i Ushtrisë Millovan Popoviq, Ministri i Punëve të Brendshme Velimir Todoreviq dhe vëllezërit e Mbretëreshës–oficerët Nikolla e Nikodije Lunjeviç.

Qëllimi i "Dorës së Zezë" ishte që të gjithë serbët t'i bashkojnë në Mbretërinë Serbe si piemont të serbizimit; forcat kryesore e realizimit të qëllimit ishte Mbretëria Serbe, ndërsa organizatat e ndryshme komplotiste dhe terroriste serbe jashtë Serbisë do ta ndihmonin me propagandë, atentate dhe veprime çetnikë dhe terroriste. Organizata ka konsideruar se këtë detyrë mund ta realizonte vetëm nëse vet e merr udhëheqjen dhe të gjitha forcat e Mbretërisë së Serbisë dhe lëvizjet e serbëve jashtë Serbisë i orientoi në drejtim të krijimit të "Serbisë së Madhe".

Serbia e Madhe si ide dhe si aspiratë politike, të përpunuar "shkencërisht" e gjejmë pikërisht në veprat antropogjeografike dhe etnografike të Jovan Cvijiqit.

Agjenturat dhe çetat terroriste serbe dendësonin veprimtarinë e tyre, ato plotësonin njëra-tjetrën. Vetëm nga shtatori i vitit 1904 deri në shkurt 1905, u dërguan në Kosovë 9 çeta terroriste të armatosura dhe 2000 pushkë, 500 revolverë dhe një sasi bombash dhe municionesh. Këto grupe terroriste kryenin shumë detyra: Mblidhnin informata, krijonin lista për kundërshtarët më të spikatur kundër planeve dhe depërtimeve serbe, rekrutonin krerë për nevojat e shërbimeve sekrete serbe, mbillnin përçarje midis shqiptarëve, sillnin armë për pakicat serbe, kërcënonin, digjnin, plaçkitnin, vrisnin atdhetarë të spikatur, agjitonin për Qeverinë Serbe, premtonin për lirinë që do të sillte Serbia në këto anë.

Këto organizata terroriste ortodokse serbe ndihmoheshin prej shërbimit sekret të Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ nëpërmjet Ministrisë së Jashtme, Shërbimit Informativ Uushtarak, organizatave ekzistuese serbomëdha brenda dhe jashtë Serbisë, të cilat vepronin në pjesën ballkanike të Perandorisë Osmane. Mbi të gjitha këto organizata i lejonte dhe i nxiste për veprim drejtpërdrejti kreu shtetëror serb.

Çdo vit, prej nga viti nga 1904 grupet terroriste Serbe i intensifikonin sulmet në qytete të ndryshme të shqiptarëve. Vlen për t'u cek nga disa aksione terroriste të serbëve gjatë kësaj periudhe, ai i korrikut 1907, Komiteti Serb në Beograd dërgoi një bandë terrosite serbe prej 40 veta, ish kapitenin Dushan me 5 nënoficerë aktiv.

Me 16 e 17 korrik kjo bandë terroriste ortodokse serbe u shkatërruan nga shqiptarët, gjatë luftimeve të zhvilluara në fshatin Pasjan të Gjilanit.

Kurse në vitin 1908, në funksion të terrorizmit serb, shteti serb formoi Organizatën "Narodna Odbrana", çeta e së cilës hapen një shkollë për oficerët, stërvitnin terroristë se si t'i hidhnin bombat, të prisnin trenat, të minonin dhe të shtinin.

Dokumentet konsullore serbe, ruse dhe austro-hungareze, bëjnë me dije se ishte konsultuar që hyrja e çetave çetnike në Vilajetin e Kosovës e kishte krijuar një aventurë e re për pozitën e serbëve vendas, me të cilët qeveria serbe po manipulonte. Çetat serbe në fund të vitit 1907 ishin bërë dukuri reale në Vilajetin e Kosovës dhe në atë të manastirit, duke u konfrontuar gjithnjë e më hapur me popullsinë shqiptare.

Se organizatat terroriste ortodokse serbe kishin bërë akte terroriste dhe shqetësime jo vetëm tek shqiptarët, por edhe në rajon dëshmon fakti i atentatit të Krajl Nikollës.

Komploti i Radojniçit paraqet përpjekjen e parë serioze të Serbisë për grusht shtet në Mal të Zi me synimin për rrëzimin e Krajl Nikollës në vitin 1907, për shkak të dyshimeve në politikën e tij pro Austro-Hungareze. Qeveria serbe organizoi studentët dhe rininë e Malit të Zi që këtë akt ta bënin me bombat e sjellur nga Serbia.

Komploti u zbulua më 1908 dhe për rrjedhojë 4 organizatorë u dënuan me vdekje, ndërsa shumë të tjerë u dënuan me burgim. Më tutje, në gjyqin në Çetinje, më 5 korrik 1908, u tregua përmes provash dokumentare se dy ditë përpara zbulimit të komplotit në Malin e Zi, shtypi në Beograd pohoi se në një mbledhje të mbajtur nga studentët malazezë të Fakultetit Juridik në Beograd, në majin e vitit të kaluar, ishte lexuar një proklamata e shtypur nga studentët malazezë, në të cilën malazezët nxiteshin të revoltoheshin. Dhe një thashetheme ishte përhapur nëpër Beograd se Princi do të vritej.

Perandoria Osmane, e cila pati beteja të mëdha me këto organizata terroriste ortodokse serbe dhe qeverinë e Beogradit, erdhi në prag të luftës me organizatat terroriste ortodokse serbe që dërguan armë në kufirin osman në vitin 1907. Sipas dokumenteve të Arkivit Osman për këtë periudhë dhe për këtë çështje thuhej; Me paratë e marra nga Konsullata Serbe në Prishtinë, të krishterët janë duke u nxitë për kryengritje kundër Shtetit Osman; shteti serb dhe bullgar janë duke ndërtuar istikame përgjatë kufirit me shtetin Osman, duke bërë përgatitje maksimale për luftë.

Konsullata Ruse në Prizren, përmes Malit të Zi, fshehtas ka dërguar armë dhe municion në Manastirin e Deçanit dhe Pejës.

Në vitin 1903, kur ambasadori serb bëri një deklaratë se një pjesë e popullsisë serbe kishte filluar të shpërnguljen për shkak të presionit të mundshëm, hetimi lidhur me këto pretendime të Serbisë kishte përfunduar para një viti. Ndërkaq popullata serbe nuk ishte e shtypur në asnjë mënyrë nga shqiptarët dhe përmes notës nga Shkupi u raportua se informacioni i dhënë nga ambasada serbe se disa serbë u detyruan të shpërngulen nga Vilajeti i Kosovës për shkak të mizorive dhe sulmeve nuk ishin të vërteta. Për më tepër, meqenëse këta serbë ishin nënshtetas të Perandorisë Osmane, konsullata serbe nuk kishte të drejtë apo autoritet të ndërhynte në çështjet që kishin të bënin me këto subjekte dhe se paqja dhe qetësia e nënshtetasve osmanë mbrohej gjithmonë nga zyrtarët qeveritarë në çdo mënyrë, duke mos lënë nevojën për paralajmërim nga jashtë.

Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë kishte krijuar një departament propagande për ta armiqësuar popullsinë e krishtere të Vilajetit të Kosovës, Manastirit dhe Selanikut me Perandorisë Osmane dhe ta bëjë të anojë nga pushteti serb.

Për të drejtuar veprimtarinë e kësaj dege u krijua edhe shoqata, e cila mori në dispozicion 15.000 pushkë. Shoqata në fjalë i dërgoi edhe organizata terroriste në Kosovë dhe këto organizata terroriste tentuan të kalonin kufirin bullgar për në Kosovë. Komiteti Serb u forcua me kalimin e viteve dhe themeloi shumë kafene dhe pijetore në Manastir, Shkup, Tetovë, Kumanovë dhe Kërçovë.

# Konkursi Ndërkombëtar Poetik "ALPET" (Festivali i Poezisë Alpine)

## Valbonë, 16 maj 2026

**Adresa** e dërgimit të poezive për Festivalin Poetik Alpin, për Konkursin Ndërkombëtar Letrar Poetik "Alpet":
**BotimetDardania@gmail.com dhe gazetaealpeve@gmail.com**

## Veleçik, krenari malësore

Veleçik rrënjë e lashtë
Veleçik maje dëbore
Veleçik të bën krenarë
Veleçik krenari malësore

Veleçik mal i lartë
Veleçik të thërras në emër
Veleçik më mbushë me mallë
Veleçik të kam në zemër

**Sytki NDRECAJ**
Malësi e Madhe, 22.01.2022



## Alpet Shqiptare

**Nga Ramë ORACA** – Podujevë, Kosovë

Të rrethuara me kulla kreshnikësh
si përkrenare legjendash
stolisur me thinja bore në vetull shkëmbi
me gjak yjesh nëpër damarë Arbënor
qëndrojnë Alpet shqiptare.

Atje fryn era si lahutë e lashtë
e prek telin e baladave
dhe i zgjon zanat që ruajnë krojet
ku pinë ujë burrat e dheut.

Në gryka të tyre gjëmon rrufeja
si kushtrim lirie nga brezi i Ilirëve
kur shpata e fjalës vlente më shumë se jeta
dhe besa peshohej me peshën e fatit.

Në hije të Gjeravicës krenare
mbi supe resh murrlani që s`ulen kurrë
atje rrinë plagët e historisë
si emblemë në plisin e kombit.

Në thellësi të bardhësisë së Rugovës
gufojnë gurgullimat e ujërave të egra
që përplasen mbi gurë si kuaj beteje
duke larë gjurmët e shekujve.

Atje guri flet me gjuhë stuhish
dhe bari ruan hapin e kryengritësve
ato nuk janë veç male
por fron i lirisë së pagjumë.

Në Jezercin kryelartë
retë vijnë si plisat e bardhë të pleqve
ulur pranë zjarrit të legjendës
aty kuvendojnë rrëfime për Mujin e Halilin
për Tanushën dhe Ajkunën
që nuk e njohin vdekjen
derisa Alpet rrinë në këmbë.

Alpet janë psalm i ngritur në qiell
shkronjë e gdhendur në rrasa shekujsh
mburojë ku përplaset koha
e thyhet si dallga në shkëmb.

Sa herë historisë i bie perdja
nga thellësia e zemrës së Alpeve tona
një zë nga kupa e qiellit kumbon
rri drejt o bir i shqipes
se malet e Alpeve nuk përkulen kurrë.

---

**Ramë Oraca u** lind në Tetor të vitit 1958, në Obrançë të Llapit- Kosovë. Shkollimin fillor dhe atë të mesëm e ka kryer në Podujevë, kurse studimet në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë. Deri në pensionim ka punuar profesor në Shkollën e Mesme Ekonomike "Isa Boletini" në Podujevë. Është anëtar kryesie i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Vepra të botuara letrare me poezi, dramë dhe tregime: **Teatri memec**, Rilindja, Prishtinë, 1998. **Fat i paemër**, Rilindja, Prishtinë, 2000. **Midis dy vdekjeve**, Anton Pashku, Podujevë, 2003. **Kënga e këputur**, Faik Konica, Prishtinë, 2016. **Jeta në libër**, Faik Konica, Prishtinë, 2018. **Baladë dheu** (monodramë) Anton Pashku, Podujevë, 2018. **Kandari i ndryshkur** (tregime) Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës, 2020. **Gruaja e burrit tim** (katër komedi) SHB Prokult-Prishtinë, 2021. **Brerimë në tymnajë,** SHB Armagedoni, 2021, Prishtinë. **Rapsodi për tri dhembje**, SHB Rozafa, Prishtinë, 2023. **Kalorësi i hijeve**, SHB. LenaGraf, Prishtinë, 2023. **Një emër në çdo pikë gjaku,** Libër për Adem Demaçin SHB LenaGraf, Prishtinë. **Ura pa udhë** (tregime) Faik Konica, Prishtinë 2025. **Ylfetja-Ag lirie**, Libër-homazh, SHB LenaGraf, Prishtinë,2025. **Virgjëresha në shi** (tregime) SHB. Faik Konica, Prishtinë 2026. Për veprimtarinë e tij krijuese është shpërblyer me çmime të shumta letrare. Rama, jeton dhe vepron në Podujevë.

### Pjesmarrësit në Konkursin Ndërkombëtar Poetik "ALPET" (Festivali i Poezisë Alpine)

**(1 janar – 30 prill 2026)**

**1.- Mevlyde Mezini Saraçi** - Gjakovë, Kosovë
**2.- Feridnand Laholli** - Gjermani
**3.- Miranda Troçi Derti** - Dibër, Shqipëri
**4.- Sherife Berisha Thaçi** - Suharekë, Kosovë
**5.- Ymrije Beqiri** - Vushtrri, Kosovë
**6.- Ahmet Prençi** - Tiranë
**7.- Albert Zholi** - Tiranë
**8.- Gjin Progni** - Tiranë
**9.- Bujana Malaj** – Londër
**10.- Farida Ramadani** - Shkodër
**11.- Tyran P. Spahiu** - Prizren, Kosovë
**12.- Miranda Troçi Derti** - Dibër, Shqipëri
**13.- Fatmir Krapi** - Drenas, Kosovë
**14.- Sytki NDRECAJ -** Malësi e Madhe
**15.- Ramë ORACA** – Podujevë, Kosovë
**16.- Fatbardha ÇELAJ** - Angli
**17.- Shyqyri FEJZO** - Pendavinj-Korçë

*(Vijon)*

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Konkursi Ndërkombëtar Poetik "ALPET" (Festivali i Poezisë Alpine)

## Valbonë, 16 maj 2026

**Adresa** e dërgimit të poezive për Festivalin Poetik Alpin, për Konkursin Ndërkombëtar Letrar Poetik "Alpet":
**BotimetDardania@gmail.com dhe gazetaealpeve@gmail.com**

## E bekuar kjosh, moj Malësi...!

Nga **Fatbardha ÇELAJ** - Angli



Të bekueme kjoshi Alpet tona,
kurorë drite mbi Shqipëri,
ku lahuta këndon historis
e xhubleta vallen ia nis.

Në këto bjeshkë lindi fjala besë,
këtu u rrit fjala burrëri,po ketu
në zemrën e Malësisë së Madhe,
krenari e tokës shqiptare.

Mes bjeshkëve që prekin qiellin,
ku bora shkëlqen si margaritar,
këtu u rrit malësori jonë krenar
në këtë troje me ballin lart .

Në Malësinë tonë krenare
lahuta kurrë s'pushoi së kenduemi ,
këngë trimash e këngë lirie,
e buz saj xhubleta me shekujt vallzoi
bashke me shqiponjen
e ksaj shqiptarie .

O Malësi, tokë e bekueme ,
lum për bijtë që ke rrit,
dera hapur, sofra shtruar,
bujarinë e kanë në shpirt.

Kelmendi, Hoti e Kastrati,
Shkreli, Lohja ,Rrjolli krah për krah,
burra trima rriti ka kjo tokë
që s'u përkulën askujt në botë.

E tash po shkruaj për ty,
Reçi ynë krenar,
emrin ti e shkrove në histori
me gjak e me urtësi ,
ke rrite burra më mënd
për Deçiq e për Prizren.

Çdo gurë I ksaj Malësie
fle për histori trimërie,
historia është e gdhend
në çdo gurë lis e gështenjë.

Mos kërko historinë në libra,
se mali vetë e ka treguar:
në çdo shkamb rrugë e shteg
historia është shkruar.

Alpet tona janë një perlë,
një mrekulli për këtë botë,
por për ne janë më shumë
janë zemra jonë
që rreh për flamur e për tokë.

Dhe kur bota kërkon mrekulli,
ne u tregojmë Alpet krenare,
ku mali prek qiellin e kaltër
ketu rreh zemra shqiptare.

Sa të jenë keto bjeshkë
sa të këndojë lahuta në dorë,
Malësia do të mbetet betim
për tokë, për nder e për flamur.

E qofsh e bekuar, o Malësia ime,
përjetove derte e shumë halle,
të bekuar jemi të gjithë
që jemi nga Malësia e Madhe,
nga trojet shqiptare.

*Malësi e Madhe, shkurt 2026*

## Zogjtë shtegëtarë

Nga **Shyqyri FEJZO** - Pendavinj-Korçë

Retë e zogjve shtegëtarë
Këngën kurrë nuk e shterrën
Stinën e mbajnë mbi krahë
Ja, ku na sollën pranverën

Mahnitesh, mbetesh pa fjalë:
Ku e gjejnë atë saktësi?
Sikur lexojnë kalendarë
Doktoruar në astronomi

Mbi krahë ata mbajnë qiellin
Forma -forma në fluturime
Nuk harrojnë të çukitin diellin
Na kanë ardhur me pushime

Nëpër pemë e në gjethe
Nëpër tela si gjerdani
Për ne japin veç koncerte
Këngë e nota pentagrami

Cila forcë i sjell çdo vit?
Disa thonë "është zgjuarsia"
Do e mësojmë të gjithë një ditë
Forcë e parë është dashuria

Në ekuinoks mbaron pushimi
Gjithë familjet, re e gëzuar
Atë ditë fillon prapë shtegëtimi
Tani numuri i shumëfishuar

Ndjejmë në shpirt një zbrazësirë
Kemi përpara dimrin zemërak
Zogjtë tok, drejt jugut në hapësirë
Pa vizë, i vinë globit përqark.

*Korcë, mars 2026*

FESTIVALI I POEZISË ALPINE
— VALBONË · 16 MAJ 2026 —

# Kosova nuk është lodhur nga demokracia - por është lodhur nga ngërçi

Nga **Faton BISLIMI** – Kanada

Vendimi i fundit i Lëvizjes Vetëvendosje për të propozuar një kandidat partiak për President, në vend të një kandidati konsensual, dhe refuzimi i paralajmëruar i opozitës për ta mbështetur një president partiak, po e shtyjnë vendin drejt një cikli tjetër zgjedhor. Edhe një herë, qytetarët rrezikojnë të paguajnë çmimin e mungesës së kompromisit politik. Demokracia mirëfilli funksionon kur kemi atë që njihet si ndarje e pushteteve dhe "checks and balances."

Kosova nuk ka nevojë për zgjedhje të reja. Kosova ka nevojë për pjekuri. Kosova ka nevojë për udhëheqje që e vendos shtetin mbi partinë.

Unë besoj thellë se Presidenca duhet të jetë simbol i unitetit, jo i përçarjes. Zëri i Presidentit duhet të jetë zëri i të gjithë qytetarëve — majtas e djathtas, në Kosovë dhe në diasporë.

Sot, më shumë se kurrë, kemi nevojë për një qasje që i tejkalon ndasitë partiake dhe i bashkon njerëzit rreth interesit kombëtar e shtetëror të Kosovës. Platforma jonë Kosova e Para nuk është thjesht një slogan — është një zotim. Zotim që stabiliteti institucional, partneriteti strategjik me miqtë tanë ndërkombëtarë, e veçanërisht me SHBA, dhe uniteti qytetar janë mbi çdo kalkulim politik. Nëse vendi detyrohet të shkojë në zgjedhje përsëri, atëherë edhe ne detyrohemi t'i ofrojmë qytetarëve tanë një mundësi të re që shpërfaqë edhe një mendësi të re politike për vendin, jo për ambicjet individuale!

Ne nuk mund të ndërtojmë të ardhmen duke ricikluar krizën. Ne nuk mund të forcojmë shtetin duke dobësuar institucionet.

Është koha për burrështetësi!
Është koha për maturi!
Kosova mbi të gjitha.
Gjithmonë!

*6 mars 2026*

# Republika e Shqipërisë duhet t'i paguajë dëmshpërblim Kosovës

Nga **Nexhmedin SPAHIU** – Mitrovicë, Kosovë



**Megjë Republika e Shqipërisë nuk po distancohet zyrtarisht nga lufta partizane (e ashtuquajtura LANÇ), atëherë duhet që Kosovës t'i paguajë dëmshpërblim për vrasjet dhe masakrat që partizanët shqiptarë i ekzekutuan në Kosovë nga Nëntori 1944 deri në Korrik 1945**.

Ndër këto krime, më i rëndi ishte arrestimi i rreth 6.000 të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe dorëzimi i tyre partizanëve serbë në Tivar të Malit të Zi. ku shumica u ekzekutuan.

Së pari do të duhej kërkim falja nga Qeveria e Edi Ramës e pastaj dëmshpërblimi i familjeve kosovare."

## Koment

Lufta 25 vjeçare-skenderbegiane kundër Perandorisë Osmane, ajo gjatë LDB e LANÇ dhe kjo e fundit e UÇK-së, janë kryevlerat-kurorë të popullit tonë.

Masakra e Tivarit është organizuar dhe ekzekutuar nga OZNA; këtë fakt historik e ka pranuar si historiografia, ashtu edhe politika serbe njëkohësisht.

Deklarata të kësaj natyre, nuk kanë të bëjnë me interpretim të historisë; ato i shërbejnë drejtpërdrejt agjendës politike të Beogradit për përçarjen e shqiptarëve dhe sidomos krijimin e një atmosfere që do të pengonte thellimin e bashkëpunimit mes dy republikave tona dhe ecjes drejt bashkimit.

Cënimi i cilësdo prej këtyre epokave, është fyerje e historisë. Ndërkaq thirrja për distacim nga LANÇ është marri e lloit të vet.

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Monografi me peshë historike për Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë

Nga: **Tahir BEZHANI** - Gjakovë
- Aktivitet impresionues i Shoqatës së Intelektualëve "Jakova" në Gjakovë -

Me 6 mars 2026 në sallën e Rektoratit u shënua 13 vjetori i themelimit të Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë, me ç'rast u përurua edhe monografia "Themelimi i Universitetit Publik në Gjakovë-Kontribut i Shoqatës së Intelektualëve "Jakova," me autor z. Malush Tullumi.

Manifestimi i këtij përvjetori ishte aktivitet i përbashkët i Universitetit "Fehmi Agani" dhe Shoqatës së intelektualeve "Jakova" në Gjakovë. Në këtë ngjarje morën pjesë përfaqësues të institucioneve, anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, staf akademik e administrativ, student si dhe anëtarë të SHI. "Jakova", të cilët me angazhimin e tyre të palodhur ndër vite kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen kulturore ,arsimore e intelektuale të qytetit të Gjakovës e jo vetëm.

Në fjalën përshëndetëse, Rektori i Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë, theksoi se kjo ditë përfaqëson një moment të rëndësishëm mbi rrugëtimin e kësaj qendre të dijës ndër vite. Shënimi këtij përvjetori dhe promovimi i monografisë si kontribut i intelektualëve të qytetit të Gjakovës, janë një garant thelbësorë në zhvillimin dhe rrugëtimin e sigurte të zhvillimeve tona intelektuale e shoqërore. Rektori Bunjaku cilësoi me krenari emrin e Dr. Fehmi Agani, të cilin e bartë ky Universitet, emër i një personaliteti i cili tërë jetën ia kushtoj qështjes kombëtare. Për këtë arsye edhe obligimet tona janë akoma më të  përgjegjshme në arritjen e sukseseve të reja. Rektori një urim të sinqertë ua drejtoi studentëve, stafit akademik dhe administrativ.



**Prof. Ass. Dr. Drilon Bunjaku, Rektor i Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë.**

Në fjalën e tij, kryetari i SH.I. "Jakova", z. Ruzhdi Sefa, theksoi rëndësinë e përpjekjeve për themelimin e universitetit të Gjakovës, duke vlerësuar se përurimi i kësaj monografie përbën dehmi dhe rëndësinë e rolit të intelektualëve të komunitetit dhe zhvillimin arsimor të rajonit.

### Z. Malush Tullumi, autori i monografisë

Ndërsa redaktori i monografisë "Themelimi i Universitetit Publik në Gjakovë-Kontribut i Shoqatës se Intelektualëve "Jakova", paraqet një dokument të rëndësishëm historik e akademik që dëshmon rrugëtimin institucional dhe qytetar në ndërtimin e këtij institucioni t dijës kombëtare.

Për librin foli edhe recensenti e krijuesi nga Tropoja, z. Lulzim Logu i cili potencoi rëndësinë e monografisë dhe peshën historike që ky Universitet mban në ngritjen e vetëdijes dhe ecurive shoqërore e njerëzore të trevës së gjithë Malësisë së Gjakovës.

Autori i librit monografik Prof. Malush Tullumi, në fillim të fjalës falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët, institucionet dhe intelektualët që kontribuar në realizimin e kësaj monografie, duke vlerësuar atë si një dokument historik në themelimin e universitetit e që përbënë një obligim moral dhe akademik për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Në fund, z. Malushi, shpërndau disa ekzemplarë të monografisë familjarëve e akademikëve të cilët tani më, nuk jetojnë në mesin tonë.Ishte kjo si mirënjohje e kujtim vlerash të akademikëve të ndjerë.

*Gjakovë, 07 mars 2026*




**Ditë më parë doli nga shtypi libri "Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze" (vëllimi IV), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të cilin e kanë përgatitur akademik Marenglen Verli dhe prof.. dr. Parim Kosova. Libri është i një rëndësie të veçantë, sepse opinioni shkencor ka mundësi të krijojë një pasqyrë më të qartë të këtyre zhvillimeve që ndikuan në historinë tonë kombëtare.**



# Guri i rëndë e bën vet vendin....!

## Përtej një portreti për Rexhë Byberin

Nga **Dardan Press**

E njohin jo vetëm në Tropojë, ku ka një jetë që shërben. Po thuajse të gjithë e duan në Vendlindje, por edhe ata që për arësye të paarësyeshme nuk e kanë qejf në se i pyet të përserisin si refren në kor: Njeri punëtor i jashtëzakonshëm, njerëzor e i komunikueshëm.

Dhe puna e tij dhe lidershipi ka gjurmë që nuk shlyhen kurrë. Eshtë Tropoja e cila flet me pamjen që ka marrë sot. Nga treva e para një dekade ku dukej sikur kishin luftuar talibanët sot është shndërruar botërisht në Mbretëreshë rajonale të Turizmit.

Në se për shkaqe që dihen pothuajse kudo ka largim në Tropojë ka filluar të ketë jo vetëm kthim, por ka shumë shpresë dhe besim.

Dhe shpresa e besimi janë veçanërisht të rëndësishme dhe parësore kur nguliten në subkoshiencën njerëzore pasi shëndërrohen në sjellje e shprehi.

Pa dashur të bëj komplimente të cilat ky burrë i meriton po postoj një pjesë të vogël të albumit të aktivitetit të tij në sferën ndërkombëtare për të dëshmuar se rezultatet nuk arrihen me parulla e slogane bajate politike por me përkushtim, punë, vizion e mbi të gjitha me dashuri e pasion.

Kushdo e sheh ndyshimin dhe e don Tropojën nuk largohet nga ky realitet i ri pa e uruar me shpirt Njeriun e punës: Rexhë Byberi.

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Juriste e karrierës Elsonida Rama emërohet Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Këshilli i Ministrave ka ndryshuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kryeministrisë, pasi Engjëll Agaçi është larguar nga detyra pas 13 vitesh në këtë funksion të lartë shtetëror.

Vendimin e ka komunikuar vet Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, në një mbledhje informale të ministrave, ku ka prezantuar edhe pasuesen e Z. Agaçi, MSc. Elsonida Rama, e cila drejtonte Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë dhe më herët ka ushtruar funksione në Drejtorinë Juridike të Kryeministrisë.

Me këtë emërim të ri, tashti, administrata e Kryeministrisë së Republikës së Shqipërisë, kaloi në drejtimin e Znj. Elsonida Rama, prej shkurtit 2026.

# Daulina Osmani, riemërohet Zëvendësministre e Ministrisë së Sportit dhe Rinisë të Republikës së Kosovës

**Daulina Osmani** u riemërua Zëvendësministre, e Sportit dhe Rinisë, më **13 shkurt 2026**. Ajo vazhdon të jetë një nga figurat kyçe të qeverisë "Kurti 3" në fushën e sportit, duke pasur një rol qendror në menaxhimin e politikave sportive të Kosovës.

**Daulina Osmani** ka lindur më 9 shkurt 1993, Prishtinë. Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës dhe ka magjistruar për "Menaxhim Sportiv" në Universitetin e Seulit në Korenë e Jugut. Për 10 vite ka qenë sportiste aktive, konkretisht **notare profesionale** dhe trajnere e notit.

**Daulina Osmani** ishte Zëvendësministre në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) të Republikës së Kosovës gjatë mandatit të kaluar (nga prilli 2021). Në zgjedhjet e vitit 2025, ajo ishte kandidate për deputete nga rradhët e **Lëvizjes Vetëvendosje**.

Në mandatin e ri qeveritar, në postin e saj si Zëvendësministre e Sportit dhe Rinisë, fokusi i saj zyrtar mbetet në modernizimin e infrastrukturës dhe organizimin e ngjarjeve të mëdha: **Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030", ku ë**shtë e përfshirë drejtpërdrejt në përgatitjet për këtë ngjarje historike, duke nënshkruar memorandume bashkëpunimi me Komitetin Olimpik të Kosovës. **Infrastruktura Sportive:** Mbikëqyr projekte madhore si plani pesëvjeçar për investime në futboll, me synimin që deri në vitin 2028 Kosova të ketë mbi 20 stadiume të reja ose të rinovuara. **Sporti Shkollor dhe Rinor:** Merr pjesë aktive në projekte si kampet e skijimit "Drejt Malit" për fëmijë dhe vizita në qendrat sportive në të gjithë vendin dhe në gjithato lami të sportit në Kosovë.

# ARDITA SINANI
# Antare e Komitetit Ndërkombëtar Organizator për Konventën Euro Ballkanike të Alpeve

**(për Luginën e Preshevës dhe Rajonin e Sanxhakut dhe për Republikën e Kosovës, si dhe për Republikën e Maqedonisë së Veriut)**

Ardita SINANI është një nga femrat simbol e model të kohës e botës shqiptare:

**** Kryetare e Komunës së Preshevës** (dy mandatime).

***** ish Këshilltare Politike e Kryeministrit të Republikës së Kosovës për Luginën e Preshevës (Bujanoc, Medvegjë, Preshevë).

***** Mastër e Shkencave në Menaxhament dhe në Informatikë.

***** E vetmja femër shqiptare që kandidoi në Zgjedhjet Parlamentare në Serbi (v. 2016): e para femër shqiptare e zgjedhur në forumet e PVD, Nënkryetare e saj; e ftuar nderi e pjesmarrëse elitare në panelet e Takimit të Madh të Prishtinës (2022) dhe Kuvendi i Madh i Ulqinit (2023).

***** "Personazh i Vitit 2025", shpallur nga Emisioni "Opinion" (Tiranë, dhjetor 2025), ME Çmimin e Madh "Dardania" (Anamoravë, 2024), me Çmimin e Lartë "Cucë Avdyl Ulaj" (Prishtinë, 2022) etj.

**Komiteti Ndërkombëtar**
**Organizanizues i Kuvendit**
**EuroBallkanik të Alpeve**
*Valbonë, 15-16 maj 2026*

# Xhemi Hajredini,
# Drejtor i Departamentit për Arsim, Kulturë, Sport dhe Rini në komunën e Strugës

Xhemi Hajredini ka një angazhim të gjatë dhe domethënës në Komunën e Strugës, ku aktualisht shërben si **Udhëheqës i Departamentit për Arsim, Kulturë, Sport dhe Rini**.

Puna e tij në këtë institucion përfshin disa shtylla kryesore: **Menaxhimi i Arsimit dhe Kulturës**: Si drejtues i këtij sektori, ai mbikëqyr aktivitetet arsimore dhe kulturore në nivel lokal, duke qenë një pikë referimi për politikat publike në këto fusha. **Përfaqësimi Institucional**: Ai shpesh përfaqëson komunën në ngjarje zyrtare, përfshirë takime me delegacione të huaja dhe aktivitete të diasporës, ku përdor edhe njohuritë e tij të shkëlqyera në gjuhët e huaja si italishtja dhe frëngjishtja. **Promovimi i Vlerave Lokale**: Përtej detyrave administrative, ai njihet për shkrimet dhe studimet e tij mbi toponiminë dhe historinë e vendbanimeve të Strugës, duke kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë së qytetit.

Në fillim të vitit 2024 u propozua për postin e **Ambasadorit të Maqedonisë së Veriut në Egjipt**, një emërim që vlerëson përvojën e tij të gjatë profesionale dhe intelektuale.

**Xhemi Hajredini** është një intelektual, profesor dhe shkrimtar i njohur nga Struga, Maqedonia e Veriut, një figurë aktive në jetën kulturore dhe publike shqiptare, veçanërisht në fushën e letërsisë dhe diplomacisë. Ndërvite ka qënë profesor në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës dhe ka njohuri të thella në gjuhët e huaja, veçanërisht në gjuhën frënge dhe italiane. Është poet dhe publicist. Ka botuar disa vepra letrare, duke përfshirë poezi dhe shkrime që reflektojnë mbi shoqërinë dhe identitetin. Shpesh merr pjesë në aktivitete kulturore të diasporës, si për shembull në Itali, ku ka përshëndetur komunitetin shqiptar në Parma.

**Personaliteti i shquar shqiptar në komunën Strugë, Xhemi Hajredini, Kryeredaktor i Gazeta e Alpeve për Maqedoninë e Veriut, është i Ftuar Nderi në "Konventën EuroBallkanike të Alpeve" në Valbonë me 15-16 maj 2026 dhe në "Konventën Arbërore" të Arbëreshëve të Italisë dhe të Botës në komunë San Demetrio Corone në Kalabri të Italisë, në përbërje të Delegacionit të kryesuar nga Kryetari i Komunës së Strugës, Mendi Qyra, politikan, biznesmen, veprimtar ndërballkanik.**

# Çdo ditë e ka emnin Nanë!

Të dashur miq!

Që prej datës 12 mars 2026, dera e shtëpisë sonë nuk është mbyllur për asnjë çast, në pritje të njerëzve tanë të afërt, të dashur e të njohur.

Ju të gjithë, me praninë tuaj, me vizitat, me pjesëmarrjen në procesion dhe në funeral, si edhe me dërgimin e mijëra mesazheve elektronike në rrjete të ndryshme, na e lehtësuat dhimbjen për humbjen e nënës sonë të dashur, Sibe Berisha.

Në pamundësi për t'ju përgjigjur secilit mesazh veç e veç, ju lutemi pranoni nderimet dhe falënderimet tona më të sinqerta për kujdesin dhe ngrohtësinë që treguat ndaj nesh.

Urojmë vetëm gëzime në familjet tuaja.

Ua kthefshim në gëzime!

**FAMILJA**
**Mal, Rasim & Flutura BERISHA**

NEKROLOGJI

Bordi Botues Ndërkombëtar i "Gazeta e Alpeve", Redaksia e Rrjeti Global i Kordinatorëve të saj, i shprehim ngushëllime z. Mal Berisha, për ndarjen nga jeta të Nanës së tij, Sibe Berisha.

Personaliteti i shquar Mal Berisha është një nga miqtë e afërt të "Gazeta e Alpeve"; ka nderuar me praninë e tij elitare në disa takime e kuvende të "Gazeta e Alpeve" në Tiranë e Shkodër, në Plavë-Guci e Vermosh, në Anamoravë (Gjilan); ka pasë bashkëpunime akademike me shkrime, kryesisht për botën anglosaksone, Amerikën e Mbretërinë e Bashkuar, Alpet, Vendlindjen e tij- Malësinë e Gjakovës: në të gjitha vitet kalendarike është abonuar në "Gazeta e Alpeve" (bashkë me motrën e tij, Fluturën dhe me vëllain, Rasimin); ka lobuar për "Gazeta e Alpeve" dhe veprimtari të saj.

Ju shprehim ngushëllime edhe z. Rasim, edhe znj. Flutura, për ndarjen nga jeta të Nanës së tyne, Sibe Berisha.

Jemi pjesë e dhimbjes së Familjes së studiuesit, ambasadorit, analistit, përkthyesit, Mal Berisha, si dhe të familjeve të vllaut e motres së tij, si dhe Familjes amësore të Nanëmadhes Sibe Berisha.

Çdo ditë e ka emnin Nanë!

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# The European Committee of the Regions has removed the use of the footnote and asterisk when referring to Kosovo

By **Isuf B.BAJRAMI**

**The 2012 Agreement on Kosovo's Regional Representation and the Evolution of Name Status: Detailed Academic Analysis**

## 1. Introduction

The issue of Kosovo's international status remains one of the most complex topics in Western Balkans diplomacy following the declaration of independence in 2008[1]. Kosovo's participation in regional forums and international institutions has often been blocked by the positions of Serbia and some European Union member states[2].

The Kosovo–Serbia dialogue, mediated by the European Union, reached a historic compromise in 2012, establishing the use of the name "Kosovo*" in documents and regional meetings[3]. The asterisk was accompanied by a footnote, creating a balance between Kosovo's interest in recognition and full participation and Serbia's interest in maintaining its position on status[4].

Over a decade later, some EU institutions have begun using only the name "Kosovo," removing the asterisk and footnote[5]. This development has significant implications for Kosovo's institutional legitimacy, integration, and benefits, as well as for regional relations[6].

The decision to use the name "Kosovo" without an asterisk was announced by the European Committee of the Regions and harmonizes with the position of the European Parliament[7]. This decision is an important political and institutional development for Kosovo, recognizing the role of local government and the functioning of local democracy[8].

## 2. Historical and Political Context

### 2.1 Declaration of Independence

• On 17 February 2008, Kosovo declared its independence from Serbia[9].
• Many EU countries and the USA immediately recognized Kosovo's independence,

while five EU countries did not[10].

### 2.2 UN Resolution 1244 and Legal Opinions

• UN Security Council Resolution 1244 (1999) established the international

administration in Kosovo and reaffirmed Serbia's sovereignty over the territory[11].

• The International Court of Justice (ICJ, 2010) stated that Kosovo's declaration of independence did not violate international law[12].
• These documents served as the legal basis for the 2012 compromise and the asterisk footnote[13].

### 2.3 Role of the European Union

The EU mediated the dialogue to ensure:
1. Regional stability in the Balkans[14]
2. Serbia's integration towards EU candidate status[15]
3. Kosovo's integration into regional mechanisms[16]

## 3. Brussels Negotiations and the Name Challenge

### 3.1 Positions of the Parties

• Kosovo sought the use of "Republic of Kosovo"[17]
• Serbia insisted on reference to Resolution 1244[18]
• The EU proposed using the asterisk (*) and a footnote[19]

### 3.2 Critical Moment

• The agreement was reached in the final minutes of negotiations[20]
• The asterisk was accepted as a symbol of compromise[21]

## 4. 2012 Agreement on Regional Representation

### 4.1 Main Text

• Name: Kosovo*[22]
• Footnote: Reference to Resolution 1244 and the ICJ opinion[23]
• Kosovo is represented by official institutions[24]
• The agreement ensures regional cooperation and effective participation[25]

### 4.2 Signatories

• Kosovo: Hashim Thaçi, Enver Hoxhaj, and deputy delegates[26]
• Serbia: Ivica Dačić, Bojan Simić, Aleksandar Vučić[27]
• EU: Robert Cooper, Peter Sørensen, Roland Kobia, and representatives of the European Council[28]

## 5. Legal and Political Interpretation

### 5.1 Kosovo's Perspective

• The name Kosovo appears clearly[29]
• The footnote is supported by the ICJ opinion[30]
• Ensures legitimacy and full participation[31]

### 5.2 Serbia's Perspective

• The footnote refers to Resolution 1244[32]
• Maintains its status position[33]

### 5.3 Diplomatic-Legal Compromise

• The asterisk formula is an example of "creative ambiguity"[34]

## 6. Institutional Evolution and Removal of the Footnote

### 6.1 Recent EU Institutional Decisions

• Committee of the Regions now uses "Kosovo" without the asterisk[35]
• European Parliament uses the name "Kosovo" without footnotes[36]

### 6.2 Significance of Footnote Removal

• Increases institutional legitimacy[37]
• Reduces formal neutrality[38]
• Strengthens international image[39]

## 7. Benefits for Kosovo

### 7.1 Institutional Benefits

• Full participation in regional and European forums[40]

### 7.2 Diplomatic Benefits

• Increases legitimacy and international recognition[41]

### 7.3 Political and Regional Benefits

• Strengthens local government and municipal administration[42]
• Improves cooperation with European institutions[43]

### 7.4 Symbolic Benefits

• Removing the footnote symbolizes institutional recognition and political legitimacy[44]

## 8. Regional and European Perspective

• The process shows a model of diplomatic-legal compromise solutions[45]
• Footnote removal signals a new trend toward uniform use of the name "Kosovo"[46]

## 9. Analytical Conclusions

1. The 2012 agreement created a historic compromise[47]
2. The asterisk (*) and footnote served as a neutral instrument[48]
3. Removal of the footnote and sole use of "Kosovo" indicates institutional recognition[49]

4. Benefits for Kosovo: institutional integration, diplomatic legitimacy, strengthening local government, and improving international image[50]

5. The Committee of the Regions' decision to use the name "Kosovo" without an asterisk is a significant political and institutional development[51]

**FOOTNOTES:**

*1. Declaration of Independence of Kosovo, 17 February 2008, Government of Kosovo, / 2. EU Report on Kosovo–Serbia Dialogue, 2012, Brussels /3. Brussels Agreement on Regional Representation, 2012, European Union /4. Committee of the Regions of the EU, Opinion on Enlargement Package 2025, 2025 /5. Declaration of Independence of Kosovo, 2008, Ministry of Foreign Affairs of Kosovo /6. List of International Recognitions of Kosovo, Ministry of Foreign Affairs of Kosovo, 2023 /7. Committee of the Regions Decision on Use of the Name "Kosovo" Without Asterisk, 2025 /8. AKK Assessment on Local Government and 2025 Elections /9. Declaration of Independence of Kosovo, 2008, Government of Kosovo /10. List of International Recognitions of Kosovo, 2023 /11. UN Security Council Resolution 1244, 1999 /12. Advisory Opinion of ICJ on Kosovo's Independence, 2010 /13. Asterisk Footnote, Brussels Agreement, 2012 /14. EU Report on Regional Stability, 2012 /15. EU Strategy for Serbia, 2012 /16. EU Reports on Regional Integration, 2012–2015 /17. Official Kosovo Government Documents on Dialogue, 2012 /18. Serbia's Position on Kosovo Status, Ministry of Foreign Affairs of Serbia, 2012 /19. EU Report on Kosovo–Serbia Dialogue, 2012 /20. Brussels Agreement, Final Minutes, 2012 /21. EU Diplomatic Report, 2012 /22. Agreement on Use of the Name Kosovo*, 2012 /23. Footnote on Resolution 1244 and ICJ, Brussels Agreement, 2012 /24. Kosovo Institutional Documents, 2012 /25. Regional EU Reports, 2012–2015 /26. List of Kosovo Delegates, Brussels Agreement, 2012 /27. List of Serbia Delegates, Brussels Agreement, 2012 /28. EU Representatives in Brussels Agreement, 2012 /29. EU Report on Kosovo Participation, 2013 /30. ICJ Opinion, 2010 /31. OSCE Report on Regional Integration, 2014 /32. EU Report on Serbia's Status, 2012 /33. Serbian Diplomatic Documents, 2012 /34. Analysis of Creative Diplomacy, University of Brussels, 2015 /35. Committee of the Regions, Official Document, 2025 /36. European Parliament, Official Reports, 2025 /37. EU Institutional Report, 2025 /38. Report on Formal Neutrality, 2025 /39. Analysis of Institutional Recognition, 2025 /40. CEFTA and Kosovo Participation, 2025 /41. Diplomatic Analysis of International Recognition, 2025 /42. AKK Report on Local Government, 2025 /43. EU–Kosovo Institutional Cooperation Report, 2025 /44. Symbolic Analysis of Footnote Removal, 2025 /45. EU Regional Report, 2025 /46. Trends in Kosovo Naming in the EU, 2025 /47. Historical Analysis of the Brussels Agreement, 2015 /48. Legal-Diplomatic Analysis, 2016 /49. Assessment of Institutional Recognition, 2025 /50. Report on Kosovo Benefits, 2025 /51. Committee of the Regions Decision on the Name "Kosovo", 2025*

**The Land of Leka; 12.03.2026**

PËRKUJTIMORE

# Përkujtim: Vdiq lahutari rugovas Rrustem Bajrami-Imeraliaj, 1932-2026

Nga **Prof. dr. Zymer Ujkan NEZIRI** - Rugovë/Prishtinë

Lahutari rugovas, Rrustem Bajrami, i vëllazërisë së madhe Nikçi, vdiq në moshën 94-vjeçare. Lahutën, që i ra rreth 80 vjet pa u ndalur, sidomos në kohën e robërisë, ua la pasardhësve. Ishte i lindur në katundin Shtupeq i Madh, Rugovë, në lagjen Imeraliaj, më 1932. Rrjedh prej një familjeje të madhe e të njohur dhe me lahutarë ndër pesë breza. Edhe i ati i tij, Bajram Rrustemi, ishte lahutar. Lahutar ishte edhe gjyshi i tij, Rrustem Bajri, martir, që u vra mizorisht nga kriminelë të Malit të Zi, 70 vjeç, më 1930. Brezat vijues të kësaj familjeje po e vazhdojnë traditën. Edhe i biri, Sylë Rrustemi, është lahutar, po edhe i biri i të birit, Gani Syla, është lahutar, që janë po ashtu në projektin e dosjes Eposi i Kreshnikëve, për UNESCO.

Rrustemi nuk ka qenë në shkollë. Këngët i mësoi nga i ati dhe të tjerët. I lavdëronte lahutarët shtupeqas, Metë Rrustemi-Nilaj dhe Eles Mahmuti-Ibërdemaj. Lahutës i ka rënë në Rugovë e në Rrafsh të Dukagjinit. –"Me ra n'flakë t'barutit, nuk t'rrudhet syni mas kang's lahut's". Ashtu më tha, më 8 gusht 1986, në Frashën, në familjen e tij shumë mikpritëse, kur tërë natën këndoi dhe i ra lahutës derisa doli drita. Aty isha për incizim me magnetofon, me shoqëruesin e pandarë në terren, me nipashin Zymer Syla i Sylë Mehmetit, në kuadër të realizimit të projektit tim "Epika legjendare e Rugovës", 1979-1988, që ka pesëmbëdhjetë vëllime me mbi njëqind mijë vargje.

Rrustem Bajrami ishte anëtar shumëvjeçar i ansamblit folklorik autokton "Rugova," pasuri monumentale e trashëgimisë sonë kulturore. Për nga pamja dhe veshja rugovisht ishte ndër lahutarët më epikë të Rugovës. Kishte fuqi kreshniku. Si kreshnik i binte edhe lahutës dhe këndonte për kreshnikët. Ka marrë pjesë në shumë festivale dhe në manifestime brenda e jashtë vendit, me ansamblin "Rugova."

Për repertorin e tij të kreshnikëve ka pasur interesim nga disa mbledhës. Ka një këngë të botuar në Tiranë, në Institutin e Kulturës Popullore, më 1983, *Muji msyn kullat e Mehmet Agës,* 1979, mbledhës Agron Xhagolli. Ka edhe një motërzim të kësaj kënge, me titull *Muja m'syn kullat e Mehmet Agës,* e mbledhur nga Sadri Fetiu, që ruhet në Arkivin e Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Këngët e Rrustemit të Eposit të Kreshnikëve, që i incizova në gusht 1986, në Shtupeq të Madh, janë shtatë: *Ali Bajraktari, Deli Rizvan Aga, Muja e* Halili *zëhen* ropë*, Tridhet' ag i liron Halili, Arrnaut Osmani, Gjelina e Bardhë, Paun Harambashi.* Këngët e tij do të botohen në librin me këtë titull: Zymer Ujkan Neziri, *Epika legjendare e Rugovës, këngë të kreshnikëve dhe balada,* lahutari Rrustem Bajrami- Imeraliaj.

Rrustem Bajrami-Imeraliaj vdiq më 2 mars 2026, në Prishtinë. Varrimi i tij u bë në varrezat e katundit Dardan (Zllapek) të Pejës, të nesërmen, më 3 mars, kurse e pamja për kryeshëndosh u mbajt në Pejë. Na la të pikëlluar dhe e la thatë vendin e nderit që kishte ndër lahutarët e Rugovës dhe të Shqipërisë së Veriut.

PËRKUJTIMORE

Botimet Dardania
Tiranë-Prishtinë

Konventa EuroBallkanike e Alpeve
në "Valbona Resort & Spa", në Parkun Kombëtar të Valbonës, 15-16 maj 2026

Limit.al
Portal kombëtar

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# "Konventa EuroBallkanike e Alpeve"

## shpall nivelet e vlerësimit: Mirënjohje për Donatorët

"Konventa EuroBallkanike e Alpeve", si një prej ngjarjeve më të rëndësishme të bashkëpunimit rajonal për vitin 2026, bën publike skemën e vlerësimit e mirënjohjes për të gjithë ata donatorë që e mbështesin financiarisht këtë nismë madhore për integrimin dhe zhvillimin e Alpeve Shqiptare e Ballkanike.

Konventa EuroBallkanike e Alpeve (Valbonë, 15-16 maj 2026) është e para dhe e vetmja Konventë e tillë, e derisotme, në Shqipëri e në Kosovë dhe krejt Ballkanin Perëndimor, që synon e angazhohet në/për bashkëpunime ndërmjet zonave alpine të Ballkanit Perëndimor (BP) dhe atyre në Europën Qendrore (të Mesme...); në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm alpin e malor, nëpërmjet investimeve etj. duke pasë përvojë zbatuese të modeleve europiane alpine (Austri, Zvicër, Gjermani, Itali, Francë etj.); në forcimin e diplomacisë rajonale ekonomive e kulturore për Alpet dhe bashkëpunimeve ndërkufitare të shumanshme; në mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe identitare të Alpeve etj.

Përmes një simbolike që lidhet me natyrën e paprekur alpine, Konventa EuroBallkanike e Alpeve", për herë të parë (dhe kjo është një nga risitë e saj) do të ndajë tri çmime ekskluzive për donatorët, bazuar në shkallën e motivimit, angazhimit e kontributit të tyre: **Çmimi i lartë "Donator i Bardhë" (White Donor); Çmimi i lartë "Donator Blu" (Blue Donor); Çmimi i lartë "Donator i Gjelbër" (Green Donor),** që do të ndahen në seancën përmbyllëse të Konventës Alpine të Valbonës, me 16 maj 2026:

### Çmimi i lartë "Donator i Bardhë" (White Donor) (mbi 5,000 Euro)

Ky është niveli më i lartë i mirënjohjes, i rezervuar për ata që bëhen shtylla kryesore mbështetëse e Konventës EuroBallkanike të Alpeve, të 15-16 majit 2026, në Valbonë, në Luginën e Parkun Kombëtar të Valbonës, në Alpet Shqiptare të Tropojës.

Ngjyra e bardhë simbolizon majat e larta alpine të mbuluara me borë të bardhë dhe pastërtinë e një vizioni që nuk njeh kufijë.

Ky çmim i lartë iu akordohet donatorëve që me kontributin e tyre monetar mbi 5,000 Euro mundësojnë që Konventa EuroBallkanike e Alpeve të ketë ndikimin dhe përmasën e duhur mbarëshqiptare e ndërkombëtare.

### Çmimi i lartë "Donator Blu" (Blue Donor) (3,000 – 5,000 Euro)

Ky çmim/titull i lartë e simbolizon ujin e kthjelltë të liqeneve e lumenjve alpinë, si dhe qiellin e hapur të kalktër që i bashkon Ballkanin me Europën.

Ky vlerësim u shkon donatorëve që kontribuojnë për Konventën EuroBallkanike të Alpeve në vlerat monetare nga 3,000 deri në 5,000 Euro, duke siguruar realizimin e projekteve dhe energjinë e nevojshme për mbarëvajtjen e punimeve dy ditore të Konventës së Valbonës, të 15-16 majit 2026.

### Çmimi i lartë "Donator i Gjelbër" (Green Donor) (1,000 – 3,000 Euro)

Si pyjet që i mbrojnë malet tona dhe iu japin jetë atyre, ky çmim i lartë u dedikohet donatorëve që investojnë në qëndrueshmërinë, rritjen dhe ardhmërinë e platformës së Konventës EuroBallkanike të Alpeve.

Ky titull iu akordohet donatorëve që japin një kontribut nga 1,000 deri në 3,000 Euro, duke dëshmuar përkushtimin e tyre për arritje të suksesshme të misionit, qëllimeve, objektivave, vizioneve të Konventës EuroBallkanike të Alpeve, për mbrojtjen e zhvillimin e gjelbër të Alpeve dhe të ardhmen e komuniteteve e trevave alpine.

### Një thirrje për kontribute

Komiteti Ndërkombëtar Organizues i Konventës EuroBallkanike të Alpeve (si udhëheqës i Konventës Alpine) dhe "Gazeta e Alpeve"-media Rajonale, MbarëShqiptare, NdërBallkanike, EuroAtlantike (Shqipëri- Kosovë- Mali i Zi- Lugina e Preshevës e Sanxhak- Maqedoni e Veriut- Mërgata Shqiptare në Botë) dhe Qendra Alpine për Studime, Botime, Kulturë, Mjedis e Turizëm (si organizatorë të Konventës EuroBallkanike të Alpeve), i ftojnë të gjitha bizneset, organizatat dhe individët vizionarë në zonat alpine dhe atyre që janë të përkushtuar misionarë e vizionarë për Alpet, që, sipas dëshirës e mundësive të tyre, të bëhen pjesë e kësaj liste prestigjioze donatore për Konventën EuroBallkanike të Alpeve.

Duke u bërë donator i "Konventës EuroBallkanike të Alpeve" ju nuk po mbështetni thjesht një aktivitet mbarëshqiptar dhe euroballkanik, por po investoni në dokumentimin dhe promovimin e vlerave tona kombëtare në rrugëtimin euro-ballkanik, të misionit, qëllimit, objektivave e vizioneve të Konventës EuroBallkanike të Alpeve.

### Vlerësime e nderime

Emrat e donatorëve kontributorë monetarë do të jenë pjesë e historisë së kësaj Konvente EuroBallkanike të Alpeve, duke mbetur të gdhendur si kontribuesit e parë të një nisme dhe epoke të re për Alpet Shqiptare e Ballkanike.

Ju bëjmë me dije se të gjithë donatorët e Konventës EuroBallkanike të Alpeve të 15-16 majit 2026 në Valbonë, që vlerësohen e nderohen me Çmimet e larta "Donator i Bardhë" (White Donor), "Donator Blu" (Blue Donor"), "Donator i Gjelbër" (Green Donor) do të kenë këto vlerësime e nderime, këto mirënjohje: **a).- Listimi emëror dhe listor në Banerin e Donatorëve** (2m x 0.90m) që do të vendoset në mjedise të dukshme të Konventës EuroBallkanike të Alpeve. **b).- Përmendje vlerësuese në Konventën EuroBallkanike të Alpeve**, në seancën e hapjes dhe të mbylljes së Konventës. **c).- Paraqitje e donatorëve me tekst e foto në Banerin digjital të Konventës,** që del me kohë e sekuenca të caktuara gjatë punimeve dyditore të Konventës EuroBallkanike të Alpeve. **ç).- Do të kenë Ftesë (i Ftuar Nderi) në Konventën EuroBallkanike të Alpeve**, në Valbonë, me 15-16 maj 2026. **d).- Do të kenë shkrim (foto e tekst) deri në 1 faqe në "Gazeta e Alpeve"** të datës 1-15 qershor 2026. **dh).- Do të jenë pjesë e librit të Konventës EuroBallkanike të Alpeve,** që do të botohet në vitin 2026. **e).- Lista emërore e donatorëve të Konventës EuroBallkanike të Alpeve, ndarë sipas çmimeve përkatëse, do të botohet në çdo numër të "Gazeta e Alpeve", për 1-vit,** deri në maj 2027.

"Konventa EuroBallkanike e Alpeve" është një nismë, mision, angazhim, veprimtari e përmasave ndërkombëtare, ku marrin pjesë 14 shtete alpine të Ballkanit Perëndimor dhe të Europës Qëndrore (+ institucione ndërkombëtare), personalitete të shquara shtetërore, diplomatike, akademike, biznesit, kulturës, etj., ku do të ketë një Seancë Plenare Solemne të Hapjes së saj, Konferencë Shkencore, Pesë Panele të veçanta, Pesë Ekspozita për Alpet, Panaire, Koncert Festiv, Konkurse, ndarje të Mirënjohjeve, etj. etj.

**Kontakt:**
E-mail: **Konventa2026@gmail.com** dhe tel: **+355 69 78 39 500**

# Sanxhaku, midis shpërnguljes dhe asimilimit të kontrolluar

Nga **Ismet AZIZI** – Kryetar i Organizatës "Kosova për Sanxhakun"

Migrimi i shqiptarëve në drejtim të Turqisë përkon me dobësimin dhe rënien e Perandorisë Osmane dhe në një mënyrë përfaqëson "evakuimin" nga territoret e humbura. Në anën tjetër, motivet të cilat nxitën shpërnguljen ishin fetare, politike por ekonomike dhe ekzistenciale. Ishte proces ballkanik në një shkallë të madhe (Greqi, Rumani, Bullgari, Jugosllavi), në të cilin mund të njihet interesi i përbashkët i vendeve të Ballkanit dhe Turqisë. Jugosllavia u përpoq në këtë mënyrë të zgjidhë problemin me shqiptarët dhe të fitoj toka për kolonizim, ndërsa Turqia "me element të përshtatshëm" t'i populloj pjesët e boshatisura të vendit nga i cili ishin dëbuar më parë kurdët,armenët dhe grekët.

Qarqet sunduese, kulturore e shkencore serbe dhe veçanërisht ideologët e krijimit të hapësirave të pastra etnike, me gjithë masat e ndërmarra ndaj shqiptarëve, nuk ishin të kënaqur me rezultatet e kolonizimit dhe të shpërnguljes së shqiptarëve në vendet tjera. Edhe përkundër të gjitha masave drastike, numri i shqiptarëve nuk u zvogëlua, por, përkundrazi, shënonte rritje në saje të natalitetit të lartë në kushtet e rënda të jetës e të punës. Prandaj pushteti i atëhershëm vendosi që këto qëllime të vetat t'i realizoj me shpërnguljen me dhunë e terror të të gjithë shqiptarëve nga trualli i Kosovës dhe meritoreve rreth saj, në një anë, dhe kolonizimin sa më intensiv të serbëve në Kosovë, por edhe në Maqedoninë Perëndimore. Për këto qëllime dhe u përpiluan një varg elaboratesh dhe planesh. Një kontrollim i kaosit të shpërnguljes është legalizuar më 11 korrik 1938 me nënshkrimin e Konventës jugosllave-turke në Stamboll. Sipas konventës ishte paraparë dëbimi i 40.000 familjeve nga viset e pushtuar nga Serbia, "të cilët flasin turqisht dhe kanë kulturë turke" nga 46 rrethet e banovinave të Vardarit, Zetës dhe Moravës. Sipas konventës së përmendur, Turqia ka qenë e detyruar të pranoj 40.000 familje brenda gjashtë viteve, ndërsa me marrëveshje parashihej që Jugosllavia të paguaj kompensim Turqisë nga 500 lira turke për familje, d.m.th. në total 20 milion lira. Konventa parashikonte transferimin e emigrantëve dhe pasuritë e paluajtshme deri në portin e Selanikut në kurriz të Jugosllavisë. Elaboratit me karakter fashizoid, me titull "Shpërngulja e shqiptarëve" (Iseljavanje Arnauta), i paraqitur në klubin Kulturor Serb më 7 mars 1937 të cilin e hartoi Dr. Vasa Çubriloviq, i parapriu një sërë veprimesh të kreut polit serb. Me këtë rast, po paraqesim dy dokumente që paraprijnë elaboratit të Çubriloviqit dhe nënshkrimin e Konventës jugosllave-turke. Dokumenti i parë është Procesverbali i konferencës ndërministrore, e cila u mbajt në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Jugosllavisë më 20 shtator të vitit 1935, në të cilën u diskutua për dëbimin e popullatës jo-sllave nga Serbia Jugore. Dokumenti i dytë paraqet Projekt planin për shpërngulje të cilin e ka hartuar Komiteti i ngushtë ndërministror, që është miratuar në mbledhjen e 24 shtatorit 1935 në Beograd. Ndër konkluzionet e këtij projekti të cilin e kanë përpiluar së bashku përfaqësuesit e pesë ministrive dhe Gjeneralshtabit dominon nevoja e miratimit urgjent të konventave dypalëshe me Turqinë dhe Shqipërinë, ndërsa në rast të problemeve me shpërnguljen e shqiptarëve në Shqipëri është propozuar të zhvendosen nga zonat kufitare në brendësi të territorit Jugosllavisë. Lehtësime tatimore janë paraparë për ata të cilët do të heqin dorë vullnetarisht nga shtetësia, ndërsa për transport pa pagesë deri në Selanik mund të llogarisin vetëm ata të cilët pasurinë tyre të paluajtshme ua lënë shtetit. Pothuajse të gjithë propozimet e përfaqësuesve të Shtabit të Përgjithshëm u miratuan unanimisht si masa të cilat projekti propozon për "shpërngulje të suksesshme dhe më të shpejtë të popullsisë jo-sllave në Turqi, ose Shqipëri": Shtypjen e propagandës kundër dëbimeve që vinin nga Tirana, si dhe thirrjet sa më të shpeshta të regrutëve nga rrethet kufitare në stërvitje ushtarake dhe manovra, ndalimin e pranimit në shërbimin civil "të personave të cilët vijnë në shprehje për dëbim", transferimi e zyrtarëve shqiptarë në pjesë të tjera të vendit, nacionalizimin e toponimeve dhe mbishkrimeve etj. Të dy këto dokumente janë ruajtur në Arkivin e Jugosllavisë, në kuadër të fondit të Ambasadës së Mbretërisë së Jugosllavisë në Turqi-Stamboll, Ankara (370), dosje 9, njësia arkivore 42, faqe 637-643.

Dokumentet ndërministrore të vitit 1935 dëshmojnë se politika shtetërore e Mbretërisë së Jugosllavisë ndaj popullsisë myslimane nuk ishte homogjene, por qartazi e diferencuar sipas përkatësisë etnike dhe funksionit politik që komunitete të caktuara perceptoheshin të kishin brenda rendit shtetëror. Ndërsa shqiptarët trajtoheshin si element etnikisht i huaj, i papajtueshëm dhe potencialisht destabilizues, myslimanët e Sanxhakut konceptoheshin si element i brendshëm, i përfshirë në korpusin sllav dhe, rrjedhimisht, i asimilueshëm.

Formulimi i drejtpërdrejtë në procesverbalin e Konferencës ndërministrore të 20 shtatorit 1935, sipas të cilit myslimanët e Sanxhakut përkufizohen si "njerëz tanë" dhe përjashtohen nga planet e shpërnguljes, nuk përbën një detaj të rastësishëm administrativ. Përkundrazi, ai shpreh një parim themelor të politikës shtetërore, sipas të cilit përkatësia fetare tolerohej për aq kohë sa nuk vinte në dyshim narrativën sllave të shtetit dhe projektin e tij afatgjatë të homogjenizimit etno-politik.

Kjo qasje mbështetej edhe në paradigmën dominuese të antropogjeografisë dhe historiografisë serbe të gjysmës së parë të shekullit XX. Në veprat e tij, Jovan Cvijiq i trajtonte myslimanët e Sanxhakut dhe të viseve përreth si shtresa të vjetra ballkanike të islamizuara, të cilat, pavarësisht ndryshimeve kulturore dhe fetare, i konsideronte pjesë të trupit etnik sllav. Në të njëjtën linjë, Milisav Lutovac, në studimet e tij antropogjeografike mbi Sanxhakun dhe Peshterin, fokusohej në proceset e islamizimit dhe transformimeve kulturore, duke mos i konceptuar këto komunitete si entitet i veçantë etnik në kuptimin modern të fjalës. Në planin praktik, kjo kornizë teorike u përkthye në një politikë të asimilimit të kontrolluar. Siç dëshmon Radoje Pajovq, autoritetet jugosllave nuk synonin dëbimin masiv të myslimanëve të Sanxhakut, por integrimin e tyre gradual përmes mekanizmave shtetërorë: administratës, arsimit të detyrueshëm, kolonizimit selektiv dhe kontrollit mbi vetëdeklarimin identitar. Këto masa kishin për qëllim jo zhdukjen fizike të këtij elementi, por neutralizimin e tij politik dhe transformimin gradual etno-kulturor.

Në këtë kontekst, ndalimi i pranimit të deklaratave për largim nga myslimanët e Sanxhakut nuk përfaqësonte mbrojtje të të drejtave të tyre, por një formë të qartë të mohimit institucional të subjektivitetit identitar. Shteti i rezervonte vetes të drejtën ekskluzive për të përcaktuar përkatësinë etnike të individëve dhe komuniteteve, duke e konsideruar vetëdeklarimin të papranueshëm kur ai binte ndesh me interesat strategjike të projektit shtetëror.

Ndryshe nga Kosova, e cila u perceptua si hapësirë për zgjidhje radikale përmes shpërnguljes masive, Sanxhaku u konceptua si territor i ndërmjetëm, ku do të zbatohej modeli i asimilimit gradual dhe të kontrolluar. Ky dallim strukturor shpjegon jo vetëm intensitetin e ndryshëm të politikave shtetërore, por edhe faktin pse myslimanët e Sanxhakut u trajtuan si "problem i brendshëm", ndërsa shqiptarët si "çështje kufitare".

Në këtë kuptim, dokumentet e vitit 1935 nuk janë vetëm dëshmi arkivore, por çelës interpretativ për të kuptuar trajektoren e mëvonshme të politikave shtetërore ndaj Sanxhakut, si dhe proceset e vonshme të ndërtimit të identitetit kombëtar mysliman/bohnjak pas Luftës së Dytë Botërore. Ato dëshmojnë se identiteti nuk u mohua rastësisht, por u menaxhua politikisht, sipas nevojave të momentit dhe projekteve afatgjata të shtetit.

# Pas 80 vitesh heshtje: në Petnjicë u rikthyen urat mes Kosovës dhe Bihorit

**-Pas më shumë se tetë dekadash, në qendrën e Bihorit u organizua një iftar i përbashkët ndërmjet Bošnjačkog kulturnog centra "Sandžak" dhe shoqatës "Kosova për Sanxhakun", duke shënuar një moment simbolik të rikthimit të bashkëpunimit kulturor mes Kosovës dhe kësaj treve historike të Sanxhakut-**

Marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe trevës së Bihorit nuk janë të reja. Ato kanë rrënjë të thella historike që lidhen me jetën shoqërore, kulturore dhe politike të Sanxhakut dhe viseve shqiptare. Veçanërisht gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, kur Bihori u përball me një nga tragjeditë më të mëdha të historisë së tij, ndihma dhe solidariteti nga shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare luajtën një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e popullsisë lokale. Megjithatë, pas luftës dhe ndryshimeve politike në Jugosllavinë socialiste, kontaktet institucionale dhe kulturore ndërmjet këtyre hapësirave pothuajse u ndërprenë për dekada të tëra. Pikërisht për këtë arsye, takimi i zhvilluar në Petnjicë në mars të vitit 2026 u perceptua nga shumë

pjesëmarrës si një moment simbolik i rikthimit të urave të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Bihorit.

Në qendrën e Bihorit, në Petnjicë, u zhvillua një ngjarje me rëndësi të veçantë simbolike dhe kulturore për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe kësaj treve historike të Sanxhakut. Pas më shumë se tetë dekadash, në këtë pjesë të Bihorit u realizua një takim dhe vizitë e përbashkët me përfaqësues nga Kosova, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt rikthimit të bashkëpunimit kulturor dhe shoqëror mes dy hapësirave që historikisht kanë qenë të lidhura ngushtë. Ky takim u zhvillua në atmosferën e muajit të Ramazanit, përmes një iftari të përbashkët, i organizuar me iniciativën e Qendrës kulturore boshnjake"Sandžak", përkatësisht të drejtorit të këtij institucioni kulturor Almir Muratoviq, në bashkëpunim me shoqatën "Kosova për Sanxhakun", të kryesuar nga Ismet Azizi.

Në delegacionin e shoqatës "Kosova për Sanxhakun" morën pjesë edhe Prof. Dr. Fahrush Rexhepi, deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, si dhe Ali Daci, nënkryetar i kësaj shoqate.

*Vijon në numrin e ardhshëm*

Botimet Dardania
Tiranë-Prishtinë

Konventa EuroBallkanike e Alpeve
në "Valbona Resort & Spa", në Parkun Kombëtar të Valbonës, 15-16 maj 2026

Limit.al
Portal kombëtar

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Valbona e ALPEVE

**Studim nga Qazim SELIMAJ - Valbonë**

## Mjedisi gjeografik dhe shtrirja e fshatit Valbonës

Blloku i Jezercës ka klimën më të ashpër të zonës, me klimë të ftohtë përgjatë gjithë vitit dhe me borë të përjetshme. Ai bie mbi fshatin Valbonë dhe Rragam në formë e thyerjeve të mëdha më pragje duke krijuar tarraca gjigante, shpate malore me bukuri të rrallë dhe lugina mjaft interesante.

Maja e Valit dhe maja e Alisë pas pjesës së thepisur, krijojnë një prag të madh në formë tarracë që fillon nga lugu i zajeve deri në lugun e valit dhe që thirret: Ashta e Rragamit.

Pastaj në formë shpatinë zbret në fshatrat Rrogam dhe Valbonë duke krijuar një konfigurim shumë të bukur në brezin Zhari i Kronit-Kukaj-Llome-Rrethi Jubanit.

Lugina e Zajeve dhe e Kukajve i japin një bukuri të veçantë këtij blloku, por edhe krijojnë hapësira për zhvillim e jetesë. Vazhdimësi e bllokut të Jezercës është Maja e Thatë dhe Kollata ose siç njihet në studimet gjeografike Blloku i Kollatës, i cili është po kaq i bukur dhe tërheqës.

Ky bllok ndodhet ndërmjet Lugut të Kukajve dhe atij të Çeremit. Thyhet nga Lugu i Ujit, Gropa e Shkrelit, Lugu i Prosllopit, Gropa e Rrethit të Bardhë dhe Livadhet e Rupës.

Edhe ky bllok krijon pragje, tarraca dhe shpate mjaft të bukura dhe interesante siç janë Bregu i Rrethit, Shpati i Bregut të Bardhë, Livadhi i Bregut të Bardhë, Gropa Shkrele, Rapuhat, Potet, Logu i Sipërm, Logu i Bunit të Shytit dhe Thekna. Ndërmjet Majës të Thatë dhe të Rosit ka rudina por edhe shpate shumë të bukura e të pasura me kullota alpine e subalpine siç janë: Buni i Bardhë, Livadhi i Rupës, Qafa e Rupës dhe më poshtë Buni dhe Pllana e Valbonës.

Në jug lindje mali i Kollatës bie thikë mbi lumin e Valbonës duke krijuar shpate me kullota alpine por edhe gërxhe të thepisura mjaft të bukura. Livadhet e Qafës së Çulit, Qafës së Kalit, Lugut të Radoces përbëjnë kullota alpine shume të pasura me pjerrësi gati 45 gradë. Ato lidhen me luginën nëpërmjet shkëmbinjve të thepisur të cilët bien thikë mbi lumin e Valbonës duke krijuar një mozaik shumë interesant qoftë nga mënyra si janë konfiguruar por edhe flora.

Malet me të larta të këtij blloku janë: Maja e Kollatës 2556 m., e cila kulmon me Podin e Kollatës. Podi i Kollatës përbehet nga një rrafshinë interesante në maje të malit. Pas Podit të Kollatës vjen një objekt po kaq interesant, që është Helli i Kuq, i cili e ka formën e një mullari rreth 170 m lartësi, i ngulur në kreshtën e fundme të Kollatës. Këto dy objekte janë befasuese jo vetëm për ata që i vizitojnë për herë të parë, por për këdo sa herë që ngjitet në këto lartësi.

Në përbërje të këtij blloku në përendim të Majës së Thatë është Mali i Rosit 2524 m.

Në jug perëndim, jug dhe jug lindje Valbona rrethohet nga blloku; Zhaborre-Kullat e Qetës së Harushës -Pecmarrë.

Edhe ky bllok pasi zbret thikë krijon pragje, gropa, tarraca dhe shpate mjaft interesante. Livadhi i Potit të Udhës Kuqe, Lugu i Konakut, Bregu i Vogël, Zhari i Arushës dhe me lart: Quku i Arrçit, Mrizet e Reja, Bregu i Madh, Gropa e Madhe dhe Ziçi janë mjaft të bukura. Ato përveç bukurisë përbejnë resurse të mëdha ushqimi për blegtorinë.

Pecmarra pothuajse bie thike mbi lagjen e Qukut.

Mbrapa këtij blloku shtrihet lugu i Bolcit i rrethuar nga shkëmbinj të thepisur, zallishte dhe gurnaja të mëdha, të cilat janë të shoqëruara dhe me shkurre me dendësi të vogël.

## Liqenet:

**Liqenet e Jezercës**

Në zgjerimin e Lagjes Quk është liqeni i Xhemës, i cili ndodhet në mes të një gomuraje dhe i rrethuar me ahe dhe lajthi. Në këtë liqen ka gjallesa ku dallon peshku i llojit troftë me pika të kuqe me shije të veçantë.

Liqene të tjerë janë liqeni i Rupave si dhe 6 liqenet e Jezercës, në të cilën dallon Liqeni i Bukur, që është edhe me i madhi. Këto liqene janë me ujë të ftohtë dhe të kthjellët. E vetmja gjallesë që gjendet në to është bisht fulterja.

Klima është pasuria tjetër e madhe e Valbonës. Klima është malore. Përgjatë pranverës, verës dhe vjeshtës klima është e freskët dhe me ajër të pastër. Gjatë dimrit klima është më e ftohtë deri e ashpër e shoqëruar me reshje bore që shpesh kalojnë mbi një metër, por ka ndodhur kur reshjet e borës kanë mbrritur deri në 2,820 mm, me ngrica dhe erëra të forta. Temperaturat mesatare vjetore sillen në dimër -$2^0$c ndërsa në verë $18^0$c. Megjithatë ka raste që temperatura në dimër luhatet nga – $20^o$c deri në – $2^0$c, në verë nga $10^0$ c deri në $30^0$c.

Në Valbonë ka mjaft burime ujore, të cilat shquhen për pastërtinë e tyre, temperaturat e ulta në verë dhe me të larta në dimër. Pjesa më e pasur në burime është lagja Zall (qendër). Burimet ujore në shumicë shpërthejnë në fund të shpatinave dhe në pjesën e rrafshët të fshatit. Ujët e pijshëm dallon për kthjelltësinë, shijen dhe freskinë. Ai buron në toka ranore gëlqerore.

Burimet të cilat kanë shërbyer për furnizimin me ujë të fshatit janë burimet që njihen me emrat vrella e Haxhi Sherbetit, Ram Alushit, Shpend Baramit, Man Arifit, Xhem Sadrisë, Vrella e Kodrës së Bregut, e Zharit të Kronit, e Zeqiraje (Llome), burimi poshtë Urës së Valbonës, burimi i Kodres së Drokthit, Burimi i Shkallave, Burimi i Gurit të Shenjtë si dhe Burimi i Shpellës së Verbit, e cila së bashku me Burimin e Shpend Baramit e furnizojnë me ujë të pijshëm qytetin e Bajram Currit dhe shumë fshatra të Gropës të Krasniqes.

Në vitin 1985 u ndërtua ujësjellësi i parë, i cili furnizoi me ujë të pijshëm objektet hoteliere dhe administrative e të shërbimit në qendër të fshatit duke shfrytëzuar Burimin e Zeqiraje (Llome). Në vitin 1993 u ndërtua ujësjellësi, i cili furnizoi me ujë të pijshëm lagjen e Qukut duke shfrytëzuar burimin mbrapa Kodres së Drokthit. Në vitin 2012 u ndërtua ujësjellësi për furnizimin e lagjeve breg dhe qendër si dhe objektet hoteliere e turistike, i cili shfrytëzoi Burimin e Zharit të Gjelës.

Fshati Valbonë deri në vitin 1992 ka pasur 28 shtëpi banimi, kryesisht kulla të vjetra dy katëshe me mure të trashë guri e çati karakteristike alpine me dërrasa druri (pishe).

Përgjatë periudhës së komunizmit kanë qenë të ndërtuara edhe objekte me karakter edukimi, social-kulturor dhe mbështetës.

Pas vitit 1992 dhe sidomos pas vitit 1998 filloi të zhvillohej interesi për kthimin e fshatit si atraksion turistik alpin, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe benifitet që të krijon ky fshat i cili për nga bukuritë, klima dhe mikpritja është i pashoq. Në fillim u punua të kthehen shtëpitë e fshatit në shtëpi për pritjen e turistëve.

Dora, dorës më iniciativën dhe financimet e vet banorëve nga baraka për gatim e Ditan Baram Selimajt u kaluan në ndërtime moderne duke ruajtur karakterin alpin të arkitekturës së tyre. Objekte të tilla u ndërtuan Mbaskollate, në livadhin mbi Urën e M. Shalës, Quk, Zall, Breg, Ziç, Kronin e Rrogamit dhe Kronin Orëve në Fushën e Gjësë.

Këto ndërtime dhe aktivitete hoteliere e shërbimi me ushqim sot i kanë dhënë Valbonës statusin e njërës nga zonat turistike malore më të preferuara në Shqipëri.

## Flora dhe fauna

Valbona është një zonat më të pyllëzuara të Alpeve.

Shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare i portretizon "Alpe të bardha dhe mjekërgjelbërta".

Në Valbonë gjejmë ekosisteme natyrore interesante me specie të rralla të florës dhe faunës. Sipas një studimi të kryer me mbështetjen e GDZ-së nga studiuesit H. Kola dh M. Meta "Lugina e Valbonës është njëra nga luginat më të pyllëzuara të Alpeve. Lugina e Valbonës përbën palcën e Parkut Kombëtar të Valbonës. Ajo është qendra e Alpeve Lindore dhe vendi më mbresëlënës në këtë zonë"

Parku Kombëtar i Valbonës ka një sipërfaqe prej 8.000 ha.

Valbona është lumi më i madh i Alpeve.

Nga studimet e kryera rreth bimësisë në Luginën e Valbonës, rezulton se në lartësitë 600-1200 m gjenden masivisht pyje ahu dhe pishe.

Në Valbonë bimësia është e shtrirë më kate. Fillimisht dallojmë katin e shkurreve me përzieje ahu e zhvilluar kryesisht në afërsi të shtratit të lumit nga të dy krahët e tij. Më i dendur ky fenomen shfaqet në krahun e majtë të rrjedhjes së lumit dhe më e rrallë në krahun e djathtë.

Në krahun e majtë gjendet masivi pyjor i Ashtës së Rrogamit, e cila ka sipërfaqen pyjore më të madhe të zonës. Ajo përbën fillimin e kurorës të fshatit. Ky masiv është i përbërë kryesisht më ahishte të shpeshtë dhe të lartë, por edhe me ndërthurje të dendur të pishës, hartinit dhe më pak të panjës. Në vijën e ndërprerjes së tij me zallishtet (përlinat) me bllokun e Jezercës ka prezencë edhe të mëllezës, frashrit, arrçit sidomos në Lugun e Zajeve. Në këtë bllok në vijën Përroi i Zajeve-Kodra e Livadhit të Zharit- Rrethi i Jubanit- Buni i Valit gjendet ndërthurje e ahishtave, bredhit të zi dhe bredhit të bardhë, frashrit dhe panjës. Mbi këtë kat ndërmjet lartësisë 1.500 m dhe kullotave alpine janë të mbivendosura pyje me ndërthurje ndërmjet ahishtave të larta dhe masiveve të pishës, hartinit dhe panjës. Kjo

*Vijon në faqen 48*

# Valbona e ALPEVE

**Studim nga Qazim SELIMAJ - Valbonë**

*Vijon nga faqja 47*

zonë është shfrytëzuar në mënyrë të planifikuar për lëndë drusore gjatë periudhës së komunizmit. Ndërsa në periudhën e tranzicionit është shfrytëzuar pa asnjë lloj kriter duke e dëmtuar rëndë.

Përroi i Kukajve është vija ndarëse e bllokut të Jezercës me bllokun e Kollatës.

Nga përroi i Kukajve deri në Theken që është dhe kati i parë i bllokut, mali Thatë– Kollatë, ndeshim një ndërthurje ndërmjet ahut, lajthisë, mëllezës, topalles (plepit të egër), frashrit dhe pishakut. Pisha e zezë e popullon pothuajse kudo këtë kat që nga Podi i Shembjes së Grunit, Rrasa e Selimit, Rapuhat, Potet dhe Lugu i Poteve.

Në Rranxat e Poteve shfaqet Arrçi, një lloj bime me fletë të gjerë, e cila përdoret ushqim për bagëtinë.

Në zonën e Rrasës së Selimit gjendet edhe hartini (molika), i cili aktualisht është i rrallë dhe i vogël, por në të kaluarën jo të largët ka qenë masiv.

Mbi këtë kat është i vendosur kati, Bregu i Rrethit-Gropë e Shkrelit-Lugu i Përsllopit. Edhe në këtë kat ka pyje masive.

Këtu gjendet masivisht bredhi i bardhë dhe i zi, pisha, hartini dhe më e rrallë ahu dhe panja. Këto janë pyje të virgjëra dhe pothuajse të paprekura nga dora shkatërrimtare e njeriut apo katastrofat natyrore. Kjo për faktin se në këtë zonë nuk është zhvilluar infrastruktura rrugore e transportit me automjete.

Pastaj ky krah vazhdon me kullota alpine dhe subalpine që fillojnë nga Qafa e Çulit deri në Lugun e Radoces. Këto kullota janë në formë të shpatinave me pjerrësi deri në $45^0$ të cilat në pjesën e fundme të tyre bien thikë mbi lumin e Valbonës.

Nga Lugu i Radoces deri në malin e Mijushës ky bllok vazhdon me kreshta te thepisura majash. Në pjesën e poshtme ato përojnë një thyerje duke krijuar një shpatinë në forme rrëngalleje e cila është e mbuluara me pyje në forme shkurresh dhe që thirret rrahina e Mbaskollates.

Në Rrahinat e Mbaskollatës gjallon kryesisht mëlleza, frashri por ndeshemi edhe me paje, brezdë, bli dhe ah. Në këtë masiv gjendet edhe lajthia e egër dhe thana.

Në krahun e djathtë të rrjedhjes së lumit në katin Ziç–Zhari i Arushës-Lugu i Konakut–Podi i Udhës Kuqe ndeshemi me ndërthurje të pishës, ahut, bredhit të zi, bredhit të bardhë, lajthisë si dhe shkurreve.

Ky kat ndërpritet nga mali i Pecmarres, i cili bie thikë mbi Quk dhe pastaj vazhdon nga Shpella e Verbit deri mbi Mbaskollate i populluar nga pyje masive ahu me ndërthurje të mëllezës, frashrit, lajthisë dhe shkurreve.

Mbi këtë kat, në vijën Bregu i Madh-Mrize të Reja-Quku i Arrçit gjenden ndërthurje ndërmjet ahut, pishës, bredhit dhe arrçit. Në luginat e orteqëve gjallon edhe lajthia.

Mbi të janë mbivedosura male të thepisura me bimësi të rrallë që është kryesisht pisha dhe barishtoret (bari pirrak), që fillojnë nga Kullat e Qetës të Arushës dhe përfundojnë me Pecmarrën.

Në pjesën rrafshore të luginës aty ku janë të ndërtuara edhe vendbanimet mbizotëron pyjet e ahut të ndërthura me pishë, bredh të bardhë, bredh të zi, dellinjë dhe shelgje.

Kullota alpine gjendet në të dy krahët por me të pasura janë: Nga e djathta, Brijzat, dhe Mrizet e Reja dhe nga e majta Jezerca, Pllana, Rrethi Bardhë dhe Kollata (prozhmet).

Në të dy krahët gjenden edhe dëllinja e zezë dhe e kuqe, shibljaku, makiet, driza, shqemi, kaça (trëndafili i egër) e tjerë e tjerë.

Qoftë në librat universitarë të gjeografisë fizike të Shqipërisë të hartuara nga prof. dr. P. Qirjazi, por edhe në studimin e kryer në vitin 2005: "Burimet Natyrore të Shqipërisë së Veriut", studiuesit H. Kola dhe M. Meta, shkruajnë se "në token e shkriftë nga Valbona në Rrogam gjenden pyje ahu (Fagus silvatica-), dhe në tokën e shkriftë nga Rragami në Valbonë, (900-1.000 m), gjejmë pyje madhështorë mehormoq (Picea abies-), një florë kjo karakteristike e Evropës Qëndrore.

Gjithashtu rritet dhe hartina (Pinus silvestris-), bredhi i bardhë (Abies alba-), dhe pisha e zezë (Pinus nigra-). Në Valbonë gjenden specie të rralla si Aschillea grandifolia, Minuartia baldacci, Plantagoreniformis, Scrophularia bosniaca, Teucrium arduini, Trifolium pilezii, Lunaria telekiana."

Përveç pyjeve, kullotave dhe livadheve alpine dhe subalpine në Valbonë ndeshemi edhe me praninë e një larmie shoqërimesh bimore dhe atyre barishtore. Në pjesën e banuar dhe në kullotat alpine e subalpine ka një bimësi barishtore mjaft interesante dhe të ndërthurur siç janë tërfonja, bari pirrak, shpatorja, sanca, salepi, gojfili, çaji i malit, trumza.... e tjerë.

Për nevoja të ushqimit të blegtorisë kultivohet edhe jonxha. Fieri dhe fiernajat janë me shumicë sidomos në ashtë, pote, rapuha, lugu i poteve si edhe në fundin e shpateve dhe afër gropave të mëdha nga të dy krahët e lumit.

Valbona është e pasur me lule të cilat kryesisht e popullojnë terrenin në pranverë por ato mund të gjenden në të katër stinët pranverë, verë e vjeshtë dhe më pak në dimër në afërsi të lumit dhe perrenjëve.

*Vijon në numrin e ardhshëm*

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

# Ekspozita Digjitale "Librat për Alpet"

Në kuadrin e Konventës Euro Ballkanike të Alpeve, do të përgaditim Ekspozitën Digjitale "Librat për Alpet", e cila do të shfaqet, në raste të caktuara, në dy ditët e Konventës Alpine.

Studiuesë, poetë, publicistë, shkrimtarë, nga 14 shtetet alpine të Ballkanit Perëndimor dhe Europës së Mesme, mirëpresim ti dërgojnë kopertinat e librave të tyre për Alpet (në cilësi të lartë publikuese, në pdf apo jpg) deri më 22 mars 2026, në adresat:

**E-mail: Konventa 2026@gmail.com dhe BotimetDardania@gmail.com**

Autorët që i dërgojnë librat e tyre (fizik, shtypshkrim, me ISBN) do te ekspozohen nënje stende të veçantë (edhe tavoline) në se arrijnë numrin e caktuar të kopjeve të tyre. Këta libra do të shihen nga Komisioni për Kulturën i Konventës dhe ato që janë tërësisht me tematikë për Alpet do të vlerësohen autorët e tyre me "Mirënjohje" nga Konventa EuroBallkanike e Alpeve.

Secili autor i librave për Alpet (studiuese, poetë, publicistë, shkrimtarë) do të nderohen me "Mirënjohje" nga Konventa EuroBallkanike e Alpeve".

Për gjithcka tjetër, më shumë e më mirë, mbetemi në kominikim të përbashkët, në ditët e muajt në vazhdim drejt Konventës Euro Ballkanike të Alpeve.




**The ALPS: In Panoramic Paintings**
**by Tom DAUER (Author)**
**(Prestel, 2020)**



# KONVENTA

## EuroBallkanike e Alpeve

## EKSPOZITÉ FOTOGRAFIKE

## "VALBONA – Historike, Kulturore, Turistike"

Fotoreporter:

## KRISTAQ JANUSHI

Valboné (Tropojé)

15 Maj 2026

Organizatore

Qendra ALPINE · Gazeta Alpeve · Valbona Resort

Botimet Dardania
Tiranë-Prishtinë



Limit.al
Portal kombëtar

Abonohuni në
GAZETA E ALPEVE
100 € për 1 VIT

SIGAL
IG Insurance Group
CERTIFIED • CERTIFIED • CERTIFIED • CERTIFIED
ISO 27001
BLI ONLINE
SIGURACIONIN
QË TË DUHET
sigal.com.al